Nga aspekti gjeografik, Kosova ndahet në dy njësi të mëdha rajonale të rrafshëta: pjesa veri-lindore njihet si "Rrafshi i Kosovës", dhe pjesa jug-perëndimore njihet si "Rrafshi i Dukagjinit". Ato karakterizohen me kushte të

veçanta klimatike-gjeografike. Për shembull dallohen disa nën-njësi si Drenica, Novobërda dhe Gollaku, Fusha e Kosovës, Fusha e Moravës, Podujeva, etj.

Kosova rrethohet nga disa vargje malore të larta. Pjesa veriore rrethohet nga Malet e Kopaonikut (mbi 2000 m), të cilat karakterizohen nga aktiviteti abraziv, si lumor, ashtu edhe akullnajor. Në pjesën jugore dhe jug-përëndimore të Kosovës, në kufi me Maqedoninë, gjenden Malet e Sharrit (mbi 2,500 m). Pjesa përëndimore e Kosovës (kufiri me Shqipërinë) përfshin pjesë të Alpeve Shqiptare dhe Malet e Mokrës (në kufi me Malin e Zi). Këto anë karakterizohen me material shkëmbor, male të lartë dhe gryka të thella.

Në pjesën qendrore të Kosovës, në përëndim dhe jug-përëndim të Prishtinës, gjenden vargjet e maleve Bjeshket e Çiçavicës dhe Goleshi, Carraleva dhe Milanovci, të cilat karakterizohen nga format artistike, si lumore, ashtu edhe abrazive, duke u ngritur deri në 1000 m lartësi. Pjesa e Kosovës që karakterizohet me sipërfaqe të rrafshëta, mbulon rreth 36 % of të territorit të shtetit. Këto dy ultësira karakterizohen me lartësi mes 400 dhe 700 m mbi nivel të detit [1].[4]

Sipas Gavrillovic et al. (1998), Kosova ka 45 objekte gjeomorfologjike të rëndësisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga to, 19 objekte kanë rëndësi ndërkombëtare (të shkallës ndërkombëtare), me 14 që i takojnë relievit akullnajor dhe 5 relievit para-akullnajor, 3 objekte kanë rëndësi rajonale (ballkanike), dhe 4 objekte kanë rëndësi lokale. Elementet para-akullnajorë dhe akullnajorë kryesisht ndodhen në Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Pashtrik dhe Koritnik. Malet e Sharrit përmbajnë tetë objekte që lidhen me relievin akullnajor dhe tri objekte shtesë që lidhen me relievin para-akullnajor. Bjeshkët e Nemuna përmbajnë peë objekte që lidhen me relievin akullnajor dhe dy objekte që lidhen me relievin para-akullnajor, derisa Malet Koritnik përmbajne vetëm një objekt që lidhet me relievin akullnajor. Objektet e trashëgimisë gjeografike me vlerë rajonale (Ballkan) lidhen me relievin lumor, që janë Gryka e Rugovës (Bjeshkët e Nemuna), torfa e madhe në Shutman (Malet e Sharrit) dhe Kanionin e Mirushës. Për më tepër, Kosova ka 19 shpella (objekte speleologjike); nga këto, katër janë aktive dhe tri gjysmë-aktive, derisa tjerat janë jo-aktive (Bajraktari et al. 2010). Dy nga këto shpella janë të hapura për vizitorët, duke përfshirë Shpellën e Mermertë në fshatin Gadime (Zona e Lipjanit), e cila është formuar gjatë periudhës terciare dhe është është e vetmja shpellë e mermertë e njohur në Europë, dhe Shpella e Radavcit afër burimit të Drinit të Bardhë (Bjeshkët e Nemuna); Shpella e Radavcit ka një gjatësi prej rreth 1420 metra (duke përfshirë të gjitha kanalet e shpellës).

Fenomenet më të afërta gjeomorfologjike janë shpella e mermerit (numër 26) në largësi prej 3.2 km lindje nga interkoneksioni Maqedoni e Veriut-Kosovë dhe Bifurkacioni i Lumit Nerodime (numër 27) në largësi prej 2.7 km jug nga gazsjellësi Ferizaj-Prizren.

Shpella e Mermerit apo Shpella e Gadimes është një shpellë karstike gëlqerore në fshatin Gadime e Ulët në Komunën e Lipjanit, Kosovë. Pjesa më e madhe e saj është ende e pa eksploruar. Shpella ishte zbuluar në vitin 1966 nga një fshatar me emrin Ahmet Asllani, i cili kishte qenë duke punuar në kopshtin e tij. Shpella e Gadimes gjendet brenda gurëve të mermertë gëlqerorë që i përkasin Epokës Mezozoike. Shpella është formuar gjatë periudhës terciare. Me kalimin e kohës, mermeri i është nënshtruar çarjes si rezultat i erozioneve tektonike. Hyrja në shpellë mund të bëhet nga dy drejtime. Drejtimi i ulët është relativish i komplikuar dhe përbëhet nga 3 kanale të tërthorta, 2 korridore paralele dhe të lakuara. Drejtimi i lartë përbëhet nga dy korridore të kombinuara. Gjatësia totale e shpellës është 1.260 m dhe sipërfaqa e saj është 56.25 ha.[5]

Bifurkacioni i Lumit Nerodime është i vetmi shembull në Evropë ku një lumë derdhet në dy dete të ndryshme. Lumi Nerodime rrjedh në malet e Jezercit në afërsi të Ferizajit, e pastaj ndahet në mënyrë të pakthyeshme në dy degë, të cilat derdhen në dy dete të ndryshme. Dega veriore (e majtë) derdhet në Lumin Sitnica dhe vazhdon në Ibër, Lumin e Moravës dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, deri sa dega jugore (e djathtë) përmes

---


[4] *https://www.kosovo-mining.org/kosovo/geography/?lang=en*

[5] *https://en.wikipedia.org/wiki/Marble_Cave,_Kosovo*

Lumit Lepenc dhe Vardar derdhet në Detin Egje. Bifurkacioni i Lumit Nerodime qysh nga viti 1979 është vendosur nën mbrojtje ligjore si Rezervat i Veçantë Natyror.[6]

Trashëgimia natyrore gjeomorfologjike më e afërt është Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë që gjendet 0,5 km nga gazsjellësi Prizren Gjakovë siç shihet në **Figurën 4-5** (numri 42)[7].

FIGURA 10 – VLERAT E TRASHËGIMISË NATYRORE GJEOMORFOLOGJIKE RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS



---

[6] *https://visitkosovo.rks-gov.net/post/bifurkacioni-i-lumit-te-nerodimes*

[7] *Burimi i origjinës: Behxnet, M., Hajdari, A., Mustafa, V., Pulaj, B., (2018), Trashëgimia natyrore në Republikën e Kosovës: Në kërkim të siteve potenciale për UNESCO, IALE Official Journal of the International Association for Landscape Ecology nr. 63, fq. 6*




Burimi i origjinës: Behxnet, M., Hajdari, A., Mustafa, V., Pulaj, B., (2018), Trashëgimia natyrore në Republikën e Kosovës: Në kërkim të siteve potenciale për UNESCO, IALE Official Journal of the International Association for Landscape Ecology nr. 63, fq. 6

Pjesa lindore e sistemit të planifikuar të gazsjellësit gjendet kryesiht në terren më të ulët nga 297 - 520 m mbi nivel të detit dhe pjesa përëndimorre në një terren pak më të lartë prej 520 m deri 740 m. Përjashtim nga kjo bën pjesa qëndrore e gazsjellësit Ferizaj-Prizren që gjendet 960-1400 m mbi nivel deti (FigurA 1110).

I gjithë sistemi i gazsjellësit është planifikuar kryesisht mbi shpate shumë të buta dhe të buta. Në shpate mesatarisht të pjerrëta, janë planifikuar gazsjellësi Skenderaj-Mitrovica dhe një pjesë e gazsjellësit Istog-Skenederaj. Në shpate mesatarisht të pjerrëta dhe të pjerrëta planifikohet pjesa më jugore e interkoneksionit Maqedoni e Veriut – Kosovë, dhe pjesa qendrore e gazsjellësit Ferizaj-Prizren (FigurA 12).

FIGURA 11 – HARTA E LARTËSIVE NË KOSOVË



Legend/Legjenda

Kosovo border/Kufiri i Kosovës


Gas_pipelines/Gazsjellësi

- Kosovo transmission branch pipelines/ Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës
- Kosovo transmission pipelines-gas ring/ Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit
- North Macedonia-Kosovo interconnection/ Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë
- Route ALB Border-Prizren/ Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren
- Aboveground facilities/Objektet mbitokësore

Altitude/Lartësi mbidetare

- <= 520m
- 520 - 740m
- 740 - 960m
- 960 - 1180m
- 1180 - 1400m
- 1400 - 1620m
- 1620 - 1840m
- 1840 - 2060m
- 2060 - 2280m
- > 2280m

FIGURA 12 – HARTA E PJERRTËSIVE NË KOSOVË



4.4 - Gjeologjia dhe hidrogjeologjia

4.4.1 - Gjeologjia

Kosova mbulon një sipërfaqe prej rreth 10,900 km^2 dhe karakterizohet me një lartësi prej 800 m mbi nivelin e detit, por që shfaq ndryshime vertikale të relievit dhe morfologjisë. Këto ndryshime morfologjike janë pasojë e

pozitës gjeologjike. Pika më e ulët e Kosovës gjendet në Luginën e Drinit të Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë prej 297 m. Pika më e lartë gjendet në jug të Kosovës në Gjeravicë – 2,565 m.

Kosova rrethohet nga disa vargje malore të larta. Pjesa veriore rrethohet nga Malet e Kopaonikut (mbi 2000 m), të cilat karakterizohen nga aktiviteti abraziv, si lumor, ashtu edhe akullnajor. Në pjesën jugore dhe jug-përëndimore të Kosovës, në kufi me Maqedoninë, gjenden Malet e Sharrit (mbi 2,500 m). Pjesa përëndimore e Kosovës (kufiri me Shqipërinë) përfshin pjesë të Alpeve Shqiptare dhe Malet e Mokrës (në kufi me Malin e Zi). Këto anë karakterizohen me material shkëmbor, male të lartë dhe gryka të thella.

Në pjesën qendrore të Kosovës, në përëndim dhe jugpërëndim të Prishtinës, gjenden vargjet e maleve Bjeshkët e Çiçavicës dhe Goleshi, Carraleva dhe Milanovci, të cilat karakterizohen nga format artistike, si lumore, ashtu edhe abrazive, duke u ngritur deri në 1000 m lartësi.

Pjesa e Kosovës që karakterizohet me sipërfaqe të rrafshëta, mbulon rreth 36 % of të territorit të shtetit. Këto dy ultësira karakterizohen me lartësi mes 400 dhe 700 m mbi nivel të detit

Strukturalisht, Kosova gjeologjikisht ndahet në dy gjysma përafërsisht të barabarta (Zona e Vardarit në lindje dhe Drenica (Drina – Ivanjica)/Korabi – Zona Pelagonike në perëndim) të bashkuar me një tegel VVP-JJL mes masivit Dardan (Serbo-Maqedon) në Kosovë dhe Rripit Dinarik Gjeologjik të Shqipërisë. Zona transformuese mezozoike, e ashtuquajtur vijëzimi Shkoder-Pejë, ndan Drinën dhe Korabin në dy zona të veçanta. Zona e Vardarit është ekonomikisht e rëndësishme sepse përmban depozitat e plumbit, zinkut dhe argjendit të Trepçës. Këto depozita variojnë nga skarnat me karbon dhe mbushjet karstike, deri te depozitat venore.


Platformat gëlqerore mezozoike janë çarë nga disa gjenerata të shkarjeve të orientuara në drejtime të ndryshme. Gurët gëlqerorë janë gurë reaktivë në gjendje për të absorbuar kripëra të nxehura të pasura me minerale, dhe nga këto solucione kanë dalë metale në këto horizonte të favorshme. Zona e Vardarit mund të ketë pasur zanafillën ose në Epokën e Hershme Paleozoike, si pjesë e Paleotetisit që kishte ndarë Gondvanalandën në jug nga Eurasia në veri, ose në Epokën e Triasikut, siç është lugina oqeanike e Detit të Kuq.

Mbyllja përfundimtare e Oqeanit të Vardarit është e paqartë dhe mund të ketë ndodhur ose në Epokën Kretaceitike, ose Paleogjenikun e Hershëm. Formacioni i ofioliteve përmes mbylljes së oqeanit është i rëndësishëm për shkak se njësitë ultrabazike përmbajnë krom, dhe këta gurë serpentinitë me kalimin e kohës shkërrmoqen nën klimën tropike dhe sub-tropike për të prodhuar boksit dhe nikel lateritik. Depozitat e boksitit në pjesën përëndimore qendrore gjenden në gurë gëlqerorë karstikë dhe përfaqësojnë mbetjet e këtyre ultrabazikëve të rrahur nga moti.

Zona e Kosovës karakterizohet nga varietete të formacioneve gjeologjike. Mes tyre ka shkëmbinj që vijnë nga Epoka Kristaline Proterozoike deri te Epoka Kuaternare, e që përbëhen nga lloje të shkëmbinjëve sedimentar, magmatik dhe metamorfikë.

Shpërndarja hapësinore e llojeve të ndryshme të shkëmbinjëve në Kosovë jepet në figurën në vijim.

FIGURA 13 – HARTA GJEOLOGJIKE E KOSOVËS




Burimi i origjinës: https://kosovo-mining.org/mineral-resources/geology/?lang=en

4.4.2 - Hidrogjeologjia

Burimet më të rëndësishme të ujërave nëntokësore janë të porozitetit intergranular dhe mund të gjenden të dala si kokrra të trasha të sedimenteve të paformësuara holocene dhe pleistocene në pjesën qendrore dhe përëndimore të Kosovës në ujëmbledhësit e lumenjve kryesorë. Një burim tjetër i rëndësishëm i ujërave nëntokësore paraqitet nga gurët gëlqerorë të karstifikuar të Epokës Xhurasikut dhe Triasikut, të cilat mund të gjenden në pjesën përëndimore të Kosovës.

FIGURA 14 – HARTA HIDROGJEOLOGJIKE E KOSOVËS



Njësitë hidrogjeologjike

K_f [m/s]

Akuifere

Poroze/porozitet intergranular

Akuifer me porozitet intergranular shumë të lartë – depërtueshmëri të mesme (p.sh. rërë, rërë+zhavorr, rërë+zhavorr+baltë/lym) $> 10^{-5}$

Akuifer me porozitet integranular me përshkueshmëri mesatare - të ulët (p.sh. baltë + rërë + baltë/llum) 10^{-5} - 10^{-9}

Porozitet i çarë

Akuifer me porozitet të çarë me depërtueshmëri të mesme – të ulët të thyerjeve (p.sh. gurë gëlqerorë, gurë gëlqerorë/merli, mermer, shkëmb metamorfik, gur ranor+konglomerat+gur gëlqeror/merli, shkëmb plutonik) 10^{-5} - 10^{-9}

Porozitët i çarë/i karstifikuar

Akuifer me porozitet të çarë dhe të karstifikuar me depërtueshmëri të fuqishme alternuese, shumë të lartë lokale të të çarave (p.sh. gur gëlqeror, mermer) 10^{-3} - 10^{-9}

Porozitet i përzier

Akuifer me porozitet të dyfishtë me depërtueshmëri t ë mesme-të ulët (p.sh. gur gëlqeror) 10^{-5} - 10^{-9}

Zonë hidrotermale/me ndryshime tektonike

Zone më ndryshme të shkëmbinjve të fortë m e depërtueshmëri të mesme-të ulët 10^{-4} - 10^{-7}

Akuiklud

Akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular ose të çarë (p.sh. gur ranor, gur ranor+gur balte/lymi, konglomerat, shkëmb metamorfik, s hkëmb vullkanik, shkëmb plutonik, shkëmb piroklastik) $< 10^{-9}$

Të dhëna për ujërat nëntokësore

Drejtimi i rrjedhës së ujit nëntokësor, e sigurtë

Drejtimi i rrjedhës së ujit nëntokësor, i nënkuptuar

Zona me ujëra nëntokësore të kufizuara ose arteziane

Të dhënat tektonike

Të sigurta të nënkuptuara

Vatër, veçori të panjohura hidrogjeologjike

Vatër, që vepron si zonë rimbushëse

Litologjia

Shkëmb i pakonsoliduar

Sedimenti

Rërë

Rërë + zhavorr

Rërë + zhavorr + baltë/lym

Argjilë + rërë+ baltë/lym

Shkëmb i konsoliduar

Shkëmb sedimentar

Gur ranor

Konglomerat

Gur ranor + gur balte/gur lymi

Gur ranor + konglomerat + gur gëlqeror/marli

Gur argjilor + gur ranor + gur gëlqeror/marli

Gur gëlqeror/marli

Gur gëlqeror

Shkëmb magmatik dhe metamorfik

Shkëmb plutonik, i pandarë

Shkëmb vullkanik, i pandarë

Shkëmb piroklastik, i pandarë

Shkëmb metamorfik, i pandarë

Mermer

Ujëra sipërfaqësore

Liqen

Lum kryesor

Lum dytësor

Ndarje e ujit sipërfaqësor, lumi kryesor

Ndarje e ujit sipërfaqësor, lum dytësor

Të dhëna për burimin

I vogël < 10 l/s	I mesëm 10 - 100 l/s	I madh > 100 l/s	I paklasifikuar	
				Burim, i pazhvilluar
				Burim, i zhvilluar
				Burim mineral (>1 g/l) i pazhvilluar
				Burim mineral (>1 g/l) i zhvilluar
				Burim termal (>20C) i pazhvilluar
				Burim termal (>20C) i zhvilluar
				Burim termomineral (>1 g/l, >20C) i pazhvilluar
				Burim termomineral (>1 g/l, >20C) i zhvilluar

Të dhëna primare

- Pus
- Grup pusesh
- Pus vëzhgimi, pus monitorimi, piezometër
- Pus për ekzemplar
- Pus me pompë
- Stacion pompimi
- Luginë ose shpellë

Të dhëna topografike

- Kufi administrative
- Qytete
- Rrugë
- Hekurudhë

Burimi i origjinws: Harta hidrogjeologjike e Kosovws 1: 200 000, Beak Consultants GmbH, 2006

4.4.3 - Raporti i gazsjellësit me pozitën gjeologjike dhe hidrogjeologjike

Gazsjellësi nga kufiri MKD/KOS deri në Prishtinë (Interkonektori Maqedonie Veriut - Kosovë)

Pjesa më e madhe e gazsjellësit gjendet në:

- gurë gëlqeror të kretakut të sipërm, gurë merli, gur lymor dhe gur ranor,
- sedimente pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, merlë, kristale karbonati, gurë të djegur dhe linjit
- sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe argjilë, dhe
- holocen proluvium – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjëve, depozita ranore-lymore

Një seksion i vogël i gazsjellësit ndodhet mbi gurë merli miocenë, shistë paleozoike dhe serpentinit xhurasik.

Shkëmbi sedimentar kretak është një akuiklud.

Pjesa më e madhe e seksionit verior të gazsjellësit mbi proluviumin holocen i cili është akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë - mesatare.

Një seksion më i vogël i gazsjellësit verior shtrihet mbi sedimente pliocene të cilat janë akuifer i porozitetit intergranular.

Disa seksione shumë të vegjël përbëhen nga gurët gëlqerorë me akuifer të porozitetit të copëtuar me përshkueshmëri të mesme- të ulët të thyerjes.

Uji nëntokësor definohet si i kufizuar apo artezian.

Gazsjellësi Ferizaj - Prizren

Pjesa më e madhe e gazsjellësit shtrihet mbi:

- Sedimente pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, merlë, kristale karbonati, gurë të djegur dhe linjit
- Sedimente të larta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, pjesërisht merl, tufite
- Sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe argjilë
- Gurë gëlqerorë koniakan - mastrihtinan, gurë merlë, lym (flish i kalkuar)
- Filite të paleozoikut të lartë, sericite shist, kuarc, meta-gur ranor
- Holocen proluvium – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjëve, depozita ranore-lymore dhe
- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym

Një seksion i vogël i gazsjellësit shtrihet mbi shkëmbinjë metamorfikë të triasikut të ulët –të mesëm, amfibolite të paleozoikut të lartë, gur ranor mastrihtian, gur lymor, merlë (flish).

Seksioni i mesëm i gazsjellësit shtrihet kryesisht mbi akuiklud i cili përbëhet nga guri gëlqeror, merla dhe shkëmbinjtë metamorfikë.

Një pjesë e vogël e seksionit të mesëm është akuifer i porozitetit të copëtuar dhe karsifikuar me përshkueshmëri shumë të ndryshueshme, shumë të lartë lokale të thyerjes.

Seksionet e jashtme të gazsjellësit shtrihen mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë – të mesme, që përbëhet nga sedimente të rërës dhe zhavorit dhe mbi akuiferin me porozitet intergranular me përshueshmëri të mesme – të ulët që përbëhet nga zhavorri apo argjila, rëra dhe balta.

Pjesa më e madhe e akuiferit është zonë me ujë të kufizuar apo artezian.

Gazsjellësi Prizren - Gjakova

Gazsjellësi shtrihet mbi seksionet në vijim:

- Sedimente të larta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, pjesërisht merlë, tufite
- Terrasa lumore pliocene – zhavorr, rërë
- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym

Gazsjellësi shtrihet komplet mbi akuiferin me porozitet intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë – të mesme deri të mesme – të ulët që përbëhet nga zhavori apo argjila, rëra dhe balta.

Gazsjellësi Gjakovë – Pejë

Gazsjellësi shtrihet mbi sektorët në vijim:

- Sedimente të larta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, pjesërisht merlë, tufite
- Terrasa lumore pliocene – zhavorr, rërë
- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym
- Holocen proluvium – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjëve, depozita ranore-lymore

Një seksion shumë i vogël ndodhet mbi sedimente pleistocene glacigjene të depozitave moraine fluvio dhe limnoglaciale.

Pjesa më e madhe e gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë- të mesme të përbërë nga rëra dhe zhavori. Një pjesë e vogël e gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të përshkueshmërisë së mesme- të ulët.

Uji nëntokësor ka rrjedhë të orientuar kah lindja në këtë zonë.

Gazsjellësi Pejë - Istog

Gazsjellësi shtrihet mbi sektorët në vijim:

- Holocen proluvium – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjëve, depozita ranore-lymore
- Terrasa lumore pliocene – zhavorr, rërë
- Holocene Deluvium – fragmente shkëmbinjsh, rërë, lym
- Sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe argjilë
- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym
- Sedimente të larta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor, pjesërisht merlë, tufite
- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym

Dhe një pjesë e vogël e gazsjellësit ndodhet mbi kalk pleistocen tufa / travertine.

Pjesa më e madhe e gazsjellësit ndodhet mi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë- të mesme të përbërë nga rëra dhe zhavori dhe lymi/balta.

Një seksion shumë i vogël i gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit të dyfishtë me përshkueshmëri të mesme të ulët.

Uji nëntokësor ka rrjedhë të orientuar kah lindja në këtë zonë. Një pjesë e vogël e akuiferit është në zonën me ujë të kufizuar artezian.

Gazsjellësi Istog – Skenderaj

Gazsjellësi shtrihet mbi seksionet në vijim:

- Aluvium holocen - zhavor, rërë, lym
- Sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe argjilë
- Pliocen i mesëm- i lartë zhavor, rërë, argjilë. merlë, gurë gelqërë merlë
- Gur ranor mastrihtian, gur lymi, gur merle (flish)

Pjesa më e madhe e gazsjellësit gjendet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë – të mesme deri në të mesme-të ulët që përbëhet nga rëra, zhavori dhe balta/lymi.

Një seksion i vogël i gazsjellësit ndodhet mbi akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular apo të çarë që përbëhet nga guri ranor dhe guri baltor/lymor.

Një pjesë më e vogël e akuiferit gjendet në një zonë me ujë nëntokësor të kufizuar apo artezian derisa pjesa më e madhe e ujit nëntokësor ka orientim jugor të rrjedhës.

Gazsjellësi Prishtina 1 - Drenas

Gazsjellësi ndodhet në sektorët në vijim:

- Sedimente të ulëta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor,merlë, kristale karbonati, shkëmbinj te djegur, linjit
- Shkëmbinjë silikati sedimentar të Meta Triasikut të ulët-mesë, - shistë, kuarcite, meta-konglomerat
- Delivium Holocen – copëza shkëmbi, rërë, lym
- Sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe klaz

Një seksion i gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshueshmëri shumë të lartë-të mesme deri të mesme-të ulët të përbërë nga rëra, zhavori dhe balta/lymi.

Pjesa tjetër e gazsjellësit ndodhet mbi akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular dhe porozitet të çarë të përbërë nga shkëmbinjë metamorfikë.

Një pjesë e vogël e akuiferit është zonë me ujë nëntokësor të kufizuar apo artezian.

Gazsjellësi Drenas - Skenderaj

Gazsjellësi ndodhet mbi seksionet në vijim:

- Sedimente të ulëta pliocene klastike, rërë argjile, zhavor,merlë, kristale karbonati, shkëmbinj te djegur, linjit
- Gur ranor mastrihtian, gur lymi, gur merle (flish)

Një seksion shumë i vogël i gazsjellësit ndodhet mbi: Aluvium Holocen – zhavor, rërë, Cenomanian - Turonian brecia, gur ranor, gur gëlqeror dhe serpentinit të Xhurasikut të mesëm të lartë.

Pjesa më e madhe e gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri të mesme të ulët të përbërë nga argjila, rëra dhe balta/lymi.

Pjesa më e vogël e gazsjellësit ndodhet mbi akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular apo çarje të përbërë nga guri ranor dhe guri baltor/guri lymor.

Një pjesë shumë e vogël e gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë të përbërë nga zhavori dhe rëra.

Gazsjellësi Skenderaj - Mitrovica

Gazsjellësi ndodhet mbi seksionet në vijim:

- Gur ranor mastrihtian, gur lymor, gur merlor (flish)
- Sedimente klastike të pliocenit të ulët, argjilë, rërë, zhavor, merlë, kristale karbonati, shkëmbinj të djegur, linjit
- Gur ranor Koniakan - Mastrihtian, gur lymor, conglomerat, gur merlor, gur gëlqeror
- Sedimente liqenore pleistocene– zhavor, rërë, lym dhe argjilë

Gazsjellësi kryesisht shtrihet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri të mesme të ulët të përbërë nga rëra, zhavori apo argjila dhe balta/lymi dhe mbi akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular apo çarës të përbërë nga guri ranor dhe guri baltor/lymor apo guri gëlqeror/merlor.

Një pjesë shumë e vogël e gazsjellësit ndodhet mbi akuifer të porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë-të mesme të përbërë nga rëra dhe zhavori.

Gazsjellësi Mitrovicë - Vushtrri

Gazsjellësi shtrihet mbi Aluvium Holocen - zhavor, rërë dhe lym.

Kjo zonë është akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë të mesme të përbërë nga zhavori, rëra dhe balta/lymi.

Pjesa më e madhe e zonës së gazsjellësit është ujë i kufizuar apo artezian.

Gazsjellësi Krushe e Madhe - Rahovec

Gazsjellësi ndodhet në njësitë e mëposhtme gjeologjike:

- Aluvium Holocen - zhavor, rërë, lym
- Sedimente klastike pliocene, argjilë, rërë, zhavor, pjesërishte merlë, tufite

Gazsjellësi gjendet në njësitë hidrogjeologjike si në vijim:

- Akuifer i porozitetit intergranulat me përshkueshmëri shumë të lartë të mesme të përbërë nga zhavori, rëra dhe balta/lymi
- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri të mesme të ulët të përbërë nga zhavori, rëra dhe balta/lymi

Uji nëntokësor ka rrjedhë në drejtim jugor në këtë zonë.

Gazsjellësi Ferizaj – Gjilan

Gazsjellësi ndodhet në njësitë e mëposhtme gjeologjike:

- Holocene proluvium – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjëve, depozitave të rërës dhe lymit
- Sedimente të ulëta klastike pliocene, argjilë, rërë, zhavor, pjesërishte merlë, tufite
- Gur merle i mesëm miocen, gur argjilor, gur ranor, pjesërisht gur shtufi dhe linjit
- Shkëmbinj piroklastik Oligocen – Pliocen
- Gabbro e Xhurasikut të mesëm të lartë

Gazsjellësi shtrihet në njësitë hidrogjeologjike si në vijim:

- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri të mesme të ulët të përbërë nga argjila, rëra dhe/ose balta/lymi (i forcuar apo i paforcuar).

- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë-të mesme të përbërë nga argjila, rëra, balta/lymi
- Akuifer i porozitetit të çarë me përshkueshmëri të thyer të mesme-të ulët të përbërë nga shkëmbi piroklastik
- Akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular apo të çarë të përbërë nga shkëmbinj plutonik apo gur argjilor, gur ranor dhe gur gëlqeror/gur merlor.

Gazsjellësi Prishtinë - Podujevë

Gazsjellësi ndodhet në njësitë gjeologjike si në vijim:

- Aluvium Holocen – zhavor, rërë, lym
- Terrasa lumore pleistocene - zhavor, rërë
- Proluvium Holocen – fanglomerat i copëzave të shkembinjve, depozita ranore-lymore

Gazsjellësi ndodhet në njësitë hidrogjeologjike si në vijim:

- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë-të mesme të përbërë nga zhavori, rëra dhe/ose balta/lymi.

Gazsjellësi SBV Hani i Elezit deri te Sharrcem

Gazsjellësi ndodhet në njësitë gjeologjike si në vijim:

- Gur ranor i miocenit të lartë, gur merlor, gur baltor
- Shist muskovit i biotitit të ulët paleozoik

Gazsjellësi ndodhet në njësitë hidrogjeologjike si në vijim:

- Akuiklud pa porozitet të konsiderueshëm intergranular apo çarës të përbërë nfa shkëmbinjtë metamorfikë.

Gazsjellësi Prizren – Kufiri SHQ/KOS

Gazsjellësi ndodhet në njësitë gjeologjike si në vijim:

- Gur gëlqeror i Triasikut të mesëm të lartë, dolomit, pjesërisht kërpudhor
- Proluvium Holocen – fanglomerat i copëzave të shkëmbinjve, depozita të rërës e lymit
- Terrasa lumore pleistocene-zhavor, rërë
- Sedimente pleistocene liqenore - zhavor, rërë, lym, argjilë

Gazsjellësi ndodhet në njësitë hidrogjeologjike si në vijim:

- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri shumë të lartë të mesme të përbërë nga zhavori dhe rëra
- Akuifer i porozitetit intergranular me përshkueshmëri të mesëm të ulët të përbërë nga zhavori, rëra, dhe lymi/balta
- Akuifer i porozitetit të çarë dhe të karstifikuar me përshkueshmëri shumë të ndryshueshme, të lartë lokale, të çatë të përbërë nga gurët gëlqerorë

4.5 - Gjeorreziqet


4.5.1 - Sizmiciteti

Territori i Kosovës, sipas aspektit sizmik-tektonik paraqet një nga vendet më aktive, ku mund të priten tërmete shkatërruese me karakter autokton. Të dhënat mbi tërmetet e kaluara dëshmojnë qartë se ndodhia e termeteve katastrofike në disa pjesë të territorit të Kosovës ka qenë evidente më herët, prandaj mes termeteve historike mund të përmendim atë të vitit 1456, që ka ndodhur në Prizren me intensitet IX, MSK-64, pastaj me 1552, në rrethinën e Pejës ka ndodhur një termet me intensitet të shkallës VIII, MSK-64. Termete të forta kanë ndodhur po ashtu më vonë, siç është ai i vitit 1921 me intensitet të epiqendrës IX, MSK-64 shkallë, i cili e ka goditur rajonin Ferizaj-Viti-Gjilan, pastaj termeti i vitit 1980, i cili e ka goditur rajonin e Kopaonikut me intensitet VIII, MSK-64 shkallë, dhe i fundit, me 24 prill 2002 me intensitet të epiqendrës VII1/2, MSK-64 shkallë, i cili e kishte dëmtuar rëndë komunën e Gjilanit. Territori i Kosovës po ashtu karakterizohet me atë që i nënshtrohet lëvizjeve të forta nga termetet që kanë epiqendër jashtë Kosovës, në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Këto dy fenomene, sizmiciteti lokal autokton dhe seizmiciteti i shkaktuar nga termetet e largëta, dëshmojnë që Kosova radhitet në territoret me aktivitet të lartë sizmik. Ky aktivitet mjaft i lartë dikton ndërmarrjen e studimeve të përgjithshme me qëllim që bazuar në analizat dhe sintezat nga të dhënat e grumbulluara, të jepet një tabelë e plotë, e saktë dhe e realizueshme për vlerësimin e rrezikut nga tërmeti në Kosovë.[8]

Tërmetet historike për periudhën 1950 – 2022 paraqiten në fotografinë e mëposhtme.

[8] *Seismotectonic Settings of Kosova Zenun Elezaj, University of Prishtina, Faculty of Mining and Geology, Mitrovice, Kosova, 2009.*

FIGURA 15 – HARTA E TËRMETEVE TË KOSOVËS



Legenda/Legjenda

Kosovo border/Kufiri i Kosovës

Earthquakes (M)/Tërmet

- 2.86 - 3.5
- 3.5 - 4.13
- 4.13 - 4.77
- 4.77 - 5.41
- 5.41 - 6.05

Gas pipelines/Gazsjellësi


- Kosovo transmission branch pipelines/Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës
- Kosovo transmission pipelines-gas ring/Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit
- North Macedonia-Kosovo interconnection/Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë
- Route ALB Border-Prizren/Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren
- Aboveground facilities/Objektet mbitokësore

4.5.2 - Vatrat aktive

Këtu, është e rëndësishme të përmendet ekzistenca e rrezikut të lartë sizmik që shoqërohet me disa zona të vatrave aktive në rajon, e që janë kryesisht zonat e vatrave në Ferizaj, Pristina, Drenovci, Zhelino, Gjilan, Vitia dhe Shkup.

Sipas të dhënave vektoriale të grumbulluara nga Projekti SHARE project (Giardini D. et al., (2013), Harmonizimi i Rrezikut Seizmik në Europë (SHARE): Online Data Resource, doi: 10.12686/SED-00000001-SHARE, 2013.) gazsjellësi kalon përmes vatrës aktive në përafërsisht matjen 23+500. Në figurën në vijim paraqiten vatrat aktive në rajon, në hartë tregohen vatrat aktive me magnituda maksimale të shprehura (mË). Më të rejat, depozitat lymore Halocene që janë prezente në fushën e Kosovës të përbëra kryesisht nga zhavori, rëra dhe lymi, munden,nëse saturohen me ujë, të tregojnë fenomene të lëngëzimit për shkak të ndodhjes së ngarkesës sizmike.

FIGURA 16 – HARTA E VATRAVE AKTIVE TË KOSOVËS



Legenda/Legjenda

Kosovo border/Kufiri i Kosovës

Active faults

Gas pipelines/Gazsjellësi

Kosovo transmission branch pipelines/
Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës

Kosovo transmission pipelines-gas ring/
Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit

North Macedonia-Kosovo interconnection/
Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë


Route ALB Border-Prizren/
Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren

Aboveground facilities/Objektet mbitokësore

4.5.3 - Rrëshqitjet e dheut

Sipas një artikulli nga Revista Ndërkombëtare e shkencave natyrore dhe inxhinierike 'Rrëshqitjet e dheut në Kosovë, Domosdoshmëria e monitorimit të tyre'', zona totale e rrëshqitjes është 48 km² dhe paraqet 0.44% të territorit të Kosovës. Lartësia mesatare e rrëshqitjeve është 657 m mbi nivelin e detit.

FIGURA 17 – HARTA E RRËSHQITJEVE TË DHEUT TË KOSOVËS



4.5.4 - Përmbytjet


Kosova është e ndjeshme sa i përket përmbytjeve dhe ato mund të ndodhin në mënyra të ndryshme, përmbytjet që ndodhin pas stuhive në zonat malore (përmbytjet e vrullshme), përmbytjet pas shirave të mëdhënj në ultësira dhe përmbytjet që ndodhin pas shkrirjes së borës.

Sipas Raportit të gjendjes së ujërave në Kosovë, disa faktorë tjerë që shkaktojnë përmbytjet janë:

- Shtretërit e parregulluar të lumenjve
- Dëmtimi i shtretërve të lumenjve me anë të nxjerrjes jo në mënyrë të duhur të rërës dhe zhavorrit
- Ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe urave në vendet që kërkcënohen nga përmbytjet
- Hedhja e mbeturinave në lumë apo afër lumit
- Prerja e pyjeve afër zonave të përmbytjeve
- Mirëmbajtja e dobët e objekteve për mbrojtje nga përmbytjet

Sipas vlerësimeve të kryera deri me tani (Master Plani i Ujit 1983), dëmet nga përmbytjet mund të kalkulohen nëse merren parasysh përmbytjet që kanë ndodhur një herë në 100 vjet. Sipas këtij lloj vlerësimi, dëmet nga përmbytja e Drinit të Bardhë mund të jenë 50%, në luginën e Lumit Ibër 24%, në Luginën e Lepencit 20% dhe në Luginën Morava e Binçës 6%. Me qëllim të parandalimit të përmbytjeve zhvillohen projekte për rehabililtimin e shtretërve të lumenjve.


FIGURA 18 – MUNDËSIA QË TË NDODHIN PËRMBYTJE



4.5.5 - Minierat

Kosova ka një gjeologji të llojllojshme që përfshin një numër të metaleve që mund të nxirren si dhe të depozitave të metaleve, duke përfshirë arin, kromin, nikelin, aluminin, bakrin, metalet e hekurit dhe plumbin e zinkun. Komisioni i Pavarur për miniera e Minarale rregullon sektorin minerar të Kosovës, si dhe lëshon licensa për nxjerrje dhe eksplorim.

FIGURA 19 – HARTA E MINIERAVE TË KOSOVËS



4.5.6 - Përshkrimi i gjeorreziqeve të identifikuara përgjatë linjës së gazsjellësit

Gazsjellësi kufiri MKD/KOS deri në Prishtinë

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Kufiri Maqedoni e Veriut/Kosovë deri te Prishtina
Intensiteti maksimal sizmik	VIII – IX ° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06 – 0.08
Rreziku sizmik - PGA vlerat (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.12 – 0.16
Shkarjet aktive	Linja e gazsjellësit kryqëzohet me vatrwn aktive në JL të Ferizajit (me magnitudë maksimale të vlerësuar në 6.5 (mW))
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të lumenjve Sitnica, Stimljanka dhe Morava e Binces.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, Gazsjellësi kryqëzohet me zonë në JL të Kaçanikut që kategorizohet si e prirur për ndodhjen e rrëshqitjeve
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të Gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së Gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbutjeve, si shumë i ulët deri në i lartë (në perëndim të Fushë Kosovës, Lumit Sitnica), por kryesisht me mundësi mesatare të përmbytjeve.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Linja e Gazsjellësit, në jug të Obiliqit kryqëzohet me zonën (në skajin lindor) me eksploatim aktiv (Bardh and Mirash).

Gazsjellësi Ferizaj – Prizren

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Ferizaj – Prizren
Intensiteti maksimal sizmik	VII – IX ° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06 – 0.08
Rreziku sizmik - PGA vlerat (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.16
Vatrat aktive	Linja e gazsjellësit kryqëzohet me vatrën aktive në JL të Suharekës (me magnitudë maksimale të vlerësuar në 6.5 (mW).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të Lumit Toplluha dhe degëve
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, si i ulët deri në i lartë (në zonën e degëve të Toplluhës).
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo

Gazsjellësi Prizren – Gjakova

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Prizren – Gjakova
Intensiteti maksimal sizmik	VII °e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.08
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.16

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Prizren – Gjakova
Vatrat aktive	Vatra më e afërt aktive ndodhet rreth 5 km JL të Prizrenit (me magnitudë maksimale të vlerësuar në 6.5 (mW).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të lumenjve Drini i Bardhe, Ereniku, dhe Toplluha.
Zona të pritura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësi	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, si i mesëm deri në i lartë (Drini i Bardhe, Ereniku, dhe Toplluha në zonat ku gazsjellësi kalon këta lumenj.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo.

Gazsjellësi Gjakova – Peja

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Gjakovë– Pejë
Intensiteti maksimal sizmik	VI - VII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit)) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.14 - 0.16
Vatrat aktive	Vatra më e afërt aktive ndodhet rreth 850 m perëndim të Decanit (me magnitudë maksimale të vlerësuar në 6.5 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të lumenjve Lumebardhi i Lloqanit, Lumbardhi i Decanit and Perroi i Behovcit.
Zona të pritura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, si i mesëm deri në i lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo.

Gazsjellësi Pejë – Istog

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Peja – Istog
Intensiteti maksimal sizmik	VI° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.14
Vatrat aktive	Vatra më e afërt aktive ndodhet rreth 2.6 km në jug të Istogut (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.5 (mW)) dhe rreth 1 km lindje të Pejës (me magnitutë maksimale të vlerësuar 6.5 (mW))
Depozita të pritura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të lumenjve Lumbardhi i Pejes, Drini i Bardhe dhe Istog
Zona të pritura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të pritura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, si i mesëm deri në shumë i lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo

Gazsjellësi Istog – Skenderaj

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Istog – Skenderaj
Intensiteti maksimal sizmik	VI° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.14
Vatrat aktive	Linja e gazsjellësit kryqëzohet me vatra aktive dy herë në Lindje të Istogut (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.5 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, brenda depozitave lumore kuaternare të lumenjve Istog, degë të Drinit të Bardhë dhe Klinës dhe degëve të saj.
Zona të pritura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazsjellësit kryqëzohet me zonën në përëndim të Skenderajt që kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Po, në jug të Cerkolezit është regjistruar një rrëshqitje, e cila ndodhet afërsisht 260 në veri të boshtit të gazsjellësit.
Zona të pritura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, si i mesëm deri në shumë i lartë, kryesisht me mundësi mesatare të përmbytjes.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo.

Gazsjellësi Prishtina 1 – Drenas

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Prishtina 1 – Drenas
Intensiteti maksimal sizmik	VII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.04 - 0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.10 – 0.12
Vatrat aktive	Vatra më e afërt aktive ndodhet 3.7 km nga boshti i gazsjellësit afër qytetit Drenas (me magnitutë maksimale të vlerësuar 6.0 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Drenica.
Zona të pritura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazsjellësit kryqëzohet me zonën në përëndim të Drenasit që kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi shumë të ulët deri mesatare të përmbytjes.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Zona më e afërt e eksploatimit aktiv (Korroticë) në përëndim të Drenasit ndodhet përafërsisht 300 m në veri të boshtit të gazsjellësit.

Gazsjellësi Drenas – Skenderaj

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Drenas – Skenderaj
Intensiteti maksimal sizmik	VI - VII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.12 – 0.14

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Drenas – Skenderaj
Vatrat aktive	Gazsjellësi kryqëzohet me vatrën aktive në jug të Skenderajt (me magnitutë maksimale të vlerësuar 6.0 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Klina dhe degës së lumit Drenica
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazsjellësit kryqëzohet me zonën në përëndim të Skënderajt që kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	No
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellwsit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi mesatare të përmbytjes.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Zona më e afërt e eksploatimit aktiv (Klina Poshtme) lindje të Skenderaj ndodhet rreth 220 m lindje të boshtit të gazsjellësit.

Gazsjellësi Skenderaj – Mitrovicë

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Skenderaj – Mitrovica
Intensiteti maksimal sizmik	VI - VII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.12 – 0.14
Vatrat aktive	Gazsjellësi kryqëzohet me vatrën aktive në verilindje të Skenderajt (me magnitutë maksimale të vlerësuar 6.0 (mW)) dhe ndodhet ne afërsi të vatrës aktive në JL të Mitrovicës (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.0 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Klina.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazsjellësit kryqëzohet me zonën në veri të Skënderajt dhe jug të Mitrovicës që kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Po, në veri të Skenderajt gazsjellësi kalon në distancë mbi 380 m në veri të rrëshqitjes së regjistruar.
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi shumë të ulët deri të lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Zona më e afërt e eksploatimit aktiv (Klina Poshtme) JL të Skenderaj ndodhet rreth. 620 m në përëndim të boshtit të gazsjellësit.

Gazsjellësi Mitrovicë – Vushtrri

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Mitrovica – Vushtrri
Intensiteti maksimal sizmik	VI° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.12
Vatrat aktive	Gazsjellësi kryqëzohet me vatrën aktive JL të Mitrovicës (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.0 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Sitnica.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazjellwsit kryqëzohet me zonën në JL të Mitrovicës dhe VP të Vushtrrisë që kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi mesatare të përmbytjes.

Aërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo

Gazsjellësi Krushe e Madhe – Rahovec

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Krushe e Madhe – Rahovec
Intensiteti maksimal sizmik	VII - VIII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06 – 0.08
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.16
Vatrat aktive	Jo
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Drini i Bardhe.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi mesatare deri të lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo

Gazsjellësi Ferizaj – Gjilan

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Ferizaj – Gjilan
Intensiteti maksimal sizmik	VIII - IX° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.14 – 0.16
Vatrat aktive	Gazsjellësi kryqëzohet me shkarjen aktive në jug të Gjilanit me magnitutë maksimale të vlerësuar 6.5 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumit Morava e Binces dhe Livoq dhe degëve të tyre.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi të ulëta deri të lartë, kryesisht të mesme
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Zona më e afërt e eksploatimit aktiv (Devaje) në jug të Devajes ndodhet rreth 120 m në jug të boshtit të gazsjellësit.

Gazsjellësi Prishtinë – Podujevë

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Prishtinë – Podujevë
Intensiteti maksimal sizmik	VI - VIII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.04
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.1
Vatrat aktive	Linja e gazsjellësit është në afërsi të vatrës aktive, në përëndim të Obiliqit (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.0 (mË)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, depozitat lumore kuaternare të lumenjve Sitnica, Llap dhe Dubnicë.

Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Po, linja e gazsjellësit kryqëzohet me zonën në të Obiliqit kategorizohet si e prirur ndaj rrëshqitjes së dheut
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kryesisht kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi të mesme deri të lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Jo

Gazsjellësi BVS Hani i Elezit deri në Sharrcem

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	BVS Hani i Elezit to Sharrcem
Intensiteti maksimal sizmik	VIII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.06
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.16
Vatrat aktive	Jo
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Jo
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kryesisht kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi shumë të ulët të përmbytjes.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Zona në jug të Hanit të i Elezit afër skajit JL të zonës aktive të eksploatimit (Hani i Elezit).

Gazsjellësi Prizren – kufiri ALB/KOS

Lloji i gjeorrezikut / Gazsjellësi	Prizren – Kufiri ALB/KOS
Intensiteti maksimal sizmik	VI - VII° e shkallës MCS
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (95 periudha e kthimit) Vs30 ≥ 800 m/sec	0.08
Rreziku sizmik – Vlerat PGA (475 periudha e kthimit) (Vs30 ≥ 800 m/sec)	0.16 – 0.2
Vatrat aktive	Linja e gazsjellësit është mes dy vatrave aktive (me magnitudë maksimale të vlerësuar 6.5 dhe 6.6 (mW)).
Depozita të prirura ndaj lëngëzimit	Po, në mënyrë sporadike në depozita kuarternale të degëve të Drinit të Bardhë.
Zona të prirura ndaj rrëshqitjes së dheut	Jo
Rrëshqitje të regjistruara në afërsi të boshtit të gazsjellësit	Jo
Zona të prirura ndaj përmbytjeve	Terreni përgjatë linjës së gazsjellësit kryesisht kategorizohet, në raport me mundësinë e përmbytjeve, me mundësi shumë të ulët shumë të lartë.
Afërsia me aktivitete minerare (gurthyes)	Linja e gazsjellësit, në veri të Zhurit kalon direkt mbi gurthyes aktiv.


4.6 - Ujërat

Sipërfaqa topografike e ujëmbledhësve të Kosovës është 11,645 km^2, derisa akumulimi ekzistues arrin 569,690.00 m^2. Lumenjtë me fluksin më të madh vjetor gjenden në luginën e e Drinit të Bardhë në Rrafshin e Dukagjinit.

Në terma hidrografikë, Kosova ndahet në 4 pellgje ujore kryesore:

- Drini i Bardhë
- Ibri
- Morava e Binçës
- Lepenci

FIGURA 20 – ZONAT E PELLGJEVE UJORE NË KOSOVË



Veçoritë e lumenjve kryesorë në Kosovë paraqiten në tabelën në vijim:

TABELA 5 – VEÇORITË E LUMENJVE

Lumi	Sipërfaqa (km^2)	Gjatësia (m)	Rrjedha (m3/s)	Rrjedha vjetor 106/m3	Mesatarja e reshjeve (mm)
Drini i Bardhë	4340.14	110.7	61.7	409.8	900
Sushica	49.4	17.25	N/A	N/A	1150
Lumbardhi i Pejës	464.8	54	10.21	200.66	1168
Lumbardhi i Deçanit	259.3	53	7.84	152.46	1530
Ereniku	519.3	51.74	12.16	383.03	1515
Istogu	405.3	19.74	6.98	N/A	1200
Klina	458.7	72.12	2.8	65.52	750
Mirusha	336.7	37	1.6	N/A	700
Toplluha	495	34.5	3.44	N/A	1000
Lumbardhi i Prizrenit	247.8	36.07	6.49	147.74	960
Plava, Restelica	341.86	22.12	5.25	165.06	1080
Ibri	4044.21	89.5	36.4	1148	782
Sitnica	291.2	78	13.94	439.11	690
Morava e Binçës	1564	76	8.7	330	736
Kriva Reka	640.7	44.5	4.43	229.1	736
Lepenci	653	50	8.4	139.55	912
Nerodimja	209.4	38.5	N/A	N/A	750

Veçoritë e shtretërve të lumenjve kryesorë në Kosovë paraqiten në tabelën në vijim:

TABELA 6 – VEÇORITË E SHTRETËRVE TË LUMENJVE

Nr.	Pellgu	Stacioni	Lumi	Qmin	Q Mesatare	Qmax
1	DRINI BARDHË	Berkovo	Istok	0.48	3.75	1.86
2		Drelaj	Bistrica e Pejes	0.32	4.20	83.50
3		Grykë	Bistrica e Pejes	0.46	5.95	194
4		Klina	Klina	000	1.49	49.20
5		Mirusha	Mirusha	0.02	1.21	23.30
6		Deçan	Bistrica e Deçanit	0.60	4.28	58.00
7		Rakovina	Ëhite Drin	0.80	24.64	358
8		Gjakova	Erenik	0.06	12.33	542
9		Piranë	Topluha	0.04	3.47	55.40
10		Gjonaj	Ëhite Drin	0.10	48.8	1118
11		Prizren	Bistrica e Prizrenit	0.03	4.47	424
12	IBRI	Glogovac	Drenica	0.02	1.52	32.80
13		Lluzhan	Llapi	0.90	5.01	63.80
14		Nedakovc	Sitnica	0.50	13.62	328
15		Milloshevë	Llapi	0.00	4.48	82.70
16		Prelez	Iber	0.80	13.39	452.80
17		Leposavić	Iber	0.50	30.85	667
18	MORAVA BINQËS	Konçul	Morava	0.03	9.21	1012
19		Domarovc	Lumi Kriva	0.2	2.6	30.8
20		Vitina	Morava	0.05	1.06	18.70
21	LEPENCI	Kaçanik	Nerodimja	0.15	4.17	17.50
22		Hani Elezit	Lepenci	0.10	10.49	184

Brenda territorit të Kosovës janë ndërtuar 6 rezervuarë.

Veçoritë e rezervuarëve në Kosovë paraqiten në tabelën më poshtë.


TABEL 7 – VEÇORITË E REZERVUARËVE

Reservuari	Lumi	Sipërfaqa e ujëmbledhësit (km^2)	Vëllimi total x 10^6 m^3	Ujitje	Ujë i pijshëm	Industri
Gazivoda	Iber	1060	390	2000 ha	Po	Po
Batllava	Batllava	226	30	Jo	Po	Po
Badovci	Gracanica	103	26.4	Jo	Po	Po
Livoci	Livoc	53.6	-	Jo	Jo	Jo
Radoniqi	Perrue	130	116.6	1000 ha	Po	Jo
Prilepnica	Prelepnica	62	-	Jo	Po	Jo

Rajoni alpin ka një biodiversitet shumë të pasur dhe të llojllojshëm për shkak të topografisë së tij komplekse, mikroklimës dhe habitateve. Gati dy të tretat e bimëve në kontinentin europian janë prezent në rajonin bio-gjeografik alpin. Pyjet dhe barishtet gjysmë-natyrore mbështjellin pjerrtësirat më të ulëta të cilat janë të pasura në diversitet të specieve të ndikuar nga tranzicioni me biorajone gjeografike tjera dhe prezencën e njeriut, mirëpo me rritjen e lartësisë mbidetare, pemët bëhen më të rralla dhe kalon në komunitetin e barishteve alpine, cungave e shkurreve. Kjo zonë është bërë strehim i rëndësishëm për shumë spefie shtazore që më së shumti ndodh në ultësira. Mishngrënësit e mëdhenj (ujqit, arinjtë, rrëqebulli) dhe grabitqarët (shqiponjat, fajkonjtë, hutat) janë tërhequr nga kjo zonë për shkak se trazimi nga njeriu është më i kufizuar. Specialistët gjitarë alpinë si miu i borës (*Microtus nivalis*) dhe cjapi alpin (*Capra ibex*) ekzistojnë po ashtu. Përve kësaj, disa zogj po ashtu janë adaptuar rajonit duke përshirë ptarmiganin (*Lagopus lagopus*), çafkat (*Pyrrhocorax pyrrhocorax*) dhe zambakun, (*Charadrius morinellus*). Rajoni alpin është po ashtu i pasur në pakurrizorë, veçanërisht brumbujt dhe fluturat.

FIGURA 33 – RAJONET BIOGJEOGRAFIKE NË KOSOVË



Legend / Legjenda

Aboveground facilities / Objektet mbitokësore

Kosovo border / Kufiri i Kosovës

Gas pipelines / Gazsjellësi

Kosovo transmission branch pipelines / Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës

Kosovo transmission pipelines-gas ring / Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit

North Macedonia-Kosovo interconnection / Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë

Route ALB Border-Prizren / Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren

Bio-geographical regions / Rajoni biogjeografik

Alpine Bio-geographical Region / Rajoni Biogjeografik Alpin

Continental Bio-geographical Region / Rajoni Biogjeografik Kontinental

Ekosistemet kryesore dhe më të rëndësishme në Kosovë janë pyjet dhe tokat tjera pyjore, që përfshijnë 47.4 % të sipërfaqes së vendit (Tabela 4-26). Ekosistemet më të rëndësishme pyjore gjenden në malet më të larta të Kosovës në parqet nacionale Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.


TABELA 27 – LLOJET E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS

Klasët e tokës së përdorur	Sipërfaqa, ha	Sipërfaqa %
Pyll	481,000	44.7
Tokë tjetër pyjore	29,200	2.7
Tokë bujqësore	309,000	28.7
Barishte	161,400	15.0
Vendbanim	48,000	4.5
Ujë	5,200	0.5
Ujëra tjera	800	0.1
Totali	1,077,000	100

Burimi: Analiza e biodiversitetit të Kosovës (ABK), maj 2018

Biodiversiteti në Kosovë konsiderohet të jetë i pasur dhe i llojllojshëm, megjithëse deri më tani ende nuk ka një inventar gjithpërfshirës të monitorimit të biodiversitetit në Kosovë, me shumicën e studimeve dhe analizave të kryera individualisht nga projekte të ndryshme, institucione akademike apo OJQ. Sistemet ujore dhe ekosistemet në Kosovë janë të rrezikuar seriozisht, duke qenë të trajtuara si deponi mbeturinash nga banorët lokalë, dhe të ndotur nga industria. Për më tepër, nxjerrja e rërës dhe zhavorit në shtratet e lumenjve është e pa kontrolluar dhe jo stabile. Zonat e banuara në Kosovë për këtë arsye nuk konsiderohen të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit.

FIGURA 34 – BIODIVERSITETI I HABITATIT NË KOSOVË



Legend / Legjenda

- Aboveground facilities/Objektet mbitokësore

Gas pipelines/Gazsjellësi

- Kosovo transmission branch pipelines/Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës
- Kosovo transmission pipelines-gas ring/Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit
- North Macedonia-Kosovo interconnection/Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë
- Route ALB Border-Prizren/Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren

EUNIS

- C1 Surface standing waters/Ujërat e ndejura sipërfaqësor
- C2 Surface running waters/Ujëra sipërfaqësorë të rrjedhshëm
- D1 Raised and blanket bogs/Moqale të ngritura dhe moqale mbulesë
- D5 Sedge and reedbeds, normally without free-standing water/Shqira dhe kallamishte, normalisht pa ujë me qëndrim të lirë
- E1 Dry grasslands/Barishte të thata
- E2 Mesic grasslands/Barishte mesike
- E3 Seasonally wet and wet grasslands/Kullota të njoma sezonale dhe të njoma
- E4 Alpine and subalpine grasslands/Kullota alpine dhe subalpine
- F2 Arctic, alpine and subalpine scrub/Kaçuba arktike, alpine dhe subalpine
- F3 Temperate and Mediterranean-montane scrub/Kaçuba malore të buta dhe mesdhetare
- F5 Maquis, arborescent matorral and thermo-Mediterranean brushes/Makie (shkurre te qendrueshme), brusha matorale arboreshente dhe termo-mediterane
- FB Shrub plantations/Plantacione shkurresh
- G1 Broadleaved deciduous woodland/Tokë pyjore gjetherënëse gjethegjerë
- G3 Coniferous woodland/Tokë pyjore halore
- G4 Mixed deciduous and coniferous forests/Pyje të përziera gjetherënëse dhe halore
- G5 Lines of trees, small anthropogenic woodlands, recently felled woodland, early-stage woodland and coppice
- H2 Screes/Rrëpira
- H3 Inland cliffs, rock pavements and outcrops/Shkëmbinj të brendshëm, trotuarë shkëmbinjsh dhe pjesë të dala jashtë
- H5 Miscellaneous inland habitats with very sparse or no vegetation/ Habitate të ndryshme të brendshme me shumë pak apo fare vegjetacion
- I1 Arable land and market garden/Tokë e punueshme dhe kopsht tregu
- I2 Cultivated areas of gardens and parks/Sipërfaqet e kultivuara të kopshteve dhe parqeve
- J1 Buildings of cities, towns and villages/Ndërtesa qytetesh, qytezash dhe fshatesh
- J2 Low density buildings/Ndërtesa të densitetit të ulët
- J3 Extractive industrial sites/Zona industriale ekstraktuese
- J4 Transport networks and other constructed hard-surfaced areas/Rrjet transport dhe sipërfaqe tjera të forta ndërtimi
- J5 Highly artificial man-made waters and associated structures/Ujëra shumë artificiale të ndërtuara nga njeriu dhe strukturat përcjellëse
- J6 Waste deposits/Depozita mbeturinash

Source: EUNIS (https://eunis.eea.europa.eu/)

Tabela në vijim paraqet llojet e ndryshme të habitateve EUNIS brenda zonës tampon 200 + 200 m rreth gazsjellësave. Zona e secilit habitat të përfshirë brenda zonës tampon është kalkuluar në mënyrë të duhur. Lloji më i spikatur i habitatit në zonën përreth gazsjellësit është habitati bujqësor tip I1 tokë e punueshme dhe kopsht tregu i cili mbulon gati 44% të sipërfaqes. Barishtet, veçanërisht barishtet mesike E2 janë habitati i dytë më i zakonshëm i pranishëm në zonën me të gjerë të gazsjellësit që mbulon rreth 28% of it. Habitati i fundit më i rëndësishëm në zonën më të gjerë rreth gazsjellësit i përket llojit të habitatit pyjor G1 tokë pyjore gjetherënëse gjethegjerë që mbulon rreth 15.5% të zonës së projektit.

TABELA 28 – SIPËRFAQJA E LLOJEVE TË HABITATEVE EUNIS NË ZONËN 200 + 200 RRETH GAZSJELLËSIT

Llojet e habitatit	Sipërfaqa (ha)
C2 Ujëra sipërfaqësorë të rrjedhshëm	11.69
D1 Moqale të ngritura dhe moqale mbulesë	3.93
D5 Shqira dhe kallamishte, normalisht pa ujë me qëndrim të lirë	7.63
E1 Barishte të thata	189.94
E2 Barishte mesike	4366.54
E3 Barihte sezonalisht të lagëta dhe të lagëta	79.07
F5 Makie, brusha matorale arboreshente dhe termo-mediterane	5.78
FB Plantacione shkurresh	462.88
G1 Tokë pyjore gjetherënëse gjethegjerë	2424.18
G3 Tokë pyjore halore	1.58
G4 Pyje të përziera gjetherënëse dhe halore	2.44
G5 Vargje të pemëve, toka të vogla pyjore antropogjene, tokë pyjore rishtas e prerë, tokë pyjore në faza të hershme dhe shkurre	244.08
H2 Rrëpira	4.59
H3 Shkëmbinj të brendshëm, trotuarë shkëmbinjsh dhe pjesë të dala jashtë	0.38
H5 Habitate të ndryshme të brendshme me shumë pak apo fare vegjetacion	2.96
I1 Tokë e punueshme dhe kopsht tregu	6786.64
J1 Ndërtesa qytetesh, qytezash dhe fshatesh	74.88
J2 Ndërtesa të densitetit të ulët	344.90
J3 Zona industriale ekstraktuese	98.77
J4 Rrjet transport dhe sipërfaqe tjera të forta ndëritimi	370.87
J5 Ujëra shumë artificiale të ndërtuara nga njeriu dhe strukturat përcjellëse	0.92
J6 Depozita mbeturinash	2.92
Totali i përgjithshëm	**15,487.55**

Shpellat dhe burimet karstike janë prezentë në Kosovë të mbuluara me shkëmbinj të tretshëm si gurët gëlqerorë. Të dhënat mbi shpellat në Kosovë janë shumë të pakta. Mbrojtja e shpellave në Kosovë rregullohet me Ligjin mbi Mbrojtjen e natyrës.

Ekzistojnë gjashtë shpella të mbrojtura në Kosovë: Shpella e Mermertë në Gadime, shpellat në Radavc, Gllanasellë, Baicë dhe Kishnareke. Veç këtyre, disa shpella tjera janë propozuar për mbrojtje (Gryka e Madhe, Pjetërshticë, Bresalc, Ponor etj). Shpella më e njohur në Kosovë është Shpella e Mermertë në Gadime.

Shumë pak të dhëna ka mbi banorët në shpellat dhe burimet karstike insektet nëntokësore, krustacet, diplopodët, mollusqet, etj. Sidoqoftë, disa specie të nëndheshme të reja për shkencën janë përshkruar kohëve të fundin në Kosovë, si mollusqet e nëndheshme të familjeve Moitesieride dhe Hidrobide (Grego et

al, 2017). Lakuriqët i përdorin rregullisht shpellat si vende hibernimi dhe koloni maternale, mirëpo nuk ka të dhëna nëse lakuriqët përdorin shpellat karstike në Kosovë.

Ekosistemet ujore

Sistemet ujore të Kosovës përbëhen nga liqenet akullnajore, livadhet e lagështa, burimet, përrenjtë, pumenjtë, rezervuaret artificiale, bazenet e peshqve dhe bazenet e përkohshme. Kosova ndahet në 4 pellgje kryesore të lumenjve: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci. Gazsjellësit e propozuar do të kalojnë një total prej 55 vijash ujore duke përfshirë lumenjtë: Sitnicë, Llap, Klinë, Kaçandoll, Drenicë, Burim, Lumbardhi i Pejës, Drini i Bardhë, Lumbardhi i Deçanit, Lumbardhi i Prizrenit, Nerodime, Ereniku, Krena dhe Llukac. Liqenet natyrore të Kosovës kryesisht gjenden në lartësi më të mëdha, në dy parqet kombëtare dhe shumica janë liqene akullnajore.

Një nga tokat e lagëta më të rëndësishme në pjesën qëndrore të Kosovës është zona e lagësht e Hencit. Kjo ishte krijuar në mënyrë artificiale në fund të viteve 1960 në vendin e bashkimit të përrenjve Magurë dhe Vrellë, degë të lumit Sitnica. Qëllimi ka qenë të krijohet një habitat ku do të mund të kultivohej krapi i zakonshëm (Cyprinuscaprio). Me një sipërfaqe prej 74 hektarësh, ligatina e Hencit është e pasur me biodiversitet. Në një studim të vitit 2010 (Sherifi etj., 2010) janë regjistruar 41 specie të zogjve, katër specie të peshqve, tri specie të zvarranikëve, dy ujëtokësorë, dy gjitarë dhe 28 specie të bimëve vaskulare. Ligatina është një zonë e rëndësishme për ushqimin dhe shtimin e një numri të banuesve zi zogjve shtegtarë, dhe në vitin ishtë caktuar si Zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve (Ligatina e Hencit/ Radevës). Kjo zonë e mbrojtur shtrihet 123 m në perëndim të gazsjellësit të interkoneksionit Maqedoni-Kosovë menjëherë poshtë zonës së objektit sipërfaqësor PTS/PRMS Prishtina 1.

Në Kosovë janë bërë pak studime mbi ekosistemet ujore, dhe këto kryesisht janë fokusuar në zonën e Parkut Kombëtar Male e Sharrit. Kosova është një nga shtetet më së paku e hulumtuar në Gadishullin Ballkanik sa i përket diversitetit të peshqve dhe nuk janë kryer studime mbi vlerën ekonomike dhe të biodiversitetit të sistemeve ujore. Kjo mungesë e informacionit ndikon në përdorimin jo stabil të burimeve ujore, veçanërisht të hidrocentraleve. Ekosistemet ujore dhe potenciali i tyre për të kontribuar në shërbimet mjedisore po ashtu kërcënohen nga mënyra e trajtimit të mbeturinave dhe ujërave të zeza si dhe ndotjes industriale (KBA, 2018).

Pyjet

Pyjet mbulojnë rreth 45% të sipërfaqes së Kosoës dhe janë burimi kryesor i mirëqenies ekonomike, sociale dhe mjedisore. Pyjet janë rregullatorët natyrorë të klimës; ato ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë së ujit dhe ajrit dhe e mbrojnë tokën nga erozioni. Ato po ashtu veprojnë si thithës të dioksidit të karbonit dhe janë një nga furnizuesit kryesorë me oksigjen atmosferik. Pyjet (druri) konsiderohen burim i ripërtritshëm dhe mund të përdoren për qëllime industriale. Ekosistemet pyjore përmbajnë një numër të specieve bimore dhe shtazore që janë të rëndësishme jo vetëm për biodiversitetin e planetit, por po ashtu edhe ofrojnë vlera mjekësore dhe ushqyese për njerëzit. Ndikimi njerëzor në pyje është shumë i theksuar, prerja e pakontrolluar mund të çojë në shpyllëzim, i cili pastaj do të ketë efekte negative në mjedinin; ndikime të tilla si klimë e parregullt, ulje e biodiversitetit, erozion, etj.

Inventari pyjor i vitit 2003 ka llogaritur që rreth 60% e pyjeve janë pronë publike dhe 40% janë në pronësi private; nga kjo po ashtu llogaritet që 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private ndikohen nga aktivitetet e jashtëligjshme.


Pyjet e Kosovës ndahen në pyje të larta, të ulëta, shkurre dhe pyje të degraduara. Shumica e pyjeve përbëheet nga pyjet e ulëta 42%, me përqindjen më të vogël prej 15% që janë pyje të larta. Pyjet gjethpendore mbulojnë 90% të sipërfaqes të llojit lis dhe ah.

Sekosistemi pyjor i dominuar nga lisi gjendet në pjesën qendrore kodrinore të Kosovës. Speciet dominuese këtu janë lisi (*Quercus petreae*), lisi turk (*Quercus cerris*), lisi pubeshent (*Quercus pubescens*), lisi italian (*Quercus frainetto*), dhe gështenja (*Castanea sativa*). Në pjesën jug-përëndimore të Kosovës, në Koritnik dhe Pashtrik,

një zonë e dalluar për numrin e lartë të specieve bimore endemike, relikte dhe endemik-relikte, speciet dominuese në ekosistemin pyjor janë lisi maqedon (*Quercus trojana*). Në lartësitë mbi pyjet halore, ekosistemet pyjore dominohen nga ahu (*Fagus moesiacae*).

Në Bjeshkët e Nemuna, Koritnik, dhe në Malet e Sharrit, dominojnë forma pyjore me pisha maqedone [Ballkanike] (*Pinus peuce*) dhe pisha boshnjake (*Pinus cheldreichi*) që kanë rëndësi të madhe shkencore për shkak të endemizmit të tyre. Zonat më të larta pyjore, veçanërisht në Bjeshkët e Nemuna, dominohen nga pisha malore (*Pinus mugho*) na lartësi deri 2000 m. Megjithëse druri është i cilësisë së dobët, pisha malore është e rëndësishme për karakteristikat shëndetësore si dhe si bimë industriale, e po ashtu edhe për mbrojtje nga erozioni në shpatet e larta të pjerrëta. Në zonat sub-alpine dhe alpine gjenden ekosisteme shkurrore te dominuara nga dëllinja (*Juniperus nana*), borovnica (*Vaccinium myrtillus, V. uliginosom*), dhe bimë barishtore shumëvjeçare duke përfshirë shumë bimë medicinale dhe aromatike (MAPs) (Millaku, pa datë).

FIGURA 35 – FORMA SILVIKULTURORE E MBULUESËD PYJORE DHE LARTËSISË E PEMËVE KUNDREJT RRJETIT TË GAZSJELLËSIT



LEGEND/LEGJENDA

Kosovo border/Kufiri i Kosovës

Gas_pipelines/Gazsjellësi_novo

- Kosovo transmission branch pipelines /Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës
- Kosovo transmission pipelines-gas ring /Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit
- North Macedonia-Kosovo interconnection /Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë
- Route ALB Border-Prizren /Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren

silvicultural form/formë silvikulturore

- thicket and shrubbery/gëmusha dhe shkurre
- coppices/cungishte
- high forests/pyjet e larta

tree height/lartësia e pemës

- low/të ulëta
- high/lartë

Flora dhe Fauna

Kosova shtrihet në qendër të Gadishullit Ballkanik, dhe ndahet në tri zona klimatike, kontinentale, sub-mediterane dhe alpine. Kjo, kombinuar me faktorët e saj gjeomorfologjikë dhe hidrologjikë, rezulton në një biodiversitet të pasur. Herbariumi i Fakultetit të Shkencave Natyrore (Universiteti Prishtinës) ka konfirmuar 1,800 specie të bimëve vaskulare (derisa një total prej 2,500 parashihet të ndodh), që përfaqëson 20% të florës europiane në një zonë e cila është më pak se 2% e territorit të ballkanit. Më shumë se 200 specie endemike të bimëve (10% e endemikeve të Ballkanit) janë regjistruar në Kosovë dhe specie steno-endemike (që gjenden vetëm në Kosovë, e bëjnë vendin një nga gjashtë qendrat e endemizmit floristik europian (Stevanovic etj., 1995, Veselaj, 2012). Hulumtuesit po ashtu kanë regjistruar 68 specie bimësh relikte (Mustafa B., 1998), 400 specie të algave, dhe 104 specie të kërpudhave.

Ekologët e vegjetacionit lokal kanë identifikuar dhe kategorizuar bashkësitë e bimëve, të cilat janë grupe që në mënyrë tipike rriten përgjatë një peizazhi për shkak të kërkesave të ngjashme për rritje.

Në rajonet e dominuara me shkëmbinj serpentinë (p.sh. në Luginën e Ibrit dhe përmes Koznicës e Goleshit në jugpërëndim), gjenden dy lloje të specieve të bimëve endemike për Kosovë dhe Shqipëri: dëllinja me gjëmba (*Juniperus oxycedrus*) dhe forsitia (*Forsythia europae*). Flora e kësaj zone të masivit serpentiv është e pasur në specie të rralla (Millaku, 2008).

Në parkun kombëtar Malet e Sharrit gjenden 77 specie të bimëve të rëndësisë ndërkombëtare; 26 specie janë të përfshira në Listën e Kuqe Europiane (UNECE, 1991); dhe 32 specie në Listën e Kuqe të IUCN 1997 (Veselaj, etj., 2015). Parku Kombëtar Malet e Sharrit ka 314 njësi bimore, duke përfshirë 180 bashkësi bimësh, 16 nën-bashkësi, 59 lidhje, 7 nën-lidhje, 32 urdhëra, dhe 20 klasa (Mustafa etj., 2013).

Një numër i bashkësive bimore tashmë janë të kërcënuara për shkak të ndikimit njerëzor. Më të kërcënuarat janë pyjet e lisit (*Quercus spp*.) në një lartësi mes 600 dhe 800 metera të cilat priten në mënyrë të pa qëndrueshme për dru zjarri dhe pastrohen për bujqësi. Dy specie të rralla të pishave sub-alpine (*Pinus Peuce* dhe *P. Heldereichii*) janë kufizuar në zona të vogla në shpatet e sipërme të maleve të larta dhe janë të ndjeshme ndaj zjarreve. Bashkësi të rralla malore të kufizuara në tokat që derivojnë nga shkëmbinjtë serpentinë ultrabazikë përmbajnë nivele të larta të bimëve endemike dhe janë po ashtu të kërcënuara për shkak të shpërndarjes së tyre të kufizuar. *Forsythia europaea* është një relikt endemik dhe bima më e njohur e këtyre bashkësive. Livadhe të lagështa sezonalisht kanë bashkësi të dallueshme bimore të cilat kërkcënohen nga shndërrimi në bujqësi.

Faktorët që krijojnë kushte të favorshme për diversitet bimor në Kosovë po ashtu shpjegojnë nivelin e lartë të diversitetit shtazor brenda kësaj zone relativisht të vogël. Diversiteti shtazor i Kosovës përbëhet nga 130 specie të insekteve (ka zbrazëtirë informacioni mbi diversitetin e insekteve në Kosovë) 30 specie peshku, 14 specie ujtokësorësh, 14 specie zvarranikësh, 225 specie të shpendëve rezident dhe migrant, dhe 46 specie gjitarësh.

Në malet e larta të Kosovës, janë shënuar popullime të gjitarëve më të mëdhenj me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Rruqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër "kamois" (*Rupicapra rupicapra*), macja e egër (*Felis silvestris*), ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), dhe dreri (*Cervus elaphus*). Përveç drerit, popullimet e këtyre specieve janë të vogla dhe të shpërndara në zona të largëta malore. Gjitarët e vegjël janë mirë të përfaqësuar në Kosovë duke përfshirë shumë specie brejtësish dhe anëtarë të familjes së buklës, si vidra e ujit e cila është e rrezikuar *(Lutra lutra*). Disa specie të lakuriqëvve jetojnë nëpër shpellat e Kosovës, ose në mënyrë të përhershme, ose sezonale.

Në Kosovë ka shumë specie të rëndësishme të zogjve në Listën e Kuqe të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) si dhe në listën e kuqe botërore. Dy lloje të shqiponjave (*Aquila heliaca* dhe *Aquila chrysartos*) dhe një fajkua (*Falco naumanni*) janë zogj të mëdhenj grabitqarë që jetojnë kryesisht në male. Huta grifon (*Gyps fulvus*) tani është shumë e rrallë nëse jo e zhdukur lokalisht. Zogjtë e ujit të cilët dikur janë parë rregullisht, janë bërrë shumë të rrallë apo kanë munguar fare në dekadat e fundit, të tilla si Shpatulla Eurasiane (*Platalea leucorodia*), e kjo mendohet të jetë shkaktuar nga trazimet njerëzore dhe tharja e tokave të lagështa.

Ujëtokësorët dhe zvarranikët kanë marrë më pak vëmendje shkencore sesa grupet tjera, mirëpo njihen lloje të zakonshme të specieve të bretkosave, salamanderit, hardhucës, gjarpërit, breshkave. Salamanderi alpin (*Salamandra atra*) dhe alpin (*Triturus alpestris*) të cilët janë të rrezikuar rajonalisht gjenden vetëm në disa nga liqenet e larta.

Diversiteti dhe popullimi i peshqve besohet të jetë reduktuar në mënyrë drastike në shumicën e lumenjve si rezultat i nxjerrjes së rërës dhe zhavorit dhe ndotjes nga mbeturinat shtëpiake dhe ato industriale. Trofta (Salmonidae) është peshku më i zakonshëm në Kosovë; është e ndjeshme ndaj trazimeve në shtratin e lumit dhe ndotjes dhe tani jetojnë kryesisht në zgjatime të lumenjve mbi qendrat e populluara dhe ato industriale. Salmoni i Danubit (*Hucho hucho*) është po ashtu i pranishëm, mirëpo popullsia e tij është reduktuar, dhe migrimi i tij historik është trazuar për shkak të ndërtimit të digave dhe shkatërrimit të shtretërve të vezëve. Speciet e peshkut të familjes së krapit dhe barbunit janë po ashtu të pranishme në lumenj. Njala europiane (*Anguilla anguilla*) është specia e vetme e rrezikuar në mënyrë kritike që gjendet në lumin Drini i Bardhë River, e cila më së shumti kërcënohet nga ndërtimi i digave.

Nëntëmbëdhjetë grupe të gjetura në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna janë listuar në Listën e specieve të rrezikuara të IUCN; Në Bjeshkët e Nemuna gjendet rrëqebulli i Ballkanit, i rrezikuar globalisht, (*Lynx lynx balca*nicus), një specie e rëndësisë shumë të madhe (Veselaj atj. 2013); dhe siç u përmend më sipër, 129 specie të fluturave (Lepidoptera), që e bëjnë territorin e parkut kombëtar njërin nga zonat më të pasura të Europës për flutura (MEPH, 2013).

Speciet invazive

Një numër i specieve invazive mund të gjendet në zonën më të gjerë të gazsjellësve. Disa specie invazive që janë të zakonshme në këtë zonë janë renditur më poshtë.

TABELA 29 – LISTA E SPECIEVE INVAZIVE

GRUPI	FAMILJA
Speciet bimore	
Ambrosia artemisiifolia L.	Asteraceae
Datura stramonium L.	Solanaceae
Robinia pseudoacacia L.	Fabaceae
Amorpha fruticosa	Fabaceae
Fallopia japonica	Polygonaceae
Helianthus tuberosus	Asteraceae
Speciet e peshqve	
Oncorhynchus mykiss (Ëalbaum, 1792)	Salmonidae
Carassius gibelio (Bloch, 1782)	Cyprinidae
Pseudorasbora parva (Temminck & Schlegel, 1842)	Cyprinidae
Ctenopharyngodon idella (Valenciennes, 1844)	Cyprinidae
Lepomis gibossus (Linnaeus, 1758)	Centrarchidae

Burimi: Raporti ESENIAS 2015

Gjendja e sektorit të pylltarisë në Kosovë është përmirësuar pas përfundimit të projektit të OBU (FAO) "Zhvillimi i sektorit të pylltarisë në Kosovë" i zbatuar gjatë viteve 2011 - 2017. Projekti ka prodhuar disa rezultate të rëndësishme si përpilimi i Programit Dhjetë Vjeçar për Pyllëzimin dhe Programit Kombëtar për Shëndetin e Pyllit, një studim i gjerë mbi biomasën drunore, studimin e përdorimit të energjisë së drurit dhe potencialit të tij në zbutjen e ndryshimit klimatik dhe shumë tjera[9].

[9] *FAO: Developing the Forestry Sector in Kosovo, http://www.fao.org/3/ca4737en/CA4737EN.pdf (accessed 17 February 2022)*

Fotografitë satelitore nga analiza e misionit Sentinel-2[10] kanë treguar se shumica e pyjeve të formës më të lartë silvikulturore (pyjet e larta dhe cungishtet me biomasë më të madhe) gjenden në skajet veri përëndimore, lindore dhe jugore të vendit, derisa format më të ulëta silvikulturore (cungishtet me më pak biomasë, gëmushat dhe shkurret) më së shumti gjenden në pjesën e mesme, ngjitur me pjesën më të madhe të zonës bujqësore të vendit. Siq është treguar në FigurA 35, është evidente që shumica e sipërfaqes pyjore gjendet më larg nga linjat e gazsjellësve të projektuar dhe që pyjet e çmueshme të larta nuk do të ndikohen nga implementimi i ZHG.

4.8.2 - Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura janë shpallur si të tilla me qëllim të mbrojtje dhe kujdesit për biodiversitet, natyrë, karakteristika natyrore dhe trashëgimisë kulturore, si dhe për ofrimin e menaxhimit efikas përmes metodave ligjore dhe mënyrave tjera. Ligji mbi mbrojtjen e natyrës, Neni 17 i rendit objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur:

a) Hulumtimi shkencor
b) Mbrojtja e botës së egër, habitateve, dhe ekosistemeve,
c) Mbrojtja e diversitetit gjenetik
d) Mbrojtja e shërbimeve mjedisore
e) Mbrojtja e karakteristikave specifike të natyrës dhe trashëgimisë kulturore
f) Turizmi dhe rekreacioni
g) Edukimi dhe informimi publik
h) Përdorimi i qëndrueshëm i resurseve
i) Mbrojtja e karakteristikave kulturore dhe tradicionale

Zonat natyrore të mbrojtura në Kosovë përfshijnë përafërsisht 11,6 % të territorit të vendit, duke përfshirë dy parqe kombëtare, 38 monumente natyrore, dhe dy peizazhe të mbrojtura, të klasifikuar sipas kritereve të IUCN. Pjesa më e madhe e kësaj zone ndahet mes parqeve kombëtare Malet e Sharrit dhe Bjeshket e Nemuna.

Parku Nacional Malet e Sharrit ligjërisht ishte krijuar në vitin 1986 nga Kuvendi Krahinor i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda ish Republikës Jugosllave. Në vitin 2002 Parku Nacional i Sharrit ishte nominuar për Listën e Trashëgimisë Botërore, mirëpo ky nominim ende është i suspenduar. Në vitin 2013, brenda Qeverisë së re, Parku është zgjeruar nga sipërfaqa fillestare prej 39,000 ha në sipërfaqen e tanishme prej 53,469 ha. Malet e Sharrit ndodhen në kufirin jugor të Kosovës. Parku është i famshëm për vlerat e tij bimore, shtazore, ekologjike, turistike, rekreacionale dhe kulturore. Nga flora dhe fauna e llojllojshme e tij, 86 e këtyre specieve janë deklaruar si specie të rëndësishme kombëtare, 26 konsiderohen të rrezikuara, dhe 32 janë përfshirë në Librat e Kuq Europianë të specieve të kërcënuara.

Parku Nacional Bjeshkët e Nemuna ishte krijuar në vitin 2013; gjendet në Alpet Shqiptare në anën përëndimore të Kosovës, ngjitur me Malin e Zi, dhe përfshin një sipërfaqe prej 62,488 ha duke e bërë hapësirën më të madhe të mbrojtur të Kosovës. Ajo po ashtu është propozuar si Rezervat i Biosferës (sipas programit të UNESCO Njeriu dhe Biosfera). Karakteristika më e rëndësishme gjeologjike e parkut është Gryka spektakolare e Rugovës e gjatë 6 kilometra deri në lumin Mbushtria, që lidh ultësirat me zonën sub-alpine. Peizazhi malor i parkut përfhsin shumë maja të larta me disa kalime 2,500 m, si dhe nëntë liqene panoramike alpine. Zona është e pasur me biodiversitet bimor dhe shtazor dhe po ashtu ka një potencial të madh rekreacional sa i përket skijimit, shëtitjes, ecjes malore, dhe ngjitjes në mal dhe shkëmbinj, dhe raftingut në ujëra të bardha.

Për shkak të këtyre vlerave të larta të biodiversitetit, të dy parqet nacionale janë identifikuar si Zona të Rëndësishme Bimore (IPA), Zona rajonalisht të rëndësishme të zogjve (IBA), dhe Zona Primare të Fluturave (PBA) (Mustafa e tjerë., 2011, MMPH, 2013).

---

[10] *Althogether four Sentinel-2 satellite images ëere used in the analysis, tëo of them dated 25 July 2021 and the remaining tëo 30 July 2021.*

Monumentet natyrore dhe Peizazhet e mbrojtura janë shpallur nga Kuvendet Komunale dhe menaxhohen nga pushteti komunal. Momentalisht janë 38 monumente natyrore që mbulojnë një sipërfaqe totale prej 4,867 ha dhe dy peizazhe të mbojtura në sipërfaqe 1,681 ha. Shumica e monumenteve ekzistuese janë shpella, karakteristika ujore, apo drunjë të veçantë që kanë rëndësi lokale për shkak të madhësisë, së tyre, formës karakteristike, apo historisë. Dy peizazhet e mbrojtura janë Ujvara e Mirushës dhe Malet e Gërmisë. Ujvarat e Mirushës janë të mbrojtura për shkak të pamjes panoramike të ujvarave dhe liqeneve si dhe për shkak të diversitetit të bimëve. Malet e Gërmisë afër Prishtinës janë të mbrojtura për shkak të diversitetit bimor (610 specie të bimëve të larta dhe 83 specie të kërpudhave) si dhe shumë specie të bimëve të rralla.12 Komuna, siç duket të motivuara nga krenaria lokale dhe shpresa për të tërhequr turistë, kanë paraqitur 150 propozime të reja për monumente natyrore. Shumica e monumenteve kombëtare ekzistuese janë deklaruar në vitet 1980. (Vlerësimi i biodiversitetit, 2003).

Një zonë tampon 200 + 200 m është krijuar rreth gazsjellësve dhe sipërfaqa më e gjerë e objekteve sipërfaqësore janë shënuar dhe listuar.


Të gjitha zonat e mbrojtura dhe pikat e referencës për gazsjellësit janë paraqitur në figurën më poshtë.

TABELA 30 – ZONAT E MBROJTURA NË KOSOVË

EMRI	KOMUNA	SIPËRFAQA (ha)	Kategoria IUCN	VITI I MBROJTJES	PËRSHKRIM I SHKURTËR I VLERAVE	DISTANCA NGA GAZSJELLËSIT
Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë	Gjakovë, Rahovec	198	III	1986	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik	Korridori i gazsjellësit Prizren– Gjakovë ndodhet brenda zonës
Trungjet e Qarrit (*Quercus cerris*), në Jezerc	Ferizaj	0.09	III	2017	Monument natyror me karakter botanik	96 m nga gazsjellësit Ferizaj - Prizren
Ligatina e Hencit/ Radevës (special area for bird protection)	F. Kosove, Graçanicë, Lipjan	109	V	2014	Zone me karakteristika speciale ne ornitologji, iktologji, hidrogjeologji, botanike, dhe peizazh.	123 m nga gazsjellësit kufiri MKD/KOS deri te Prishtina
Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës (park natyror)	Prizren, Gjakovë	5.934	IV	2015	Park me vlera biologjike, gjeomorfologjke, hidrologjike, kulturore dhe turistike	130 m nga gazsjellësit Prizren – kufi SHQ/KOS

Burimi: AKMM, 2016

FIGURA 36 – ZONAT DHE PIKAT E MBROJTURA NË KOSOVË



Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë është një monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik. Kanioni Drini i Bardhë shtrihet në pjesën e mesme të lumit Drini i Bardhë. Është një fenomen morfo-hidrik me vlera gjenetike, vizuale dhe edukative. Kanioni është formuar në periudhën post-lakuristike të liqenit neogjen të Dukagjinit.

Trungjet e Qarrit (*Quercus cerris*), në Jezerc

Trungjet e Qarrit (*Quercus cerris*) është një monument natyror me karakteristika botanike, që ndodhet në fshatin Jezerc, Komuna e Ferizajit.

Ligatina e Hencit/ Radevës

Ligatina e Hencit njihet si zonë e rëndësishme e zogjve. Ishte krijuar artificialisht vitet 1960, me qëllim të kultivimit të krapit (*Cyprinus carpio*). Megjithëse studimet e kaluara kanë zbuluar që zona ishte e pasur me zogjë ujorë dhe bimë vaskulare, ishte e qartë që ishte lënë pas dore dhe ishte menaxhuar keq dhe kjo kishte çuar në suksesionin e saj natyral. Disa nga speciet më të zakonshme të zogjve që mund të gjenden në zonën më të gjerë të ligatinave janë lejleku i bardhë (*Ciconia Ciconia*). Sipas Raportit Vjetor për gjendjen e ambientit në Kosovë [11], të publikuar në vititn 2017, ishte e qartë që ndikimi i madh njerëzor në ligatinë ishtë arsyeja që shumë specie të zogjve që kishin qenë me bollëk në atë zonë, tanimë rrallë shihen.

Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës (park natyror)

Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës është deklaruar Park Natyror me vendim të Qeverisë Nr. 07 / 104 në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Kategorizimi i zonës së mbrojtur është ekuivalent me kategorinë IV të IUCN's me qëllim të ruajtjes, konzervimit dhe restaurimit të specieve dhe habitateve. Parku Natyror i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës shtrihet në territorin e dy komunave, Komunës së Prizrenit dhe Komunës së Gjakovës. Ka një sipërfaqe totale prej rreth 5,763 hektarëve.

4.9 - Peizazhi

Kosova pozicionohet në qendër të Gadishullit Ballkanik e kufizuar nga Mali i Zi në perëndim, Serbia në veri dhe lindje, Maqedonia e Veriut në juglindje, dhe Shqipëria në jugperëndim. Malet e kufizojnë Fushën e Kosovës në veri-lindje dhe Rrafshin e Dukagjinit në vëri-përëndim. Kosova përbëhet nga pika më lindore dhe pjesës më veriore të vargut të malit.

Kosova, si njësi e peizazhit, është e kushtëzuar nga klima bashkë me gjeologjinë dhe hidrologjinë. Bjeshkët e Nemuna dhe Malet e Sharrit, janë karakteristika më përcaktuese e vendit. Sa i përket rajonit qendror, rrafshi i Dukagjinit dhe ai i Kosovës zgjatet në përëndim dhe lindje. Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna) dominojnë skajin përëndimor pasi ofrojnë malin më të madh në Kosovë, Gjeravicën. Shpesh të referuar si Bjeshkët e Nemuna, ky rajon konsiderohet të jetë mes vargmaleve më të paqasshme në Evropë dhe vargmalet më të egra në Gadishullin Ballkanik. Malet e Sharrit ndodhen në pjesën jugore dhe jug-lindore të Kosovës ku ndodhet 43.12% e vargut.

Vargmali në Kosovë është i ndarë në tri zona kryesore: Zona e Lubotenit dhe Brezovicës, zona qendrore e Prizrenit dhe zona e Opojës dhe Gorës. Maja e Lubotenit dhe Mali Crna Gora krijojnë Grykën e Kaçanikut. Malet e Sharrit ndahen nga Mali i Nerodimës me Luginën e Siriniqit.

E tërë zona është e pasur me burime ujore: lumenj, liqene alpine, liqene akullnajore, dhe liqene artificiale. Shumica e lumenjve që burojnë në Kosovë i derdhen jashtë territorit të vendit në Adriatik, Egje dhe Detin e Zi. Lumi më i gjatë është Drini i Bardhë.

---

[11] *Raporti vjetor mbi gjendjen e ambientit ne Kosove (2017)*

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura në Kosovë (2019) është 210 dhe ky numër përfshin 5 peizazhe të mbrojtura (Shkugëza në Gjakovë, Pishat e Deçanit në Deçan, Kompleksi i pishave, në Strazhë Kaçanik, Kompleksi i Pishave në Shtime dhe Gërmia në Prishtinë). Sipërfaqja e përgjithshme e peizazheve të mbrojtura është 2,084 ha ose 0.2% e pjesës së tërë sipërfaqes së Kosovës.[12] Dy parqet kombëtare rajonale (peizazhet e mbrojtura) janë Gërmia dhe Mirusha[13]. Parku nacional Bjeshkët e Nemuna dhe Malet e Sharrit janë themeluar për të mbrojtur peizazhin, dhe mjedisin natyror të vendit. Ato po ashtu përfaqësojnë rajonet më të rëndësishme të vegjetacionit dhe biodiversitetit.

Në përgjithësi, pjesa periferike e Kosovës përgjatë kufirit përbëhet nga zona më të mëdha të peizazhit dhe përputhen me vargjet malore. Pjesa qendrore përbëhet nga pika individuale si peizazhe më të vogla të çmueshme që përputhen me zonat gjeomorfologjike apo vlerat natyrore. Gazsjellësit i planifikuar është vendosur në pjesën qendrore të Kosovës. Gazsjellësi më së shumti kalon përmes një peizazhi bujqësor me modele të copëtuara të fushave, të ndara me shumë kufinj. Ato po ashtu kalojnë nëpër shumë rrjedha ujore me brigje të ngritura dhe përmes luginave të lumenjve që i takojnë peizazheve të çmuara lumore. Pjesa jugore e interkoneksionit Maqedoni e Veriut-Kosovë dhe pjesa qendrore e gazsjellësi të Ferizaj-Prizren kalojnë përmes peizazhit pyjor-malor.

Gazsjellësit e planifikuar me korridor 200+200 m më së shumti ndodhen jashtë zonave të çmueshme të peizazheve. Sipas FigurA 37, zonat e peizazhit të çmueshëm më të afërt janë si në vijim:

TABELA 31 – ZONAT MË TË AFËRTA TË PEIZAZHAVE TË ÇMUESHME

Num.	Zonat e peizazhit të çmueshëm	Distanca nga linja më e afërt e gazsjellësit
7	Ligatina e Hencit / Radevës (afër lumit Sitnicë)	137 m – Gazsjellësi interkoneksioni Maqedoni e Veriut-Kosovë
12	Bifurkacioni i Lumit Nerodime	2,200 m – gazsjellësi Ferizaj-Prizren
17	Pisha e Car Dushanit	1,340 m – gazsjellësi Ferizaj-Prizren
23	Kanioni i Drini të Bardhë te Ura e Fshajtë	Gazsjellësi Prizren -Gjakova gjendet në zonë periferike të kësaj sipërfaqeje të peizazhit në gjatësi 1,740 m.
-	Parku natyror: Mali Pashtrik dhe Liqueni i Vërmices - park me vlera biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore dhe të peizazhit	Në distancë 200 m përgjatë fundit të gazsjellësi Kufiri me Shqipërinë-Prizren (liqeni Fierzës i formuar nga lumi Drini i Bardhë).

Sipas TabELA 31 – ZONAT MË TË AFËRTA TË PEIZAZHave TË ÇMUESHme TabELA 31, Kanioni Drini i Bardhë te Ura e Fshajtë është peizazhi më i rrezikuar me ndërtimin e gazsjellësit Prizren -Gjakovë. Peizazhet tjera të çmueshme që rrezikohen kanë të bëjnë me luginat e lumenjve ku ndodhen gazsjellësit në vijim:


- Gazsjellësi Kufi me Shqipërinë-Prizren – kalon lumin Lumbardhi i Prizrenit,
- Gazsjellësi Prizren -Gjakova – në luginën e lumit Drini i Bardhë, kalon lumin Drini Bardhë dhe lumin Ereniku,
- Gazsjellësi Peja-Istog – kalon lumin Lumbardhi i Pejës dhe Drini i Bardhë,
- Gazsjellësi Mitrovica-Vushtri – në luginën e lumit Sitnicë,
- Gazsjellësi Prishtina-Podujeve – në luginën e lumit Sitnicë, Llap, kalon lumenjtë në shumë vende
- Gazsjellësi Prishtina 1-Drenas – kalon lumin Drenicë dy herë,
- Gazsjellësi Drenas -Skenderaj – kalon lumin Klinë,
- Gazsjellësi Ferizaj -Prizren – kalon lumin Nerodimë,
- Gazsjellësi për interkoneksionin Maqedoni e Veriut-Kosovë – në luginën e lumit Sitnicë, kalon lumin.

---

[12] *Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Mjedisit, Prishtinë, 2020.*

[13] *Behxhet Mustafa et al., Gjendja e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Kosovë. Procedia Social and Behavioral Sciences 19, 2011., pg 651–654*

FIGURA 37 – ZONAT E PEIZAZHEVE TË ÇMUESHME NË KOSOVË





Burimi i origjinës: Behxnet, M., Hajdari, A., Mustafa, V., Pulaj, B., (2018), Trashëgimia kulturore në Republikën e Kosovës: në kërkim të vendeve të mundshme për UNESCO, IALE Official Journal of the International Association for Landscape Ecology nr. 63, fq.

4.10 - Trashëgimia kulturore

Pozita gjeografike brenda kufijve të tanishëm të Kosovës ka shkaktuar ndikimin e shumë civilizimeve përgjatë tërë historisë moderne njerëzore, duke rezultuar në trashëgimi të shumta dhe të llojllojshme kulturore.

Gjurmët e para të dokumentuara në territorin e Kosovës i takojnë Epokës së Gurit. Megjithatë, jeta gjatë kohës së Paleolitit apo Kohës së Vjetër të Gurit ende nuk është vërtetuar dhe provuar shkencërisht. Prandaj derisa të jenë vërtetuar prova për popullsi të Paleolitit dhe Mesolitit, do të merret parasysh vetëm njeriu i Neolitit, respektivisht vendbanimet neolitike si fillim i vendbanimeve njerëzore. Nga kjo periudhë e deri tani Kosova ka qenë e banuar dhe gjurmët e aktiviteteve njerëzore të shoqërive nga koha parahistorike, e lashtë dhe mesjetare, janë të qarta dhe të shpërndara gati në tërë territorin e Kosovës, për deri sa në disa vende arkeologjike gjurmët e vendbanimeve shumështresore qartë e pasqyrojnë vazhdimësinë e jetës përgjatë shekujve.[14] Kosova ka pozitë gjeografike strategjike, pasi që përmes saj kanë kaluar linja të trafikut dhe rrugë që kanë qenë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës, trashëgimisë, historisë dhe artit. Përkundër trashëgimisë së pasur multikulturore neolitike deri në Epokën e Bronzit, më vonë kjo është pasur nga periudha ilire, romake, bizantine/serbe ortodokse dhe otomane.

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Monumenteve është një organ qeveritar administrativ dhe pjesë përbërëse e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky departament është përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kulturore dhe ofrimin e kushteve për kërkime arkeologjike.

E gjithë trashëgimia kulturore mbrohet nga ligjet në vijim: Ligji për trashëgiminë kulturore, Ligji mbi zonat e veçanta të mbrojtura (përfshirë Ligjin për qendrën historike të Prizrenit dhe Ligjin për Hoqën e madhe), Ligji

---

[14] *Berisha, M. (2012), Udhezuesi arkeologjik i Kosoves, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Instituti Arkeologjik i Kosoves, Prishtine 2012*

për fshatin Zym të Hasit, Ligji për lirinë e religjionit, Ligji për shpronësim, Ligji për ndërtim, Ligji për institucionet kulturore, dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale; ligjet tjera si Ligji për planifikimn hapësinor dhe Ligji për arkivat.

Gjendja aktuale e trashëgimisë kulturore të Kosovës nuk është e kënaqshme për disa arsye: mungesa e të dhënave për trashëgiminë kulturore për tërë territorin e Kosovës, numri i vogël i iniciativave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, presionet për ndërtim pa plan dhe zhvillimi hapësinor në përgjithësi, shkatërrimi i trashëgimisë kulturore gjatë luftrave të kaluara.

Monumentet mesjetare në Kosovë janë listuar në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ato përmbajnë katër ndërtesa të shenjta në pjesë të ndryshme të Kosovës, dhe po ashtu janë të përshkruara në Listën Botërore të Trashëgimisë ne Rrezik (2006).

- Manastiri i patriarkanës së Pejës. Ky është një grup prej katër kishave me kube me disa seri të pikturave në mure. Afresket e shekullit 13 të kishës së apostulit të shënjtë janë pikturuar në një stil unik monumental (rreth 5 km VL nga gazsjellësit Pejë-Istog)
- Manastiri i Deçanit është ndërtuar në mes të shekullit 14 për mbretin serb Stefani i Deçanit dhe është po ashtu mausoleumi i tij (rreth 2,5 km perëndim të gazsjellësit Gjakovë-Pejë)
- Kisha e virgjëreshës së Levishës. Afresket e hershme të shekullit 14 në kishën e Virgjëreshës së Shenjtë të Levishës përfaqësojnë stilin e ri të ashtuquajtur Renesansë palajlogjike, duke kombinuar ndikimet e bizantit lindor ortodoks me traditat përëndimore romane. Ky stil ka luajtur një rol vendimtar në artin pasues ballkanas. (përafërsisht 4,5 km JL nga gazsjellësi Kufi SHQ -Prizren)
- Manastiri i Graçanicës është ndërtuar nga mbreti Serb Stefan Milutini në vitin 1321 në gërmadhat e bazilikës së shekullit 6 (përafërsisht 9,5 km VL nga gazsjellësi interkoneksioni Maqedoni e Veriut-Kosovë)

Shumica e monumenteve historike gjenden në rrethinën e qyteteve Prishtinë, Prizren dhe Pejë. Monumentet në Kosovë më së shumti përbëhen nga qytetet e lashta, kështjellat (Kulla), manastiret, xhamitë dhe kishat, ndërtesat publike dhe të banimit.

Tabelat në vijim do të listojnë disa nga elementet më të rëndësishme të ndërtimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës:

TABELA 32 –MONUMENTET MË TË RËNDËSISHME MESJETARE NË KOSOVË

Monumentet mesjetare		
Manastiret	Manastiri i Graçancës (vend UNESCO) Manastiri i Shën Arkangjelit Manastiri i Banjskës	Patriarkana e Pejës (vendi i UNESCOs) Visoki Deçani (vendi i UNESCOs)
Kishat	Kisha e virgjëreshës së Levishës (UNESCO) Kisha e Shën Gjergjit	Kisha e shën Nikolasit Kisha bazilika e Shën Pjetrit
Xhamitë	Xhamia Pirinazit Xhamia e Fatihut (e njohur si xhamia madhe) Xhamia e Sinan Pashës Xhamia e Hadumit Xhamia e Gazi Ali Beut	Xhamia e Qarshisë/Pazarit Bajrakli Xhamia Xhamia e Llapit Xhamia e Kurshumlisë Xhamia e kuqe
Hamaet	Hamami madh Hamami Mehmet Pashës Hamami qytetit të vjetër	Hammami i Gazi Ali Beut Hammami i Haxhi Beut
Mauzoletë	Tyrbja e Sultan Muratit Mauzoleu i Gazi Mehmet Pashës	Mauzoleu i Haxhi Babës Tyrbja e Sheh Besimit
Teqet	Teqja e Sheh Eminit	

TABELAE 33 –MONUMENTET MË TË RËNDËSISHME TË ARKITEKTURËS POPULLORE		
Arkitektura popullore		
Ndërtesat publike	Kalaja e Prizrenit Nenkalaja e Prizrenit Kulla e Vojinoviçit Kështjella e Pogragjes Kalaja e Novobërdës Kalaja e Prilepacit Kalaja mesjetare e Zveçanit	Ura e Gurit në Prizren Ura e Terzive Ura e Shenjtë Ura e Vojinoviçëve Shatërvani i Prishtinës Shatërvani i Prizrenit Sahat Kulla Pazari i Çarshisë së Madhe
Ndërtesat e banimit – shtëpitë tradicionale qytetare	Emin Gjiku Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit Shtëpia Köroğlu Shtëpia e Blagoje Gjorgjeviçit Shtëpitë Qytetare Bajmak Shtëpia e Familjes Kirajtani	Shtëpia e Familjes Qyse Shtëpia e Musa Shehzades Shtëpia e Pantiçit Shtëpia e Spasiqit Ndërtesa Belediya
Ndërtest e banimit – shtëpitë e fortifikuara rurale - Kullat	Kulla e Junikut Kulla e Dul Shabanit Kulla e Haxhi Zekës Kulla e Kostiqit Kulla e Familjes Mazrekaj Kulla e Toshit	Kulla e kompleksit të vjetër Deçan Kulla e Zymer Mushkolajt në Deçan Kulla e Osdautajt Kulla Shehu Kulla Sylaj Kulla e Habib Avdylit
Hotelet, monumentet dhe ndërtesat publike	Hotel Unioni në Prishtinë, Muzeu i Kosovës	Libraria Hivzi Sylejmani Monumenti Neëborn

Trashëgimia arkeologjike e Kosovës është jashtëzakonisht e pasur me vende të shumta arkeologjike nga gati çdo periudhë e historisë njerëzore. Tabela në vazhdim rendit vetëm vendet më të rëndësishme arkeologjike sipas *Udhërrëfyesit Arkeologjik të Kosovës.*

TABELA 34 – PIKAT ARKEOLOGJIKE MË TË RËNDËSISHME NË KOSOVË		
Arkitektura popullore		
Epoka e re e Gurit, Neoliti	Vlashnje Runik Varosh Zhitkoc dhe Karagaç Vallaç Reshtan	Barileve Bardhosh Tjerrtorja-Prishtina Fafos-Mitrovica Surkish
Periudha e hekurit	Gadime e Epërme Hisar Gllareva Boka e Përçevës Rogova Korisha Bërnicë e Poshtme Ponoshec	Gjinoc Bellaçec Fshej Llashtica Shiroka Lubozhda Banja e Pejës
Periudha romake	Municipium D.D. (‘Dardanorum’) Vindenis Pestova Poslishta Staradran Cerce Kllokot-Vërban	Paldenica Municipium Ulpiana Uglar-Statio Viciano Nerodime e Poshtme Çifllak Nikadin
Periudha e vjetër antike dhe periudha mesjetare	Vrella Banja e Malishevës	Kalaja e Dubovcit Kalaja e Topanicës


Arkitektura popullore		
	Kalaja e Harilaqit Kalaja e Pogragjës Kalaja e Korishës me kishë të hershme kristiane Kalaja e Kastercit Kalaja e Vuçakut Kalaja e Strocit Kalaja e Llapushnikut Kalaja e Llanishtës	Fortifikimi Suka e Cërmjanit Kalaja e Zatriqit Kalaja e Veletinit Kalaja e Grabocit Kalaja e Matiqanit Kalaja e Novobërdës Kalaja e Prizrenit

Një hartë e përzier e trashëgimisë kulturore është përgatitur dhe përfshin vende të rëndësishme arkeologjike dhe vende të UNESCOs. Pasi që ka ende një numër të madh të vendeve arkeologjike në Kosovë dhe një numër shumë të madh të aseteve të kulturore të ndërtuara (monumente, arkitekturë popullore, etj.), është e pamundur të tregohen në një hartë të përzier. Vendet e rëndësishme arkeologjike janë paraqitur për të treguar aktivitetin arkeologjik në hapësirën më të gjerë. Një vlerësim më i detajuar do të bëhet në lidhje me lokacionin e projektit dhe elementet e trashëgimisë kulturore në fazat e mëvonshme të zhvillimit të projektit.

Gjeografikisht, një pjesë mjaft e madhe e aseteve kulturore gjendet në lokacionet që janë më të përshtatshme për jetë, ekonomi, infrastrukturë dhe bujqësi. Këto janë ultësira dhe kodrina të buta të pjesës qendrore dhe ultësirat përgjatë kodrave në pjesën jugore dhe veiore të Kosovës. Një pjesë shumë e vogël e aseteve kulturore gjendet në vendet malore dhe sipërfaqet kodrinore të mbuluara me pyje.

Sipas fakteve të sipërpërmendura mund të konkludohet që nuk ka asete kulturore nga lista e aseteve kulturore të UNESCOs në afërsi të menjëhershme të projektit të planifikuar.

FIGURA 38 – VENDET ME VLERË ARKEOLOGJIKE DHE TË UNESCO NË KOSOVË



Legend/Legjenda

Gas pipelines/Gazsjellës

- Kosovo transmission branch pipelines/ Gazsjellësi i degës së transmisionit të Kosovës
- Kosovo transmission pipelines-gas ring/ Gazsjellësi i Kosovës-unaza e gazit
- North Macedonia-Kosovo interconnection/ Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë
- Route ALB Border-Prizren/ Gazsjellësi Kufiri Shqiptar-Prizren
- Aboveground facilities/Objektet mbitokësor

Cultural heritage/Trashegimi kulturore

- UNESCO sites/Vendet e UNESCO-s
- Important archaeological sites/Vende të rëndësishme arkeologjike
- Kosovo border/Kufiri i Kosovës

4.11 - Shëndeti i njeriut

Cilësia e ajrit

Ndotja e mjedisit, veçanërisht ndotja e ajrit dhe ujit, është një faktor që ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut. Ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit dhe të ujit konsiderohet të jetë shkaktar i shumë sëmundjeve dhe vdekjeve të parakohshme. Ndotja e ajrit, megjithëse nuk mund të jetë vizualisht e dukshme, mund të jetë vdekjeprurëse për shkak të përbërjes toksike që ka. Në përgjithësi, ajri në zonat urbane, dhe në veçanti në Prishtinë dhe Obiliq, vlerësohet të jetë disa herë më i ndotur se normat e lejuara.

Mes ndotësve më të mëdhenj në Kosovë janë industria energjetike, industria metalurgjike, minierat, nxjerrjet e materialeve, deponitë industriale dhe urbane, deponitë ilegale, transporti, bujqësia etj.

Lirimet e ndotësve në ajër dhe ujë jo vetëm që shkaktojnë shumë probleme mjedisore, por në rast të kontaktit me njerëz shkaktojnë shumë probleme shëndetësore. Ndotës të tillë shkaktojnë pasoja në shëndet duke manifestuar sëmundje të sistemit kardiovaskular, kapacitet të reduktuar funksional të mushkërive të shoqëruar me infeksione dhe përkeqësim të astmës, diaresë, kancerit të mushkërive, dëmtime gjenetike të shoqëruar me abnormalitet qelizor, mutacione qelizore dhe çrregullime tjera qelizore.

Gjatë shekullit 21, nevoja për të identifikuar faktorët që shkaktojnë sëmundjet kronike si diabeti, zhvillimi neurologjik i fëmijëve, sëmundjet e lidhura me stresin, etj., është rritur në mënyrë domethënëse. Të gjitha këto sëmundje kanë lidhje me mjedisin ku jetojmë dhe mënyrën se si e ruajmë dhe e trajtojmë atë. Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çdo vit, më shumë se dy milion vdekje të parakohshme mund t'i atribuohen ndotjes së ajrit si rezultat i djegies dhe lirimit të gazrave të ndryshme, vdekje tjera si rezultat i ujit të ndotur, dheut dhe ndotjeve tjera.

Prandaj, faktori njeri ka rol thelbësor në të gjitha këto procese, dhe me veprimet e tij mund të ndikojë në reduktimin e këtyre ndotësve që kanë pasoja për shëndetin e njeriut.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) monitoron gjendjen e shëndetit publik dhe në veçanti sëmundjet e shkaktuara nga epidemitë dhe pandemitë, lëndimet në punë, në komunikacion e gjetiu, masat mbrojtëse, promovon dhe inkurajon sjellje të shëndetshme për jetën dhe mjedisin.

IKSHP, si një institucion për monitorimin dhe parandalimin e sëmundjeve mjedisore, ka zhvilluar një sistem informimi për publikun, me të dhëna të grumbulluara gjatë viteve mbi sëmundjet ambientale të cilat duket të ndodhin si pasojë e shumë faktorëve si: faktorët ekologjikë dhe socio-ekonomikë, mungesa e informacionit, ndryshimet klimatike.

Sëmundjet mjedisore ndodhin si rezultat i higjienës së dobët, kushteve socio-ekonomike, furnizimit me ujë të pijshëm nga burime të pakontrolluara – puse, ndalje për kohë të gjatë e furnizimit me ujë të pijshëm, ujëra të ndotur, mungesë e kanalizimit, hudhje e mbeturinve afër burimit të ujit dhe ndotës tjerë.

Probabiliteti për të ndodhur sëmundjet është më i madh gjatë sezonit të verës, për shkak se në këtë periudhë temperaturat janë më të larta, dhe kështu krijojnë kushte më të favorshme për shpërndarjen e viruseve dhe bakterieve. Në të njëjtën periudhë kohore, kushtet higjienike dhe sanitare në disa pjesë të Kosovës janë në një nivel më të ulët për shkak të mungesës së ujit dhe thatësisë.

TABELA 35 – SËMUNDJET NGA MJEDISI NË 2018 DHE 2019

Sëmundjet	2018		2019	
	Rastet	Mbi 100,000 banorë	Rastet	Mbi 100000 banorë
ITPR Pneumonia/ARI	12607	689.95	12284	672.27
SARI (formë e rëndë e pneumonisë)	72	3.94	63	3.45
Sëmundje të ngjashme me Influenza (ILI)	75643	4139.76	79952	4375.58
Influenza A	0	0	386	21.1

Sëmundjet	2018		2019	
	Rastet	Mbi 100,000 banorë	Rastet	Mbi 100000 banorë
Influenze A pdm09	0	0	71	3.9
Diare akute	75492	4131.50	87635	4796.05
Varicella	7327	400.99	12600	689.57
Syndromi i diaresë me gjak	36	1.97	35	1.92
Sindromi meningjitisit	124	6.79	195	10.67
EHKK	1	0.05	1	0.5
EHSV	4	0.22	3	0.16
Virusi i Nilit Përëndimor	14	0.77	0	0
Sëmundja e lymës	3	0.1	0	0
Leishmaniaza	0	0	6	0.30
Malaria	3	0.16	3	0.16
Legionelloza	0	0	1	0.05
Sindromi i etheve ekzantematike	83	4.54	0	0
Pertussis	22	1.20	17	0.93
Ethet tifoike	0	0	1	0.10
Parotitisi epidemik	92	5.03	63	3.45
Tuberkulozi	700	38.31	-	-
Intoxication alimentaris	1896	103.76	2394	131.02
Verdhëza akute A	77	4.21	44	2.68
Verdhëza B	80	4.38	36	1.97
Verdhëza C	11	0.60	35	1.92
Tifoja abdominale	2	0.11	0	0
Adenoviroza	11	0.60	35	1.92
Salmonella	99	5.42	134	7.33
Shigelloza	0	0	32	1.75
Rota virusi	191	10.45	271	14.83
Tularaemia	19	1.04	12	0.66
Lymfadenitis	0	0	0	
Leptospiroza	2	0.11	4	0.22
Fruthi	195	10.67	16	0.87
E. coli patogjenike	18	0.99	22	1.20
Brucelloza	28	1.53	13	0.71
Ehinokoku	2	0.11	0	0.00
Toksoplasmoza	9	0.49	8	0.44
Ethet Q	0	0	1	0.05
Giardia sis	3	0.1	0	0.00
Yersinia enterocolitica	1	0.05	0	0.00
Gastroenterologjike	0	0	379	20.74
Lymphadenitis ac. coli	102	5.58	49	2.68
Campylobacter	0	0	0	0
STI	1155	63.21	1321	67.10
Parasitoza	0	0	141	7.72
Giardiasis	3	0.16	0	0.00
Statusi post ictus ixodes	0	00	109	6.00
Statusi post morsum cani	0	0	3	0.16
Statusi post morsum viperi	0	0	19	1.04
Sëmundje tjera ngjitëse	643	35.19	503	27.53
Totali	**176767**	**9674.04**	**198882**	**10884.34**

Burimi: Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019, Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit, Prishtinë, gusht 2020.

Sëmundjet mjedisore ndodhin si rezultat i higjienës së dobët, kushteve të dobëta socio-ekonomike, ujit të pijshëm nga burime të pa kontrolluara – bunare, ndalje për kohë të gjatë të furnizimit me ujë, ujërave të ndotura, mungesës së kanalizimt, hedhjes së mbeturinave afër burimeve të ujit dhe ndotësve tjerë.

Probabiliteti për të ndodhur sëmundjet është më i madh gjatë sezonit të verës, për shkak se në këtë periudhë temperaturat janë më të larta, dhe kështu krijojnë kushte më të favorshme për shpërndarjen e viruseve dhe bakterieve. Në të njëjtën periudhë kohore, kushtet higjienike dhe sanitare në disa pjesë të Kosovës janë në një nivel më të ulët për shkak të mungesës së ujit dhe thatësisë.

Vlerësimi i cilësisë së ujit të pijshëm

Cilësia e ujit të pijshëm i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziokimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm i mirëqenies dhe shëndetit të popullsisë. Kosova ka legjislacion adekuat për mbrojtjen e ujit të pijshëm. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2017 është një ndër udhëzimet më të rëndësishme për mbrojtjen e ujit të pijshëm dhe është në pajtim me standardet e BE-së për ujë të pijshëm.

Kompanitë Rajonale të Ujit janë përgjegjës për furnizim me ujë kualitativ për konsumatorët; ata po ashtu janë të obliguar të kryejnë monitorim dhe testim të brendshem të cilësisë. Në anën tjetër, IKSHP është institucion me përgjegjësi ligjore për kontrollimin dhe monitorimin e cilësisë së ujit për tërë teritorin e vendit. IKSHP siguron ëe uji i furnizuar nga KRU-të të jëtë në pajtim me vlerat sipas standardeve lokale për parametrat mikrobiologjikë dhe fiziokimikë. Në këtë raport, cilësia është vlerësuar në bazë të të dhënave të raportuara nga Qendra e Ujit për ARRUK.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e IKSHP sipas përgjegjësive të saj, cilësia e përgjithshme e ujit në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve përmes shtatë KRU-ve rezulton të jetë në pajtim me standardet e ujit të pijshëm gjatë viteve 2018/2019. Gjatë vitit 2018, 8,598 mostra uji janë marrë nga rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimit në aspektin fizikokimik dhe mikrobiologjik, me 99.4% të mostrave që kanë rezultuar në pajtim me standardet e kërkuara. Ndërsa në vitin 2019, 9,229 mostra uji janë marrë nga rubinetet me qëllim të testimit në aspektin fizikokimik dhe mikrobiologjik. Nga mostrat e marra për testim, 98.8% kanë rezultuar në pajtim me standardet e kërkuara lokale. Duke iu referuar këtyre statistikave, vlerësohet që cilësia e ajrit e furnizuar nga KRU-të është në nivel shumë të mirë.

FIGURA 39 – PËRPUTHSHMËRIA E TESTEVE TË UJIT TË PIJSHËM SIPAS STANDARDEVE VENDORE PËR PARAMETRAT BAKTERIOLOGJIKË DHE KIMIKË (KRU, 2018/2019)



Burimi: Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019, Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit, Prishtinë, gusht 2020

Siç mund ta shohim nga tabela në vijim, gjatë vitit 2018, pajtueshmëria më e lartë sa u përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë ishte në KRU Prishtina me 100%, derisa më e ulëta në KRU Bifurkacioni me 97.1%. Në vitin 2019, gjendja e përputhshmërisë më të lartë për parametrat mikrobiologjikë ishte në KRU Prishtina,

Hidrorajoni Jugor, Gjakova me 100%, derisa më e ulëta ishte në KRU Bifurkacioni me 95.5%, që kishte pësuar rënie 1.6% në krahasim me vitin paraprak.

TABELA 36 – SHKALLA (%) E TESTEVE BAKTERIOLOGJIKE DHE FIZIOKIMIKE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E CILËSISË SË AJRIT SIPAS KRU 2018/2019

Kompanitë	Viti	KRU Prishtina	KRU Hidro-regijoni	KRU Hidro-drini	KRU Mitro-vica	RËC Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidro-morava	Mesatarja e sektorit
Mikrobiologjike	2018	100%	99.7%	98.7%	99.6%	99.7%	97.1%	98.3%	99.3%
	2019	100.0%	100.0%	99.3%	99.5%	100.0%	95.5%	96.9%	99.2%
Fiziokimike	2018	98.9%	99.4%	100%	100%	100%	98.2%	99.4%	99.5%
	2019	99.8%	100%	100%	97.6%	100%	91.7%	92.1%	97.9%
Mesatarja për KRU	2018	99.7%	99.6%	99.1%	99.7%	99.8%	97.4%	98.8%	99.4%
	2019	99.9%	100%	99.5%	99.1%	100%	94.5%	94.9%	98.8%

Burimi: Raporti mbi gjendjen e ambientit ne Kosove 2018-2019, Ministria e Ekonomise dhe Ambientit, Prishtinë, Gusht 2020

KRU Hidromorava dhe Bifurkacioni furnizojnë me ujë të pijshëm të cilësisë më të dobët, si në aspektin bakteriologjik dhe fiziokimik, për shkak të mungesës së furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm.

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujë gjatë këtyre vitete, sipas ARRU arrin nivelin prej 75%, derisa mbulimi me shërbimet e kanalizimit arrin nivelin prej 65%. KRU Prishtina, Gjakova dhe Hidrodrini kanë arritur të mbulojnë një pjesë më madhe të popullsisë me shërbime nga këto dy fusha të shërbimeve.

Në kornizën e angazhimit të mëtejmë për përmirësimin e cilësisë së ujit që u ofrohet konsumatorëve dhe popullsisë, IKSHPK është e angazhuar në avancimin, azhurnimin e UA AI 16/2012, në kuptim të kritereve të fundit të Direktivës Europiane dhe Rekomandimeve të OBSH-së.

Sëmundjet infektive dhe venerike

Sëmundjet infektive dhe venerike jepen në tabelën në vijim.

TABELA 37 – SËMUNDJET E TRANSMETUESHME SEKSUALISHT


Diagnoza	Totali
Condylloma actuminata 4	43
Trichomonas vaginalis	-
Gardnerella	116
Chlamydia trachomatis	103
Molluscum Contagiosum	23
Mycoplazma hominis	6
Balanitis	3
Ureaplasma ureliticum	226
Neisseria Gonorrhea	18
Herpesi gjenital	-
Sifilizi	-
Total	**538**

Burimi: Seritë 5: Statistikat shoqërore statistikat shëndetësore Agjencia e Statistikave të Kosovës, tetor 2021,

4.12 - Populllsia dhe vendbanimet

Shteti i Kosovës është i ndarë në 7 (shtatë) rajone statistikisht të ndara të nivelit NUTS 3 (që përbëhet nga disa komuna) si një divizion jo administrativ (FigurA 40).

FIGURA 40 – LINJAT E PLANIFIKUARA TË GAZSJELLËSIT DHE ZONAT RAJONALE – REPUBLIKA E KOSOVWS



Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë 2011, numri total i banorëve në Republikën e Kosovës ishte rreth 1.8 million i shpërnndarë në 1457 vendbanime, nga të cilat 38 janë të nivelit komunal, deri sa të tjerat janë vendbanime që kanë statusin e fshatit bazuar në përmbajtjen dhe aktivitetet e tyre[15].

Shumica e popullsisë jeton në zonën rajonale të Prishtinës dhe Mitrovicës (TabELA 38).

TABELA 38 – POPULLSIA NË NIVEL RAJONAL – REPUBLIKA E KOSOVËS

Zonat statistikore rajonale NUTS-3	Komunat e përfshira	Sipërfaqa (km²)	Nr. i popullsisë
Zona rajonale e Prishtinës	Drenasi, Fushe Kosova, Gracanica, Lipjani, Obiliqi, dhe Podujeva	2.081	469.583
Zona rajonale e Mitrovicës	Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Skenderaj, Vushtrria, Zvecani, dhe Zubin Potoku.	2.051	232.833
Zona rajonale e Pejës	Decani, Istogu, dhe Klina	1.660	214.254
Zona rajonale e Prizrës	Dragashi, Mamusha, dhe Suhareka	1.433	277.007
Zona rajonale e Ferizajit	Hani Elezit, Kacaniku, Shterpca, dhe Shtime.	1.021	185.695
Zona rajonale e Gjilanit	Kamenica, Enklava Kamenice , Gjilan, Kllokot, Novoberde, Ranilluge, Partesh, dhe Vitia	1.413	188.188
Zona rajonale e Gjakovës	Juniku, Malisheva, dhe Rahoveci.	1.247	185.695

Burimi: ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i popullsisë 2011


Linja e gazsjellësit kalon nëpër të gjitha zonat rajonale të Kosovës, dhe planifikon të kalojë nëpër gati secilën komunë më përjashtim të:

- Komunave veriore, duke përfshirë komunat Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq;
- Komunat qendrore, duke përfshirë komunat Kline, Mamushe, Malisheve dhe Shtime;
- Komunat lindore, duke përfshirë komunat Kamenice, Enklavën Kamenice, Novoberde, dhe Ranillug;
- Komunat jugore duke përfshirë komunën Dragash.

---

[15] *Për shkak të mosmarrëveshjes politike dhe territorale mes Serbisë dhe Kosovës, në tri komunat në very të Kosovës serbët lokalë kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë me 2011 si dhe ka pasur bojkot të pjesërishëm në jug nga serbët dhe romët, sidoqoftë, regjistrimi i popullsisë është aprovuar nga Eurostati dhe është i pari regjistrim i kryer që nga regjistrimi i fundit legjitim i kryer në vitin 1981.*

FIGURA 41 – LINJAT E GAZSJELLËSIT BRENDA KOMUNAVE



Legend / Legjenda

Kosovo border / Kufiri i Kosovës
Gas_pipelines/Gazsjellësi

Administrative units / Njësitë Administrative

Deçan
Dragash
Drenas
Enclave-Kamenicë
Enclave-Prishtine
Ferizaj
Fushë Kosovë
Gjakovë
Gjilan
Graçanicë
Hani i Elezit
Istog
Junik
Kaçanik
Kamenicë
Klinë
Kllokot
Leposaviq
Lipjan
Malishevë
Mamushë
Mitrovicë
Mitrovicë e Veriut
Novobërdë
Obiliq
Partesh
Pejë
Podujevë
Prishtinë
Prizren
Rahovec
Ranillug
Shtërpcë
Shtime
Skënderaj
Suharekë
Viti
Vushtrri
Zubin Potok
Zveçan

Popullsia në Kosovë është rritur me 8,9 % që nga regjistrimi i vitti 1981 megjithëse është regjistruar rënie të popullsisë në komunat në vijim: Kline, Kamenice, Mimtrovice, Leposaviq, Novoberde, Obiliq, Peje, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveqan, Graçanicë, Ranillu, Partesh dhe Kllokot. Dendësia e popullsisë në Kosovë llogaritet 159,5 njerëz për kilometër katrorë në vitin 2011, duke u bërë vendi më i populluar në rajonin e Ballkanit.

TABLA 39 – POPULLSIA NË NIVEL RAJONAL – REPUBLIKA E KOSOVËS


Komuna / Vendi-Qarku- Komuna	Popullsia 1981	Popullsia 2011	Dallimi 1981-2011	Sipërfaqa (km²)	Dendësia e popullsisë 2011
REPUBLIKA E KOSOVËS	1,584,440	1,739,825	1.12	10,908	159,5
DEÇAN	35,577	40,019	1.12	293	136.58
GJAKOVË	92,203	94,556	1.03	587	161.08
GLLOGOC	39,141	58,531	1.50	275	212.84
GJILAN	73,451	90,178	1.23	391	230.63
DRAGASH	35,054	33,997	0.97	433	78.52
ISTOG	50,104	39,289	0,78	454	86.54
KAÇANIK	25,028	33,409	1.33	211	158.34
KLINË	42,816	38,496	0,90	309	124.58
FUSHË KOSOVË	28,367	34,827	1,23	84	414.61
KAMENICË	40,325	36,085	0.89	413	87.37
MITROVICË	87,531	83,935	0.96	330	254.35
LEPOSAVIQ	16,906	13,773	0.81	539	25.55
LIPJAN	52,538	57,605	1.10	338	170.43
NOVOBËRDË	12,901	6,729	0.52	204	32.99
OBILIQ	26,595	21,549	0.81	105	205.23
RAHOVEC	46,459	56,208	1.21	276	203.6
PEJË	111,071	96,450	0.87	602	160.22
PODUJEVË	75,437	88,499	1.17	632	140.03
PRISTINA	141,201	198,897	1.41	520	382.49
PRIZREN	131,774	177,781	1.35	626	284.00
SKENDERAJ	47,827	50,858	1.06	374	135.98
SHTIME	19,952	27,324	1.37	134	203.91
SHTËRPCË	12,115	6,949	0.57	247	28.13
SUHAREKË	50,444	59,722	1.18	361	165.43
FERIZAJ	83,945	108,810	1.30	345	315.39
VITI	43,690	46,987	1.08	270	174.03
VUSHTRRI	65,512	69,870	1.07	344	203.11
ZUBIN POTOK	8,081	6,616	0.82	334	19.81
ZVEQAN	9,710	7,481	0.77	123	60.82
MALISHEVË	36,808	54,613	1.48	306	178.47
JUNIK	5,063	6,084	1.20	77	79.01
MAMUSHË	2,752	5,507	2.00	11	500.64
HANI I ELEZIT	6,044	9,403	1.56	83	113.29
GRAÇANICË	14,060	10,675	0.76	122	87.50
RANILLUG	6,446	3,866	0.60	77	50.21
PARTESH	4,266	1,787	0.42	28	63.82
KLLOKOT	4,149	2,556	0.62	23	111.13

Source: KAS, Kosovo Agency of Statistical data base

Popullsia urbane dhe rurale në Kosovë që rrjedh nga kriteret administrative[16] është raportuar si 38 % dhe 62 %, respektivisht. Sipas definicionit të zonave urbane që definon nivelin e vendbanimit me vendime administrative të komunave, shpërndarja e njerëzve në zonat urbane e popullsisë totale (%), paraqitet në figurën në vijim.

[16] *2011 Te dhenat e Regjistrimit te popullsise nga ASK*


FIGURA 42 – POPULLSIA URBANE DHE RURALE BRENDA REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Burimi: Shpërndarja e popullsisë në Republikën e Kosovës: analizë krahasuese për popullsinë urbane dhe klasaifikimin e saj në bazë të kritereve administrative dhe joadministrative, Idriz SHALA, Agjencia e Statistikave të Kosovës, EFGS2016 – Forumi Evropian për Gjeografi dhe Statistika, Konferenca Paris 2016

Në zonë gjeografike urbane karakterizohet me dendësi më të madhe të popullsisë, ndërsa zona rurale karakterizohet me dendësi më të ulët të popullsisë. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të vitit 2011, popullsia urbane që jeton në Prishtinë është rritur në mënyrë domethënëse në raport me atë rurale urbane: 161,751 (81.3%) vs rurale: 37,146 (18.7%)] derisa në komunën e Deçanit, etëm një proporcion i vogël i popullsisë së komunës jeton në zonën urbane [urbane: 3803 (9.5%) vs rurale: 36,216 (90.5%)]. Linjat e propozuara të gazsjellësit dhe vendbanimet tjera duke përfshirë qytetet më të mëdha shpërndarë sipas numrit të popullsisë janë paraqitur në figurën në vijim.

FIGURA 43 – NUMRI I PERSONAVE BRENDA VENDBANIMEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, TË DHËNA NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011




Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë CENSUS 2011, Tishukaj et al. BMC Shëndeti Publik(2017) 17:711: Gjendja fizike dhe veçoritë antropometrike në radhët e adoleshentëve që jetojnë në zonat urbane ose rurale të Kosovës

Ndarja e popullsisë sipas moshës tregon që shumica e kosovarëve janë në klasën e mesme të moshës (15-64). Republika e Kosovës ka popullsinë më të re në Europë me një mesatare prej 29,5 vjetësh. Nga 1.739.825 banorët e regjistruar në Kosovë (përjashtuar serbët që kishin bojkotuar regjistrimin), 50,3% ishin meshkuj dhe 49,7% femra. Përqindja e popullsisë më të vjetër është nën 9% në të gjitha nivelet me përjashtim të komunave Partesh,

Ranillug, Shtërpcë, Novoberde, dhe Dragash. Ky raport paraqet pjesën më të vogël të individëve të moshave 65+ krahasuar me vendet në rajon si Shqipëria, e cila raporton rreth 10% dhe tjerat rreth 17 %.

FIGURA 44 –SHPËRNDARJA E GRUPMOSHAVE SIPAS KOMUNAVE



- Populllsia QË bojkotoi regjistrimin 2011


Burimi: REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011 ASK

Kosova është një ndër të paktat shtete europiane ku tranzicioni i fertilitetit ka filluar në një fazë shumë të vonshme. Shkalla e fertilitetit në Kosovë është raportuar në 1.9 % në 2020, sipas grumbllimit të indikatorëve të zhvillimit nga Banka Botërore, e përpiluar duke u bazuar në burime të njohura zyrtare. Ka shkallën më të

lartë të fertilitetit në rajon, si dhe shkallën më të lartë, në krahasim me shkallën e fertilitetit në Bashkimin Europian.

Sipas të dhënave nga ASK, Kosova ka rritje natyrale pozitive dhe dallimi mes lindjeve dhe vdekjeve është duke u zvogëluar (FigurA 45).

FIGURA 45 – SHTESA NATYRORE NË KOSOVË NGA 2010– 2020




Republika e Kosovës konsiderohet si shtet i emigrimit, ngase një nga tri familje ka një pjesëtar të familjes që jeton jashtë shtetit, dhe një nga katër familje pranon remitenca financiare. Një numër i madh i Kosovarëve ka emigruar në ndjekje të një pune më të mirë dhe një jete të re, kryesisht në Gjermani, Zvicërr dhe Itali. Megjithëse politika e emigracionit në Kosovë është në pajtim me *Acquis Communautaire* dhe Ligjin ndërkombëtar për të drejtat njeriut, ende ekzistojnë migrime të parregullta të kosovarëve si përgjigje ndaj deficiencave strukturale, mungesës së vendeve të punës, varfërisë, si dhe mungesës së qasjes në zonën e lirisë së lëvizjes Shengen. Llogaritet që që nga vjeshta e vitit 2014, dhjetra mijëra kosovarë kanë emigruar, kryesisht në shtetet e Bashkimit Europian.

Kosova është një shoqëri multi-etnike. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të vitit 2011, shpërndarja e grupeve etnike ishte si në vijim: shqiptarë (92.9 %), serbë (1.5 %), boshnjakë (1,6 %), romë, ashkali, dhe egjiptian[17] popullsia (RAE) (2.0 %), turq (1.1 %), dhe tjerë (0.6 %). Rreth 15% e popullsisë nuk ka dashur të deklarojë përkatësinë etnike. Minoriteti më i madh etnik është komuniteti serb, i pasuar nga boshnjakët ish-jugosllavë dhe turqit. Përveç këtyre, Kushtetuta e Kosovës njeh edhe minoritetet roma, ashkali, dhe egjiptian (RAE) si tri grupe të dallueshme etnike.

---

[17] *Egjiptianët në vendet ballkanike janë të njohur si grup etnik që kanë karakteristika të përbashkëta me romët dhe nuk duhet të përzihen me qytetarët e Republikës Arabe të Egjiptit*


FIGURA 46 – POPULLSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE, REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011



Burimi: ASK REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011

Minoriteti më i madh kombëtar në Republikën e Kosovës është komuniteti serb i raportuar brenda komunave Gracanice, Kllokot, Partesh, Ranillug, Novoberde, dhe Shterpce, i pasuar nga boshnjakët ish-jugosllavë dhe turqit. Përveç këtyre, Kushtetuta e Kosovës njeh edhe minoritetet roma, ashkali, dhe egjiptian (RAE) si tri grupe të dallueshme etnike.


FIGURA 47 – HARTA ETNIKE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011



Burimi: Harta etnike e Republikes se Kosoves sipas Regjistrimit te vitit 2011, Autor: Luan Zeqiri, 2013, harta administrative: Ivan Vukicevic, Lulani I Medvegjes

Pjesa më e madhe e popullsisë në Kosovë janë muslimanë të vetëdeklaruar, që përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë totale. Rreth 0,4% e popullsisë nuk ka dashur të deklarojë përkatësinë fetare. Muslimanë janë deklaruar në tërë territorin, megjithëse më pak janë deklaruar në komunat Gracanice, Shterpce, Ranillug dhe Kllokot ku janë përqëndruar më shumë pjesëtarë ortodoksë. Më shumë se 15% e popullsisë janë të përkatësisë katolike në komunat Gjakove dhe Kline dhe më shumë se 1% në komunat Decan, Istog, Peje, Prizren dhe Viti.

FIGURA 48 – POPULLSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS SIPAS PËRKATËSISË FETARE, REGJISTRIMI I POPULLSISË 2011



Burimi: ASK REGJISTRIMI I POPULLSISW 2011

Edukimi në Republikën e Kosovës mbulohet nga shkollat publike dhe private. Sistemi edukativo-arsimor përbëhet nga arsimi parashkollor (fëmijët nën 6 vjet), arsimi fillor (klasat 1-5, fëmijët 6-10 vjet), arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9, fëmijët 11-14 vjeç), arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12, fëmijët 15-18 vjet) dhe arsimi i lartë.

Çdo fëmijë ka të drejtë të shkollohet në gjuhën amtare në shkollën fillore dhe të mesme nëse plotësohen kushtet e ofruara nga Ministria. E drejta e fëmijëve të minoriteve për t'u shkolluar në gjuhën e tyre amtare parashihet me Ligjin për Arsimin i cili u garanton të drejtën e baabartë në edikim të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Duhet të përmendet që sistemi arsimor në Kosovë ka karakter etnik për shkak të intervenimit të politikës serbe në zonat serbfolëse në Kosovë. Serbët e Kosovës vijojnë shkollimin me planprograme serbe, ndërsa të tjerët vijojnë me planprgramet e Kosovës.

Sipas të dhënave nga regjstrimi i vitit 2011, shumica e popullsisë e moshës 10 e më shumë, (duke përjashtuar serbët qe kanë bojkotuar regjistrimin) ka nivel të mesëm shkollimi, ndërsa gati 10 % e popullsisë nuk e ka përfunduar shkollimin dhe gati 8 % kanë kualifikim të shkallës së treë. Të dhënat e fundit tregojnë që ka pasur nje rritje në 6,6 % të numrit të studentëve të shkallës së tretë në Kosovë mes viteve 2013 dhe 2019 [18]. Si krahasim, numri i studentëve të shkollimit të shkallës së tretë në Evropë është rritur mesatarisht 0.4 % në vit. Të dhënat nga regjistrimi i vitit 2011 tregojnë që shkalla e analfabetizmit e popullsisë mbi 10 vjet është 3,85 %. Kjo është një shkallë relativisht e lartë e cila preket nga një numër relativisht i madh i grupmoshës 75 vjeçe. Populla pa shkollim formal/po nivel të përfunduar shkollimi që dijnë shkrim e lexim përbëjnë 5,75% të popullsisë mbi 10 vjet dhe ku gratë përbëjnë 3,06%. Përqindja e grave mes të analfabetëve është 79,7%.

---

[18] *Të dhënat e marra nga https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_education_statistics#Tertiary_education*

Grupet vulnerable në zonën e projektit kanë të bëjnë me njerëzit , veçanërisht ata nën vijën e vafëisë, të patokët, të moshuarit, gratë dhe fëmijët duke përfshirë të rinjtë (15 deri 24 vjeç) dhe familje pa të drejta ligjore në tokë dhe familjet që varen nga toka e kufizuar e rendimentit të ulët, e po ashtu edhe personat e zhvendosr dhe të kthyerit, të cilët për shkak të gjinisë, kombit, moshës, kufizimit fizik apo mental, disavantazhit ekonomik apo gjendjes sociale mund të ndikohen më shumë nga projekti. Gati 20% e popullsisë brenda zonës së projektit janë të rinjë që përballen me situatën aktuale ekonomike dhe politike në Republikën e Kosovës.


Përveç kësaj, komunitetet RAE në Kosovë përbëjnë rreth 2% të popullsisë dhe konsiderohen grupi më vulnerabël nga pikëpamja e përfshirjës sociale. Të tri komunietet, që ndajnë karakteristika të përbashkëta, përballen me me jetën në varfëri, veçim, qasjen e vështirë në shërbimet sociale, akomodimin, diskriminimin etj. Komunitetet RAE janë të pranishme gati në të gjitha komunat me numrin më të lartë të raportuar në komunat Gllogoc, Kamenice, Podujeve, Skenderaj, Viti, and Kacanik.

4.13 - Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë

4.13.1 - Bujqësia


Bujqësia në Kosovë historikisht ka qenë një sektor i rëndësishëm për ekonominë e vendit. Pjesëmarrja mesatare e bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë dhe peshkimit në Vlerën Bruto të Shtuar (GVA) për periudhën 2006-2011 ishte 15%. Pjesëmarrja e bujqësisë në shkallën e punësimit në vitin 2020 është llogaritur në 4.8%. duke marrë parasysh kontributin e sektorit të bujqësisë në PBB dhe shkallën e vlerësuar të punësimit në bujqësi, ka indikacion që ky është një sektor me shkallë të mirë efikasiteti. Megjithatë, kjo shifër (4.8%) mbulon vetëm punësimin formal në sektorin e bujqësisë. Sektori i bujqësisë në Kosovë po ashtu ofron një rrjetë të sigurisë sociale për një numër të madh të familjeve fshatare. Në këtë kuptim, një vëmendje e veçantë duhet kushtuar procesit të zhvillimit të politikave dhe mekanizmave për zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale me qëllim të reduktimit të faktorëve të pakënaqësisë për parandalimin e mëtejmë të migrimit të popullsisë nga zonat rurale. Pjesëmarrja e familjeve bujqësore në numrin total të familjeve sipas komunave paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

FIGURA 49– PËRQINDJA E EKONOMIVE FAMILJARE BUJQËSORE NË TOTALIN E EKONOMIVE FAMILJARE SIPAS KOMUNAVE



Ekonomia rurale në Kosovë ende karakterizohet nga infrastruktura e dobët (megjithëse disa përmirësime janë bërë viteve të fundit), përdorimi i tokës në mënyrë jo të duhur, konsolidimi i tokës jo i plotë, dhe privatizimi jo i plotë i tokës në pronësi shoqërore me paqartësi të të drejtave të pronësisë dhe shfrytëzimit, (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, (MBPZHR), 2013a). Pjesa e tokës së përdorshme bujqësore në sipërfaqen totale sipas komunave jepet në grafikun në vijim.

FIGURA 50 – PËRQINDJA E SIPËRFAQES BUJQËSORE TË SHFRYTËZUAR NË TOTALIN E SIPËRFAQES SË KOMUNËS



Bazuar në rëndësinë e bujqësisë, politikat bujqësore vazhdimisht janë bërë më të rëndësishme për zhvillimin e tyre duke marrë parasysh rëndësinë e bujqësisë në bruto produktin vendor sipas aktivitetetve ekonomike në çmimet aktuale, ku bujqësia në vitin 2019 kishte një pjesëmarrje prej 7.7%.

Brenda kornizës së Programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Kosova ka përpiluar dokumentin e Programit Vjetor Kombëtar bujqësi dhe zhvillim rural, me qëllim të afrimit gradual të politikave bujqësore me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së.

Kosova nuk ofron mbulim të sigurimi të kulturave bujqësore, mirëpo ofron pak ndihmë financiare për fermerët që janë dëmtuar nga ngjarjet e shkaktuara të motit ekstrem. Sa u përket fermave, peizazhi bujqësor në Kosovë është shumë më ndryshe nga ai në BE. Në kontrast me strukturën e fermave në BE, një karakteristikë e rëndësishme në Kosovë është dominimi i fermave të shkallës së vogël me nivel të ulët të integrimit në treg. Regjistrimi i përgjithshëm i bujqësisë i kryer në Kosovë në vitin 2014 (ASK, 2015) ka numëruar 130,436 familje bujqësore dhe biznese individuale. Sipërfaqja mesatare e një ferme 3.2 ha, duke përfshirë afër 60% të fermave me sipërfaqe deri 1 ha. Ermat me tokë të punueshme mes 0 dhe 0.5 ha janë më të zakonshmet – 35.3% e

numrit total të fermave. Në sektorin e bagëtisë, numri mesatar i njësive të bagëtië (LSU) për fermë është 3. Kështu, fermat e vogla jaë prodhuesit më të shpeshtë në Kosovë, që do të thotë që prodhimtaria dhe qëndrueshmëria e tyre janë qendrore për performancën e përgjithshme të bujqësisë në Kosovë. Për këtë arsye, komercializimi i këtij grupi të fermerëve është krucial për rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë e bujqësisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve në zonat rurale.

Të dhënat e fundit nga viti 2019 tregojnë të njëjtën strukturë dhe karakteristika të fermave. Sipërfaqja totale e tokës së punueshme në Kosovë është 44.8%, që përfshin sipërfaqen e tokës që kultivohet rregullish me kultura të ndryshme, apo me një rregull të caktuar të kulturave. Sipërfaqja e tokës së punueshme të përdorur i referohet sipërfaqes kryesre gjatë një vitit të prodhimit bujqësor. Në vitin 2019, toka e përgjithshme e punueshme ishte 0.11 ha per capita, derisa mesatarja e sipërfaqes së përdorshme bujqësore për kokë banori ishte 0.24 ha.


Në Kosovë, sipërfaqja e tokës 2 deri 5 ha paraqet 35% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme, pasuar nga sipërfaqja 5 deri 10 ha (21%), sipërfaqja 1 deri 2 ha (16%) dhe sipërfaqet tjera me më pak pjesmarrje ku sipërfaqja më e vogël është nga 0 deri 0.5 ha.

Numri më i madh i fermave bujqësore në Kosovë është në sipërfaqe nga 0 deri 0.5 ha (30.4%), pasuar nga sipërfaqja 2 deri 5 ha (23.0%), pastaj 1 deri 2 ha (21.9%) dhe grupet tjera. Numri më i vogël i femrave bujqësore është në sipërfaqet: 20 deri 30 ha (0.2%) dhe 30 e më shumë (0.2%).

Sipas Hulumtimit mbi fermat bujqësore (AHS) për vitin 2019, nga numri total i sipërfaqes së përdorur të tokës bujqësore, pjesa më e madhe u takon livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën shoqërore) me 51.9%; toka e punueshme me fusha merr 44.8%; kulturat shumëvjeçare (frutat, vreshtat, fidanishtet) me 3.0%; dhe kopshtet me 0.3%.

FIGURA 51 – STRUKTURA E SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE TË SHFRYTËZUAR

(in %)




Burimi: Anketimi i ekonomive bujqësore, 2019

Nga totali i tokës së punueshme (188 364.69 ha), pjesa më e madhe është me drithëra 124 198.96 ha (65.9%); bimë foragjere 37 496.72 ha (19.9%); perime (në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte) janë 9 958.80 ha, nga të cilat perime në fushë dhe sera janë 8 836.68 ha (4.7%); patate 3 688.19 ha (2.0%); bishtaja 2 997.00 ha (1.6%); bimë industriale 401.92 ha (0.2%); kultura tjera 2 580.42 ha (1.4%) dhe tokë ugar 8 164.80 ha (4.3%).

FIGURA 52 – STRUKTURA E TOKËS SË PUNUESHME – FUSHAT ME KULTURA

(in %)




Burimi: Anketimi i ekonomive bujqësore, 2019

Sipëraqa e ujitur e tokës, së paku një herë gjatë periudhës referente të hulumtimit, është 31 899.99 ha. Derisa sipërfaqa totale e tokës e trajtuar me pesticide është 19 050.93 ha.

Sipas rezultateve të hulumtimit AHS 2019, numri i bagëtive është 257 733 kokë; dele 189 102 kokë; dhi ishin 27 197 kokë; derra 40 538; kuaj, mushka, gomarë 2 037 kokë; shpezë (pula, biba, pata e rosa) 2 665 262 kokë; dhe numri total i koshereve të bletëve ishte 219 831.

Përmes hulumtimit AHS të dhëna janë grumbullar edhe për të punësuarit në bujqësi varësisht nga angazhimi, me orar të plotë, apo të pjesshëm. Sipas AHS 2019, numri total i njerëzve të angazhuar në bujqësi në Kosovë ishte 270 181. Kontributi i tre total në punësim në bujqësi ishte 82 656.98 Njësi Punë Vjetore (AWU) (ku 1 AWU është e barabartë me 1 800 orë punë në vit / 225 ditë pune / 8 orë në ditë).


FIGURA 53 – FUQIA PUNËTORE NË BUJQËSI (AWU) DHE NUMRI I TË PUNËSUARVE SIPAS LLOJIT TË FUQISË PUNËTORE



Burimi: Anketa e bujqësisë, 2019

Pjesa më e madhe e punës në familjet bujqësore kryhet nga familja, siç edhe shihet nga grafiku në vijim, shumica e fuqisë punëtore janë bartësit me 55.2% dhe anëtarët tjerë të familjes 39.5%, derisa grupet tjera kanë pjesmarrje më të vogël.

FIGURA 54 – PUNA BUJQËSORE (AWU) NË EKONOMI BUJQËSORE SIPAS LLOJIT TË FUQISË PUNËTORE



Burimi: Anketimi i ekonomive bujqësore, 2019

Sa u përket anëtarëve të familjeve të bartësit që punojnë në fermë fuqia punëtore është gati e barabartë me pjesëmarrje të meshkujve me 51% dhe femrave 49%. Struktura e grupmoshave të bartëve është 35 deri 45 vjet që përbën grupin më të madh të kësaj strukture prej 33%, derisa grupmosha tjetër është 45 deri 55 vjet që përbën 25%.

4.13.2 - Pylltaria


Pyjet në Kosovë menaxhohen nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës (pjesë inegrale e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural) zyrtarët e të cilës kryejnë të gjitha punët profesionale si në pyjet shtetërore, ashtu edhe në ato private. Korniza ligjore sa u përket pyjeve dhe planifikimit dhe menaxhimit të pyjeve ende mbetet në fazat e hershme të saj. Implementimi i kufizuar dhe i pamjaftueshëm i ligjit dhe politikave tjera normative dhe rregullatore përbëjnë një kufizim shtesë për përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Zhvillimi ekonomik rural është një ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova sot. Pjesa më e madhe e popullsisë (62%) jeton në zonat rurale dhe jetesa e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi varet nga prodhimtaria bujqësore. Është shumë e rëndësishme që të rritet gjenerimi i të hyrave për komunitetet e varfëra dhe ato vulnerabël në zonat rurale, e po ashtu të promovohet zhvillimi ekonomik.

Rreth 44.7% e sipërfaqes tokësore të Kosovës (481,000 ha) mbulohet me pyje sipas Inventarit Kombëtar të Pyjeve (NFI) të kryer në periudhën 2012-2013, duke kontribuar në bruto produktit vendor nga 1.5 në 3%. Në këtë kuptim, pyjet e Kosovës kanë një potencial të madh ekologjik, social dhe ekonomik, i cili realizohet vetëm margjinalisht. Parashikohet që, nëse menaxhohet në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshme, sektori pyjor do të mund të ishte një burim i rëndësishëm i punësimit për komunitetet e varfëra rurale, dhe në përgjithësi të përmirësojë kushtet e jetesës në fshat.

Në grafikun në vijim paraqitet një krahasim mes mbulueshmërisë me pyje të Kosovës dhe BE & OECD.

FIGURA 55 – MESATARJA E MBULUESHMËRISË PYJORE MES KOSOVËS DHE EU& ECD, (% TË TERRITORIT), 2016



Burimi: (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës (2019), Raporti i Gjelbër i Kosovës 2019, ëëë.mbpzhr-ks.net/repository/docs/ENG_Raporti_i_Gjelber_2019.pdf; Banka Botërore (2020), Indikatorët e Zhvillimit Botëror (databaza), atabhttp://datatopics.ëorldbank.org/ëorld-development-indicators.)

Tabela e mëposhtme tregon të dhënat bazike të formave silvikulturale sipas pronësisë.

TABELA 40 – TË DHËNAT BAZË PËR FORMËN SILVIKULTURORE DHE PRONËSINË E PYJEVE NË KOSOVË (HA)

Origjina e bimës	Shtetërore	Private	E panjohur	Totali
Farëzim natyror	58,400	13,600	1,000	73,000
Bmë dhe farëzim artificial	2,000	800	-	2,800
Cungishte	229,000	164,800	-	397,800
Cungishte me standarde	5,800	1,600	4,000	7,400
Totali	**295,200**	**180,800**	**5,000**	**481,000**

Cugishtet dominojnë mBi pyjet e larta me (84%) pyjet në pronësi shtetërore dominojnë ato private me (62%). përafërsisht 62% e pyjeve (295,200 ha) janë publike, dhe 38% (180,800 ha) janë në pronësi private (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2019). Kjo është një llogaritje e përfarërt, përderisa nuk ka statistika zyrtare sa i përket madhësisë dhe vlerës së pyjeve për shkak të mungesës së monitorimit të rregullt nga autoritetet publike. Stoku i pyjeve që rriten është pak a shumë i njëjtë si gjatë vlerësimit të kaluar NFI (rreth. 481 milion m^3), dhe speciet më të shpeshta të pemëve janë ahu (*Fagus* sp.) me 46% të vëllimit, dhe speciet e ndryshme të lisit (*Quercus* sp.) që kontribuojnë me 23% të vëllimit. Mesatarja e stokut arrin 84 m^3/ha. Shkalla mesatare vjetore e prerjes arrin në 950.000 m^3.[19] Pjesa më e madhe e sipërfaqes pyjore përbëhet nga pjet gjethegjera (93%), nga të cilat më shumë se gjysma konsiderohen të moshuara në mënyrë të njëtrajtshme[20]. Duhet të theksohet që pjesa më e madhe e vëllimit vjetor të drurit të prerë përdoret për ngrohje (rreth. 1 milion

[19] *Republika e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2013): Inventari Kombëtar i Pyjeve 2012, Prishtinë 2013, f.8*

[20] *Idem, p. 22.*

m^3), dhe megjithëse ka potencial të madh për përdorimin apo eksportimin e lëndës së drurit, vetëm një sasi e vogël e lëndës së drurit prehet për qëllime industriale (vetëm 70,000-90,000 m^3 gjatë dekadës së kaluar, edhepse ka mjaftueshëm lëndë druri për të furnizuar dyfishin e kësaj sasie)[21].

Prerja ilegale e drurit më shumë i ngjan një kombinimi të prerjes në shkallë të vogël nga njerëzit lokalë për shkak të varfërisë dhe prerjes ilegale komerciale më të organizuar. Shpeshherë përdoren vetëm pjesët më të vlefshme të drurit, duke lënë pas pjesë shumë të mira. Përveç kësaj, drurët që mbesin shpesh dëmtohen, gjë që është e papërgjegjshme, por edhe joefikase, sepse mund të kontribuojë në përhapjen e insekteve dhe sëmundjeve të pyllit. Llogaritjet tregojnë që rreth 40% e pyjeve publike dhe 29% e atyre private i nënshtrohen prerjes ilegale dhe që një pjesë e madhe e pyjeve të reja dhe atyre të moshës së mesme kërkojnë intervenim të menjëhershëm, d.m.th. pastrim dhe rrallim[22].

Aktivitetet në trajtimin e pyjeve të reja

Rrallimi ka rëndësi të veçantë për përmirësimin e pyjeve të reja dhe ka për qëllim rriten e cilësisë dhe produktivitetit të pyjeve me anë të përmirësimit të kushteve për rritje dhe zhvillim. Përveç kësaj, Agjencia Pyjore bashkë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke implementuar një projekt të përbashkët me angazhimin e punëtorëve sezonalë për trajtimin e pyjeve të reja. Me implementimin e këtij projekti, rrallimi është kryer në një zonë prej rreth 306 ha dhe është përfituar rreth 1,959 m^3 dru.

TABELA 41 – RRALLIMI PARAKOMERCIAL, 2019

Table 68: Pre-commercial thinning, 2019

Departments Departamentet	Volume in m^3 Volumi në m^3	Area in ha Sipërfaqja në ha
Prishtina	182	52
Gjilan	332	56
Peja	99	34
Mitrovica	348	52
Ferizaj	835	76
Prizren	163	36
Total	**1,959**	**306**

Source: Kosovo Forest Agency, KFA/Burimi: Agjencia e Pyjeve të Kosovës, APK

Aktivitetet në pyjet private

Agjencia e Pyjeve dhe autoritetet komunale të pyjeve, në kornizën e implementimit të Ligjit për Pyjet sa i përket decentralizimit të përgjegjësive në planifikimin vjetor, duhet të bëjnë rregullimin e pyjeve private me anë të shërbimeve teknike dhe profesionale që kryhen nga Agjenca e Pyjeve sa i përket implementimit të planifikimit dhe shenjëzimit të drurëve. Lëshimi i lejeve për prerjen e durëve në pyjet private si edhe shërbimet e transportimit të drurit (lejet e transportit, lejet e prerjes, regjistrat e shënimeve, etj.) kryhet në nivel komunal.

Në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve të Pyjeve Private, Agjencia e Pyjeve ka realizuar mbështetjen e pronarëve privatë me pyllëzimin e rreth 84 ha, ripyllëzimin e 13 ha, kultizimin e 3,379 ha, dhe bazuar në kërkesën e pronarëve, ka përgatitur plane për përdorimin e 4,750 ha në 101 zona pyjore. Autoritetet komunale në bashkëpunim me Agjencinë e Pyjeve kanë planifikuar të kryejnë prerjen e 161,685 m^3 të drurit në vitin 2019.

---

[21] Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor (): Plani Hapësinor i Kosovëss, Strategjia për Zhvillimin Hapësinor 2010-2020+, f. 48.

[22] Ibid.

Zjarri në pyje është një sfidë tjetër e madhe. Numri i zjarreve dhe zonës së ndikuar nga to rritet nga viti në vit. Ne vitin 2018 Agjencia e Pyjeve ka identifikuar 83 zjarre në pyjet publike dhe private, duke afektuar rreth 949 ha (Ministria e Bujqësisë, Pylltrisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, 2019). Për pronarët e pyjeve, kjo paraqet një humbje ekonomike.

Bazuar në planin vjetor për menaxhimin e pyjeve, pyllëzimi i tokave pyjore është bërë në tërë territorin e Kosovës, që përfshin rreth 418 ha. I gjithë pyllëzimi i tokave pyjore është bërë në bazë kontraktuale mes Agjencisë Pyjore dhe ndërmarrjeve private.

Përbërja e drurëve të prerë në pyjet në pronësi shtetërore sipas komunave paraqitet në TABELA 42.

TABELA 42 – PËRBËRJA E DRURËVE TË PRERË NË PYJET SHTETËRORE

Table 67: Implementation of the use of state-owned forests

Departments	Technical coniferous wood	Technical wood sawn	Fire wood	Waste	Total m³
Prishtina	0	1	647	-	649
Peja	108	302	4,199	-	4,214
Mitrovica	-	677	231	15	246
Prizren	108	302	3,220	286	3,916
Gjilan	1,395	224	7,149	752	9,519
Ferizaj	-	-	3,469	-	4,146
DMKE	-	-	1,798	-	1,798
Total	**1,518**	**1,203**	**20,713**	**1,052**	**24,486**

Source: Kosovo Forest Agency, KFA

4.13.3 - Gjuetia

Relievi dhe ortografia e Kosovës ofrojnë habitate të cilësisë së lartë për një varietet të gjerë të specieve për gjueti. Ultësirat dhe kodrinat janë habitate të përshtatshme për kaprollë, derra të egër, drerë, laraska e garguj, thëllënza, fazanë, qukapikë, korba të kaftë, pëllumba, etj., derisa zonat malore jan shtëpi për arinjtë, dhelprat, rruqebujt, ujqërit, shpendë të vogla dhe të mëdha të egra, pula të pyllit, thëllënza dhe ketra.

Aktivitetet e gjuetisë në Kosovë rregullohen me anë të Ligjit për Gjuetinë sipas të cilit çdo person i cili kryen aktivitete të gjuetisë duhet të pajiset me leje valide. Lëshimi i këtyre lejeve bie nën jurisdiksionin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në konsultim me Departamentin e Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ligji përcakton zonat ku lejohen këto aktivitete, armet që mund të përdoren dhe teknika e gjuetisë repektivisht. Të gjitha këto varen nga ajo nëse qëllimi i aktivitetit është rekreativ, ekonomik, shkencor apo i ngjashëm[23].

Sipas analizave të biodiversitetit të Kosovës të kryer nga USAID në vitin 2018, ka pak të dhëna mbi fondin e kafsheve te gjuetise në Kosovë. Asociacioni i Gjahtarëve të Kosovës ka kryer studime mbi popullimet të jetës së egër në të kaluarën, mirëpo që nga viti 1999 nuk janë bërë hulumtime mbi jetën e egër dhe nuk ka të dhëna të besueshme mbi speciet dhe numrin e popullimeve të egra.[24]

Nuk ka të dhëna publike mbi zonat e gjuetisë në Kosovë, mirëpo dokumenti i mëparshëm deklaron që ekzistojnë dy zona speciale për gjueti të përcaktuara sipas Ligjit për Gjuetinë dhe Menaxhimin e Jetës së egër, Blinaja/Lipovica dhe Duboqaku, ku qëllimi kryesor është ruajtja e jetës së egër. Zonat e veçanta të gjuetisë së kashëve të egra menagjohen nga APK, bazuar në Strategjinë kombëtare për qëndrueshmërinë e boës së egër dhe menaxhimin e gjuetisë 2010-2023.[25] Ligji për gjuetinë përcakton llojet e zonave të gjuetisë (të hapura, të

---

[23] *https://www.rks-gov.net/EN/f269/environment-and-nature/hunting-and-fishing*

[24] *USAID, 2018: Kosovo Biodiversity Analysis, p. 12*

[25] *USAID, 2018: Kosovo Biodiversity Analysis, p. 15*

rrethuara dhe zona të gjuetisë për shumimin e kafshëve të egra), dhe sa i përket të drejtave pronësore, ato mund të jenë private, shoqerore apo të rëndësisë së veçantë.

Sipas nenit 6 të Ligjit për Gjuetinë, menaxherët e zonave të gjuetisë, gjahtarët dhe personat tjera juridikë apo fizikë të përfshirë në gjuetinë në territorin e Kosovës mund të bëhen anëtarë të Federatës së Gjahtarëve të Kosovës. Federata i përfaqëson anëtarët e saj në vend dhe jashtë vendit për të mbrojtur interesat e tyre dhe inkurajimin e rritjes, mbrojtjes, gjuetisë dhe përdorimit të kafshëve të egra, mbrojtjen e ambientit, ruajtjen e habitateve natyrore të kafshëve të egra, krijimin e etikës dhe traditës së gjahtarëve, dhe qëllimeve tjera lidhur me gjuetinë.

Akti parësor mbi planifikimin e gjuetisë në Kosovë është Programi për Zhvillimin e Gjuetisë, përderisa zonat e guetisë menaxhohen sipas planeve të menaxhimit të zonave të gjuetisë dhe planeve vjetore.

Çështja kryesore lidhur me aktivitetet e gjuetisë në Kosovë është gjuetia ilegale. Ekzistojnë raporte të shumta nga terreni lidhur me vrasjen ilegale të kafshëve të egra, e edhe të specieve të rrezikuara të cilat kërcënohen me zhdukje, megjithëse zyrtarët përgjegjës të Ministrisë e mohojnë këtë. Kafshët shpesh mbahen në robëri si atraksione nëpër restorante apo objekte tjera të ngjashme dhe vriten kryesisht për trofe. Megjithëse ka përpjekje të shumta brenda komunitetit për të mbrojtur dhe ruajtur jetën e egër në Kosovë, nuk ka veprime të mjaftueshme nga institucionet zyrtare si Ministria, policia dhe inspeksionet e gjuetisë.[26]

Disa projekte të ndryshme janë zhvilluar për të zhvilluar dhe avansuar menaxhimin e qëndrueshëm të faunës së egër dhe gjuetisë, por edhe për kultivimin e specieve të rralla të sportit në zonën e veçantë të gjuetisë në Blinajë, dhe janë marrë veprimet në vijim:

- Finalizimi i programit të zhvillimit për zonën e gjuetisë të interesit të veçantë të Blinajës, financuar dhe draftuar nga ekspertët e FAO-s.
- Finalizimi i projektit të renovimit të objekteve ndihmëse (depoja e rezervave ushqimore të kafshëve të egra, depoja e veglave, një thertore e vogël për trajtimin e kafshëve të egra pas gjuatjes, renovimi i burimit të ujit dhe rezervuarit, si dhe zgjatja e gypit kryesor për furnizim me ujë të pijshëm) në VGJRV në Blinajë në vlerë financiare prej EUR 70,880.

Për të krijar një databazë e cila do të ishte pjesë integrale e KPIS (Sistemit të Integruar të Policisë së Kosovës), jane grumbulluar shumë të dhëna nga gati të gjitha komunat sa i përket llojit, sasisë, moshës, gjinisë dhe shëndetit të kafshëve të egra, si edhe numrit të zonave të përbashkëta të gjuetisë të themeluara dhe të menaxhuara në Republikën e Kosovës.[27]

4.13.4 - Minierat dhe Industria

Shtytësi tradicional ekonomik në Kosovë kryesisht ka qenë industria (bujqësia dhe pylltaria, minierat dhe gjenerimi i energjisë), me prodhimin duke ofruar një kontribut të vogël në gjenerimin e pasurisë. Kosova sot është një ekonomi e vogël e hapur me një bazë produktive të kufizuar por në rritje. Shërbimet përbëjnë pjesën më të madhe të ekonomisë së Kosovës, duke përbërë deri në 47.5% të bruto produktit vendor dhe 65% të punësimit (Banka Botërore, 2021; Agjencia e Statistikave e Kosovës, 2021). Tregtia me shumicë dhe pakicë, shërbimet për patundshmëritë, transportin dhe magazinimin si dhe shërbimet financiare janë shërbimet më të mëdha në ekonomi (Agjencia e Statistikave e Kosovës, 2021). Industria përbën 26.4% të bruto produktit vendor -së, me kontributin më të madh që vjen nga sektorët e prodhimit dhe ndërtimit (11.7% dhe 8.5% të bruto produktit vendor, respektivisht) (Agjencia e Statistikave e Kosovës, 2021).

Sektori i Minierave tradicionalisht ka qenë një kontribues i rëndësishëm për Ekonominë e Kosovës. Përveç nxjerrjes së linjitit nga furnizuesi me energji, Kompania Elektroenergjetike e Kosovës (KEK), dhe nxjerrjes së

---

[26] *Ramadani, D. (2019): Gjuetia e paligjshme rrezikon faunën e Kosovës (https://prishtinainsight.com/illegal-hunting-endangers-kosovos-fauna-mag/, qasur më 20 shkurt 2022)*

[27] *Republika e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2020): Raporti I Gjelbër, Prishtinë 2020, p. 100*

materialeve të ndërtimit, the sektori formal i minierave ka stagnuar që nga intervenimi i NATOs në vitin 1999. Industria ka pësuar rënie gjatë viteve 1990 për shkak të mungesës së investimeve në pajisje, objekte dhe zhvillimin e minierave të reja.

Dy ish ikonat kombëtare të sektorit të minierave (Trepca dhe Ferronikeli) kanë ndaluar prodhimin në vitin 1999 dhe ende nuk kanë rifilluar operacionet minerare. Sektori minerar dhe metalurgjik në Kosovë kryesisht përfaqësohet nga kompleksi industrial i plumbit dhe zinkut në Trepçë; nga Ferronikeli, një prodhues i aliazhit të hekurit dhe nikelit; dhe nxjerrja në gurore dhe përpunim të materialeve të ndërtimit, dukë përfshirë edhe cementin.

Shumë nga minierat ekzistuese janë privatizuar, me shkallë të ndryshme të suksesit. Kompleksi minerar i Trepçës përmban minierat më të mëdha të Kosovës. Në pikën kulminante të prodhimit të saj në vitet 1970 dhe 1980, Trepca ka punësuar mbi 22,000 punëtorë dhe përbënte më shumë se 70 përqind të nxjerrjes së mineraleve të Jugosllavisë. Ferronikeli është privatizuar në vitin 2006 dhe është tani e vetmja fabrikë minerale metalurgjike plotësisht operacionale në Kosovë. Aty nxirret xehja e nikelit lateritik nga tri minierat e hapura (Dushkaja, Suka, dhe Gllavica). Ka pasur aktivitete tjera minerare jashtë Trepçës dhe Ferronikelit, veçanërisht për boksit, magnezium, hekur dhe krom, mirëpo kanë ndaluar operimin në vitin 1999 apo më herët. Ndikimi në qytetin e Mitrovicës ka qenë shumë i madh. Në vetëm një periudhë 10 vjeçare të regjistrimit të përgjithshëm, nga viti 1961 deri 1971, qyteti është rritur me 57,7% (nga 26,721 në 42,126).

Me 34%, plastika dhe druri kontribuojnë më së shumti në eksport, pasuar nga metalet me (31%), të cilat janë gati ekskluzivisht të nxjerra nga skrapi. Sektori energjetik në mënyrë të pafavorshme është ndikuar nga mungesa e investimeve për të zevendësuar pajisjet e vjetruara të Bllokut Lindor. Ekzistojnë dy termocentrale të linjitit dhe këto kanë po ashtu nevojë për rinovim thelbësor. Diku rreth 50% e tëre elektricitetit të gjeneruar nga KEK osë humbe për shkak të problemeve teknike, ose nuk paguhet nga konsumatorët, ashtu që kompania pranon pagesën vetëm për 40% të tërë energjisë që prodhon. KEK bën përpjekje të prodhojë energji sa për të mbuluar tregun vendor, megjithëse shkurtimet e herëpashershme nënkuptojnë që furnizimi me energji elektrike duhet të zëvendësohet me import.

Në këtë sektor ekziston një potencial i madh për investime të huaja. Kosova ka një gjeologji të llojllojshme të depozitave të metaleve dhe mineraleve të eksplorueshme duke përfshirë arin, kromin, nikelin, aluminin bakrin, metalet e hekurit dhe zinkun-plumbin. Kosova po ashtu ka rezervën e pestë më të madhe botërore të linjitit. Ka potencial për të eksploatuar arin, argjendin dhe mermerin. Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve rregullon sektorin e mineraleve, lëshon licensa të eksplorimit dhe nxjerrjes dhe siguron pajtueshmëri ligjore me standardet ndërkombëtare te nxjerrjes së mineraleve, ambientit dhe sigurisë. KPMM ofron informata kyçe teknike për ofertuesit prospektivë.

Kosova ende nuk është rikuperuar plotësisht nga lufta e vitit 1998–99 dhe që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 ka dështuar të ndërtojë një ekonomi stabile. Kompleksi minerar i Trepçës nuk është rikuperuar nga prodhimi i humbur gjatë luftës. Trepça në një kohë përbënte 70 përqind të bruto produktit vendor të Kosovës, mirëpo që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, ndarja e Mitrovicës mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve lojalë ndaj Beogradit i mban shumicën e objekteve të Trepçës të mbyllura. Sipas statistikave të ndryshme, kompleksi nuk mund të rihapet pa një investim të huaj prej së paku $650 milion për të riparuar dhe azhurnuar shkritoret dhe rafineritë.

4.14 - Infrastruktura dhe shërbimet publike

Projekti i planifikuar është në mes ose afër disa llojeve të sistemeve infrastrukturore:

- Sistemi i transportit - rruget, hekurdhat, komunikacioni
- Sistemi i energjisë –sistemi i energjisë elektrike, gazit dhe vajit
- Sistemi i menaxhimit të ujërave – furnizimi me ujë, kanalizimi, dhe sistemi i ujitjes.

Territori i Kosovës ka një infrastruktrë të përshtatshme rrugore për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme biznesore. Rrjeti rrugor përbëhet nga 630 kilometra rrugë kryesore. Infrastruktura rrugore e vendit është mirë

e zhvilluar. Ekziston një rrjet plotësisht i zhvilluar rrugor, në përgjithësi rrugët janë në kushte shumë të mira. Ekzistojnë disa rrugë kryesore që lidhin qytetet e mëdha të Kosovës. Përgjegjëse për mirëmbajtjen e autoudhëve dhe rrugëve rajonale është Ministria e Infrastrukturës, ndërsa për mirëmbajtjen e rrugëve lokale janë komunat. Me ndërtimin e autoudhës me Shqipërinë, Kosova është një pikë e rëndësishme lidhëse mes Europës Përëndimore me Detin Adriaik. Rrugët kryesore me rëndësi të lartë janë:

- Rruga kryesore M9 Prishtina- Peja,
- Rruga kryesore M25 Prishtina-Podujeva,
- Rruga kryesore M9 Prishtina-Pejë
- Rruga kryesore (Prishtina-Kaçanik)
- Autoudha "Ibrahim Rugova" Morina-Merdare është e rëndësisë së posaçme.

Kosova ka një sistem hekurudhor prej 330 km që mbulon tërë territorin e Kosovës duke lidhur veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin. Sistemi hekurudhor, përveç për transportin e udhëtarëve me qëllim privat dhe zyrtar, po ashtu ofron transportimin e mallrave të ndryshme me qëllim biznesi, në Kosovë dhe jashtë saj. Ky lloj transportimi bëhet jo vetëm me anë të hekurudhës, por po ashtu edhe në kombinim me mënyra tjera të transportit. Hekurudhat e Kosovës mundësojë ndërtimin e binarëve privatë industrialë nga linjat hekurudhore e deri te lokacioni i klientit. Divizioni komercial i Hekurudhave të Kosovës është trupi kryesor përgjegjës për tranportimin e mallrave përmes Hekurudhave të Kosovës. Tri linjat hekurudhore të Kosovës janë:


- Kaçanik – Fushë Kosovë – Mitrovicë,
- Fushë Kosovë – Pejë dhe
- Fushë Kosovë – Podujevë

Infrastruktura e Sektorit të TIK në Kosovë është kryesisht e ndërtuar me rrjet mikrovalor, kabllo optike dhe koaksiale (DOCSIS). Industria e telekomit është e liberalizuar, dhe legjislacioni ka adoptuar parimet regulatore të Bashkimit Europian dhe ka promovar konkurrencën. Disa nga provajderat më të mëdhenj të internetin janë PTK, IPKO, Kujtesa dhe Artmotion [7]

Sistemi aktual elektrik i shtetit është i dalë afati, jo adekuat dhe jo i besueshëm – duke paraqitur kështu sfida të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike e pengojnë investimin dhe prishin prodhimin, pengojnë shërbimet në arsim dhe shëndetësi. Shumë qytetarë ende djegin dru për ngrohje dhe për gatim. Që shkakton ndotje të ajrit e të cilat pastaj shkaktojë probleme respiratore dhe të tjera. Sot, kapaciteti operacional i rrymës elektrike në Kosovë është rreth 900 MW, gati e tëra që vjen nga dy fabrika të vjetra që operojnë me qymyr, Kosova A dhe Kosova B. Me rritjen e popullsisë, do të rriten edhe kërkesat dhe shtrëngimet për energji elektrike. Me qëllim që të arrihet kërkesa në rritje për energji, të reduktohen ndërprerjet e rrymës dhe të ulet lirimi i gazrave serë, Qeveria e Kosovës është duke e rehabilituar termocentralin Kosova B – i cili është më shumë se 30 vjet i vjetër – për ta sjellë në pajtueshmëri me direktivat e ndryshme europiane dhe për të ndërtuar një termocentral linjiti të ri, më efikas për ta zëvendësuar termocentralin 45 vjeçar shumë ndotës të Kosovës A. Zbrazëtira e lënë nga dekompozimi i termocentralit Kosova A dhe kërkesa në rrritje për energji pritet të plotësohet me kombinimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme me një gjeneratë të re të linjitit. Ferma e parë me erë e Kosovës, centrali 32 MVV i Kitkës, ka filluar punën në fund të vitit 2018, dhe në dhjetor 2019, BERZH ka aprovuar një kredi për centralin 105 MVV të Bajgorës. Që nga fundi i vitit 2018, Kosova ka pasur të instaluar vetëm 7 MVV PV solare, edhe pse vendi ka një central prodhimi. Interkonektori i rrjetit të transmisionit të Kosovës me rajonin dhe Europën kryesisht bëhet me linjat e nivelit të voltazhit 400kV. Kosova po ashtu është e ndërlidhur me shtetet fqinje përmes linjave 220 kV dhe 110kV. Kosova ka një rrjet të fortë ndërlidhjeje i cili do të përforcohet me anë të ndërtimit të linjës Kosova B - Kashar (Tirana) 400kV. Nga viti 2000 - 2012, janë bërë investime për të rritur dhe përmirësuar kapacitetet e rrjetit të transmisionit. Ky investim ka rritur sigurinë e furnizimit dhe humbjet e transmisionit janë zvogëluar në masë të madhe – në vitin 2012 humbjet në transmision ishin 1.99% nga konsumi bruto. Në vitet e fundit ka pasr investime në rrjetin e distribucionit, të cilat megjithatë ishin të pamjaftueshme për të sigurar

cilësi dhe furnizim të besueshëm të rrymës elektrike për konsumatorët. Rrjeti i distribucionit përfshin linja voltazhi prej 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstacionet relevante.

FIGURA 56 – RRJEDHA E ENERGJISË ELEKTRIKE NËPËRMJET LINJAVE LIDHËSE (BURIMI: DEKLARATA E SIGURISË SË FURNIZIMIT PËR KOSOVË (ELECTRICITET, GAZ NATYROR DHE NAFTË), 2013)



Në këtë moment nuk ka infrastrukturë funksionale dhe treg të gazit natyror – Kosova nuk është e lidhur me ndonjë nga rrjetet e furnizimt me gaz natror. Për këtë arsye furnizimi dhe konsumi me gaz natyror është i kufizuar në LPG (liquefied petroleum gas-gazin petrol të lëngëzuar). Një lidhje me furnizim me gaz natyror do të ishte një opsion i rëndësishëm për të diversifikuar furnizimin me lëngë djegëse në vend dhe për të rritur sigurinë e furnizimit. Projekti i gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP) është për të ndërlidhur sistemin ekzistues me atë të planifikuar të transmisionit të gazit të Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë projektin TAP) me sistemin e ardhshëm të projektuar të transmisionit të gazit të Republikës së Kosovës, dhe interkonektorët e transmisionit që janë pjesë e degës lindore të Unazës Komunitetit të Energjisë së Gazit (ECGR), po ashtu. Projekti ka për qëllim të vendosë një linjë të re të furnizimit me gaz natyror nga Lindja e Mesme dhe Rajoni Kaspik transportuar nga Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), në drejtim verilindor të Ballkanit Përëndimor drejt Serbisë. Projekti ALKOGAP megjithatë duhet të planifikohet si një gazsjellës dykahor, ashtu që drejtimi i mundshëm i furnizimit po ashtu mund të jetë veri-jug, nga ECGR, apo burime tjera. Ndërtimi i këtij gazsjellësi të transmisionit do të mundësojë gazifikimn e Shqipërisë dhe Kosovës* dhe të ofrojë një furnizim të diversifikuar dhe të besueshëm me gaz natyror. Ky projekt i transmisionit të furnizimit, në gjatësi totale prej rreth 260 km do të krijonte parakushtet për zhvillimin e mëtejmë të tregut të gazit të Shqipërisë dhe në krijimin dhe zhvillimin e tregut të gazit natyror në Kosovë* në një nivel të përllogaritur prej 1.5 - 2 bcm (1-1.3 bcm për Shqipëri dhe 0.5 - 0.7 bcm për Kosovë*). Do të jetë e mundur të rritet kapaciteti i tij (dyfish apo trefish), në rast se ALKOGAP do të përdoret për ta furnizuar Serbinë dhe vendet e tjera të rajonit me gazin kaspik apo të Lindjes së Mesme.

Kosova nuk ka as prodhim të naftës së papërpunuar, e as import të naftës së papërpunuar. Ekzistojnë dy fabrika të licencuara të prodhimit, të cilat momentalisht prodhojnë karburant nafte, i cili kryesisht përdoret për ngrohje. Njëra nga fabrikat e sipërpërmendura ka prodhuar dizel po ashtu, mirëpo e ka ndërprerë prodhimin e naftës

dizel në vitin 2012. Në vitin 2012 këto dy fabrika kanë furnizuar tregun vendor me 11.1 ton të naftës për djegie. Lënda e parë e përdorur për prodhimin e nafës është vajgazi, kerozina dhe nafa e trashë që përmban më shumë se 2% sulfur.

Pellgjet ujore të Kosovës pritet të provojnë një rritje të stresit të ujit gjatë 20 viteve të ardhshme me rritjen e popullsisë, kufizime të resureve dhe rritje të kërkesave për përforcimin e sektorëve të ujitjes, minierave dhe energjisë. Për më tepër, shumica e këtyre pellgjeve janë ndërkufitare dhe të ndjehme ndaj rreziqeve si përmbytjet, thatësirat dhe ndotja. Sektori bujqësor i vendit është shumë i varur nga uji (me 140 milion m^3/në vit nxjerrje) – megjithëse infrastruktura e varfër dhe mungesa e investimeve e kufizon disponibilitetin e tij. Për më tepër, Kosova ka një infrastrukturë të rrënuar dhe të dalë afati, si dhe kapacitet të ulët të prodhimit të energjisë (0.8 kilovat për banor), dhe kapacitet të ulët të instaluar të fuqisë ujore (52 megavat).

Megjithatë, vetëm një përqind e popullsisë aktualisht shfrytëzon shërbimin e trajtimit të ujit të kanalizimit. Me tri tjera të planifikuara dhe nën implementim, shumë shpejt kjo përqindje do të rritet në mënyrë të ndjeshme pasiqë fabrikat e trajtimit të ujërave të zeza janë duke u ndërtuar në lokacionet me dendësi të madhe si Peja, Gjakova dhe Prishtina.

Infrastruktura e vjetërsuar e ujitjes dhe mungesa e mirëmbajtjes e kanë reduktuar përdorimin e sistemit të ujitjes duke ndikuar kështu në zhvillimin e bujqësisë. Shumica e skemave të sistemit të ujitjes janë ndërtuar në vitet 1970 dhe kanë filluar të shfaqin shenja të rrënimit. Për më tepër, lufta në vitet 1990 i ka dëmtuar apo shkatërruar sektorë të tërë të infrastrukturës së ujitjes së vendit. Sipërfaqa e pajisur për ujitje ka rënë nga përafërsisht 71,000 ha para luftës në 43,900 ha në vitin 2014. Ekspansioni i zonave urbane dhe industriale në vitet e fundit, po ashtu ka reduktuar sipërfaqen e ujitshme ashtu që sipërfaqa aktuale e tokës nën ujitje është më e vogël se në të kaluarën. Mungesa e planifikimit të integruar hapësinor dhe ndërtimit shirit të përmendur më herët, ndikon në tokën e mirë bujqësore, në veçanti bujqësinë me ujitje e cila varet nga kanalet që qarkullojnë ujin. Veçanërisht Iber-Lepenci dhe Dukagjini kanë vuajtur nga ndërtimet e planifikuara në tokën e pajisur me sistem të ujitjes dhe nga shkatërrimi i infrastrukturës, si dhe nga ndotjet urbane që ndikon në cilësinë e ujit dhe qarkullimin nëpër kanale. Mes viteve 2006 dhe 2012, mesatarja e sipërfaqes së ujitur ishte vetëm rreth 12,000 ha - 4,000 ha në skema të vogla dhe 8,000 ha brenda zonave të shërbimit nga tri kompanitë rajonale të ujitjes: Iber-Lepenci, Radoniqi-Dukagjini dhe Drini i Bardhë, i cili është shumë më poshtë se zona e pajisur, lëre më potencialin e ujitjes në vend. Duhet të theksohet se ka gjasë që ka më shumë sipërfaqe që ujitet se sa që raportohet, nga puse të vogla, diversione dhe po ashtu nga uji i pijshëm, kryesisht për përdorim në fermat private dhe shpesh edhe me pompa të vogla dhe sisteme të ujitjes me rënie të lirë.

4.15 - Zhurma

Ndotja nga zhurma është veçanërisht e rëndësishme në vendet në zhvillim, si Kosova. Kjo është kryesisht për shkak të trafikut rrugor. Në zonat me trafik të rënduar, nivelet e presionit të zërit gjatë ditës mund të arrijnë 70 dB (A). Ndotja e rritur e zërit ka ndikime negative në shëndetin e njeriut. Burimet kryesore të ndotjes së zerit përfshijnë: trafikun, industrinë, ndërtimin, etj. KEC ka bërë matjen e zhurmës në disa pjesë nga korriku deri në dhjetor 2011. Po ashtu edhe Komuna e Prishtinës ka bërë matjen e zhurmës në pjesë të ndryshme të qytetit. Matjet e zhurmës bëhen në bazë të Nenit 9 të ligjit mbi sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit të Republikës së Kosovës Nr. 2003/19 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2009 mbi vlerat e lejuara të emisionit të lejuar të zerit dhe burimeve të ndotjes. Pikat e monitorimit të zhurmës – vibrimet – të monitoruara nga DLP 2010 janë: Sibofci-JP-L.Berisha, Shipitullë, Hade, Bardh, Dardhishtë, Palaj.

Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore dhe administrative në përputhje me standardet mjedisore dhe klimatike të BE-së duke e fokusuar vëmendjen në miratimin e legjislacionit sekondar dhe decentralizimin e përgjegjësive për monitorimin dhe zbatimin e politikave mjedisore nga niveli qendror te ai komunal. Ligjet e mbetura të kësaj kornize lidhur me zhurmën duhet të miratohen dhe të kompletohen me legjislacion sekondar. Kriteret e rekomanduara për zhurmën sipas BE-së janë paraqitur në Raportin për gjendjen e ajrit, KEPA, 2012.

4.16 - Mbeturinat

Legjislacioni për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është në proces të harmonizimit me direktivat e BE-së. Dokumentet kryesore të planifikimit për menaxhimin e mbeturinave janë:

- Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave
- Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave
- Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave
- Plai për menaxhimin e mbeturinave nga pronarët e mbeturinave, dhe
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licensuar.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për politikën mjedisore, zbatimin e ligjeve dhe mbikqyrjen e aktiviteteve lidhur me mbeturinat. Agjencia e Kosovës për mbrojtjen e ambientit është institucion qeveritar që merret me monitorimin e integruar të mjedisit, sistemimin efikas të informatave mjedisore dhe raportim të vazhdueshëm mbi gjendjen mjedisore. Komunat janë përgjegjëse për krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbeturinave për territorin e tyre respektiv, duke krijuar planet e tyre për menaxhimin e mbeturinave dhe duke implementuar ato plane. Operatorët e licensuar-Kompania për Menaxhimin e Deponive është përgjegjëse për menaxhimin e objekteve dhe asgjësimin e mbeturinave në Kosovë duke përfshirë deponitë dhe stacionet transferuese.

Aktualisht, ekzistojnë katër deponi nën menaxhimin e operatorëve të licensuar – Kompania e Kosovës për menaxhimin e deponive (Prizren, Gjilan, Prishtinë, dhe Podujevë), dhe një stacioni transferi (Ferizaj). Kompanitë rajonale të mbeturinave janë operatorë të licensuar në pronësi të qeverisë lokale, që ofrojnë shërbime të mbledhjes së mbeturinave. Ekzistojnë shtatë kompani rajonale të mbeturinave, që operojnë në 7 rajone, 26 komuna ku jetojnë 93 % e popullatës.

Sistemi i tanishëm i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë është i paqëndrueshëm sa i përket aspektit mjedisor. Grumbullimi komunal i mbeturinave, transporti dhe hedhja e tyre nuk bëhet për të gjithë, dhe për këtë arsye mbeturinat e pa mbledhura që hudhen apo digjen kanë ndikime negative në shëndetin njerëzor, në ujë, ajër tokë dhe biodiversitet. Ngjashëm, mbeturinat e rrezikshme (në kanalizimin komunal) nuk mblidhen dhe nuk trajtohen ndaras dhe përfundojnë bashkë me mbeturinat tjera duke paraqitur kështu kërcënim për ambientin. Ujërat nëntokësore dhe toka veçanërisht janë të kërcënuar në objektet e zonave industriale dhe deponive të shumta që nuk i plotësojnë kriteret. Ndarja e mbeturinave në burim bëhet vetëm në disa komuna (pilot), dhe grumbullimi i materialeve të reciklueshme bëhet vetëm nga sektori joformal.

Mbeturinat e grumbulluara transferohen dhe pastaj asgjësohen në shtatë deponi sanitare, katër deponi jo-sanitare dhe disa pika statike të deponisë. Për mbeturinat e kafshëve, ato të rrezikshme dhe të mëdhajat nuk kanë një sistem të ndarë të trajtimit të tyre.

Në rajonin më të gjerë të projektit, Prishtina është rajoni më i gjerë urban me sistemin më të avansuar të menaxhimit të mbeturinave. Shërbimet për Rajonin e Prishtinës i kryen Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" me 6 njësi në komunat tjera. Deponia e Pristinës, "Mirashi" ka probleme të shumta operacionale dhe ambientale të lidhura me përmbytjen e deponisën me një përzierje të kullimit, ujit të shiut dhe ujit nëntokësor.

5 - PROBLEMET EKZISTUESE MJEDISORE QË JANË TË RËNDËSISHME PËR ZHG, PËRFSHIRË SIDOMOS ATO QË KANË TË BËJNË ME ZONAT ME RËNDËSI TË POSAÇME EKOLOGJIKE

Kapitulli 5 ofron një përshkrim të gjendjes së medisit, duke përfshirë çdo problem që është i pranishëm. Probleme ekzistuese po ashtu janë vërejtur në strategjitë kombëtare dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore. Due u bazuar në këto, jaë përcaktuar objektiva për mbrojtjen e mjedisit për të inkurajuar zgjidhjen e këtyre problemeve. Gjatë analizës së dokumentacionit në dispozicion nuk është identifikuar asnjë problem i rëndësishëm ekzistues që do të kufizonte ndërtimin e gazsjellësit, as probleme që në masë të madhe do të përkeqësonin ndërtimin e gazsjellësit. Megjithatë, më poshtë janë renditur problemet ekzistuese mjedisore në bazë të të cilave janë përcaktuar objektivat për mbrojtjen e mjedisit.

Çështja mjedisore	Problemet ekzistuese mjedisore
Ajri dhe ngarkesa ekzistuese e emisioneve	Cilësia e ajrit në qytetet më të mëdha është dukshëm më e e ndotur me grimca materiesh kryesisht për shkak të termocentraleve me thëngjill dhe lëndë djegëse solide të përdorur për ngrohje dhe gatim. Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit është i centralizuar rreth qyteteve më të mëdha, veçanërisht kryeytetit Prishtinë me 6/13 stacione që gjenden në qytet dhe rajonet përreth.
Klima dhe ndryshimi klimatik	Burime të dukshme lirimesh të gazrave janë termocentralet me thëngjill dhe sektori energjetik në përgjithësi për shkak të përdorimit të thëngjillit dhe drurit. Përdorimi i dukshëm i automjeteve të vjetra që lirojnë më shumë gazra serrë se automjetet e reja.
Gjeomorfologjia	Arsyet për ndryshimin e konfiguracionit të terrenit në territorin e Kosovës janë si në vijim: ■ Prerjet e pakontrolluara të pyjeve dhe zjarre ndikojnë në shkatërrimin e të gjitha sipërfaqeve tokësore, ■ Nxjerrja e gurit degradon pjesët kodrinore dhe nxjerrja e rërës dhe zhavorit dëmton shtretërit dhe brigjet e lumenjve, ■ Ndërtimi i pakontrolluar i infrastrukturës dëmton të githa format e relievit, ■ Nxjerrja e qymyrit për termocentralet në Rajonin e Prishtinës - deponitë e hirit dhe krateret e hapur të mihjes sipërfaqësore tërësisht e ndryshojnë formën e relievit (këtë zënë rreth 150 hektarë tokë), ■ Deponitë ilegale të mbeturinave dhe hudhja e pakontrolluar e mbeturinave shkatërron format ekzistuese të relievit.
Gjeorreziqet	■ Seizmiciteti – Kosova është një territor seizmik shumë aktiv me shumicën e shkarjeve aktive me magnitudë potenciale prej 6 apo më tepër. Problemet dalin nga ndërtesat e tanishme të ndërtuar dobët që mund të rrënohen. ■ Rrëshqitjet e dheut – rrështitjet janë një nga gjeorreziqet më dëmtuese dhe të rëndësishme në Republikën e Kosovës. Në territorin e Kosovës nuk ka rrjet monitorimi për rrëshqijet. Faktorët që ndikojnë në ndodhjen e rrëshqitjeve të dheut janë pjerrtësia e shpatit, variacioni i nivelit të ujit nëntokësor, stabiliteti i shpatit dhe aktiviteti njerëzor. ■ Përmbytjet – pjesa më e madhe e rrjetit të gazsjellësit ndodhet në një zonë me probabilitet të rritur të përmbytjeve. Përmbytjet mund të shkaktojnë dëmtimin e rrugëve, shkatërrimin e urave, erozion të fortë dhe depozita mbeturinash.

	■ Aktivitetet minerare-sasitë e mëdha të mbetjeve minerare dhe metalurgjike nga e kaluara vazhdojnë të jenë burim permanent i ndotjes së mjedisit.
Ujërat	Të gjithë pellgjet më të mëdha të lumenjve njihen dhe raportohen si të ndotura mesatarisht apo shumë të ndotura. Përdorimi dhe ndotja e ujit pritet të rriten me rritjen e zhvillimit ekonomik. Drini i Bardhë është lumi më i shëndetshëm për shkak se ka më pak shtypje dhe më shumë rrjedhë ujore, por ky lum po ashtu ndotet shumë në fund të rrjedhës së tij nga ujrat e zeza urbane dhe industriale e po ashtu edhe nga nitratet dhe fosfatet bujqësore. Ibri është pellgu më i ndotur për shkak të shtypjeve të larta ekonomike dhe të popullsisë dhe rrjedhës së ulët, veçanërisht në Lumin Sitnica. Kjo vë një barrë të madhe mjedisore dhe shëndetësore mbi popullatën dhe shkakton sipërfaqe të gjera të tokës së degraduar të dalin jashtë përdorimit. Për shkak të reduktimit drastik të prodhimit nga nivelet e para 1990-tës, ndotja nga industria dhe minierat është reduktuar, mirëpo disa probleme nga e kaluara janë ende të pranishme: mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe pajisjet dhe teknologjia e vjetër, sasi të mëdha të mbeturinave metalurgjike dhe minerare nga e kaluara, vazhdojnë të jenë burime të përherhshme të ndotjes së ambientit. Industria dhe termcentralet aktuale ende janë duke ndotur ambientin.
Toka dhe bujqësia	Zgjerimi i shpejtë i vendbanimeve urbane dhe rurale ka ndryshuar sipërfaqen e tokës; tokat bujqësore janë përjashtuar nga përdorimi i tyre primar dhe kapaciteti bujqësor është reduktuar me numrin në rritje të vendbanimeve të ndërtuara në tokën me cilësi të lartë. Ekonomia e Kosovës është shumë e varur nga sektori i bujqësisë, i cili llogaritet të jetë sektori më i madh i ekonomisë. Sektori i bujqësisë ka pësuar dëme të mëdha kur popullsia rurale ishte detyruar të largohet nga shtëpitë e tyre duke lënë pas bagëtinë dhe pajisjet. Në këtë gjendje, periudha e pasluftës e gjeti bujqësinë në një gjendje të shkatërruar me tokë të pa përdorshme, mungesë farërash, plehërash artificialë, pesticidesh dhe pajisjesh bazike. Mungesa e të dhënave të besueshme sa i përket ekonomisë dhe bujqësisë ka penguar zhvillimin dhe implementimiin e politikave efikase dhe monitorimin e procesit të ndryshimeve. Sfidat në sektorin e bujqësisë përfshijnë: ■ Sistemet e ujitjes ■ Mungesën e teknologjisë ■ Mungesën e informaave dhe njohurive. Sa u përket sistemeve të ujitjes, të gjeturat tregojnë që fermerët nuk kanë qasje në sistemet e sofistikuara të ujitjes për shkak të kufizimeve buxhetore. Shumica e fermave përdorin sistemin e spërkatësve dhe vetëm një pjesë e vogël mund të përballojë sisteme tjera. Furnizimi me ujë mbetet një sfidë për Kosovën për shkak se nuk është i qëndrueshëm; megjithatë, të anketuarit nga rajoni i Dukagjinit fatmirësisht konfirmojnë që ky nuk është problem. Kjo është për shkak të cilësisë më të mirë të dheut. Cilësia e dheut dhe furnizimi me ujë po ashtu ndikojnë në kultivimin e kulturave bujqësore, për këtë arsye rajoni i Kosovës është i kufizuar në kultivimin e misrit, derisa rajoni i Dukagjinit kultivon një sërë kulturash. Të gjeturat tregojnë që mungesa e teknologjisë adekuate vazhdimisht pengon produktivitetin dhe cilësinë e prodhimit. Fermerët përdorin makina të vjetra që nuk janë adekuate për kultivimin e kërkuar. Marrja me qira e makinave nga ata që i kanë ato u kushton bujqëve të cilat i kanë kushtet e vështira financiare. Për fund, shumica e fermerëve nuk kanë qasje në edukim formal në bujqësi. Njohuritë e tyre vijnë nga praktika e kaluar nga njëra gjeneratë në tjetrën
Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura	Kosova ka biodiversitet të pasur për shkak të klimës dhe gjeorafisë së saj unike. Është e mbushur me specie endemike dhe komunitete të bimëve, ipso facto,

	është e rëndësishme që këto thesare kombëtare të ruhen. Në vitet e fundit, Kosova ka pësuar ndryshime sociale, politike dhe ekonomike si dhe rritje në urbanizim. Inkonsistenca e Kosovës në qeverisje dhe urbanizim paraqet kërcënime të caktuara në biodiversitetin e saj. Këto kërcënime janë listuar më poshtë : ■ Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve, kryesisht për djegie ka krijuar ekosisteme pyjore tejet të degraduara. ■ Separacionet e zhavorit dhe nxjerrja e zhavorit dhe rërës nga lumenjtë pa restaurim është duke e shkatërruar habitatin. ■ Ndërtimi i rrugëve, veçanërisht autostradave, e fragmenton habitatin e kafshëve të egra. ■ Ndërtimi dhe puna e hidrocentraleve dhe aktivitetet ndihmëse shkatërrojnë ekosistemet ujore. ■ Ndërtimi ilegal në PA e fragmenton, degradon, dhe shkatërron habitatin. ■ Mbieksploatimi dhe marrja ilegale e bimëve dhe kafshëve të egra kërcënon disa nga bimët dhe kafshët më sensitive dhe të rrezikuara të Kosovës. ■ Ndotja është kërcënim, veçanërisht në biodiversietin ujor. ■ Ndryshimi klimatik ndikon në biodiversitetin e Kosovës.
Peizazhi	Degradimi i peizazhit është i pranishëm në tërë Kosovën për shkaqet në vijim: ■ Prania e deponive ilegale të mbeturinave, ■ Hudhja e pakontrolluar e mbeturinave gjithandej, ■ Zhvillim i paplanifikuar i vendbanimeve, shumë objekte të pa kontrollura, të papërfunduara dhe të pa përdorura, ■ Degradimi i lumenjve ■ Shkallë e lartë e ndotjes e shkaktuar nga linjiti, minierat e qymyrit dhe termocentralet ■ Mungesa e zonave të gjelbëra në vendbanime, ■ Mungesa e vetëdijësimit mbi trashëgiminë kulturore, mbrojtjen e ambientit dhe vlerave të natyrës, ■ Ndërtimi i pa kontrolluar i infrastrukturës brenda zonave të vlefshme natyrore.
Trashëgimia kulturore	Çështjet kryesore mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm të elementeve të trashëgimisë kulturore janë: ■ Mungesa e të dhënave precize mbi trashëgiminë kulturore ■ Numri i vogël i iniciativave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ■ Presionet për shkak të ndërtimit të paplanifikuar dhe zhvillimit hpësinor në përgjithësi, ■ Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore gjatë luftrave të kaluara.
Shëndeti njerëzor	Në përgjithësi, ajri në zonat urbane, dhe në veçanti në Prishtinë dhe Obiliq, vlerësohet të jetë disa herë më i ndotur se normat e lejuara. Mes ndotësve më të mëdhënj në Kosovë janë industria energjetike, industria metalurgjike, minierat, estraktimit, depozitat industriale dhe urbane, deponitë ilegale, transporti, bujqësia etj.
Popullsia dhe vendbanimet	Çështjet kryere të popullsisë dhe vendbanimeve janë:

	■ Rënia demografike, duke përfshirë rënien në rritjen natyrale të popullsisë, shkallën e fertilitetit. ■ Pjesëmarrje e ulët e popullsisë urbane 38 % (Regjistrimi 2011). ■ Më shumë se 30 % e popullsisë së përgjithshme të Kosovës jetojnë jashtë (Regjistrimi 2011) dhe migrimi i pafavorshëm i popullatës së re mbetet element sfidues për shoqërinë kosovare. ■ Vendbanimet rurale janë duke u shpopulluar. Ndotja nga zhurma është veçanërisht e rëndësishme në shtetet në zhvillim si Kosova. Kjo kryesisht ndodh për shkak të trafikur rrugor. Në zonat me trafik të dendur nivelet e presionit të ajrit gjatë ditës mund ë arrijnë 70 dB (A). Ndotja e rritur nga zhurma ka efekte negative në shëndetin e njeriut. Burimet kryesore të ndotjes së ambientit nga zhurma janë trafiku, industritë, ndërtimi, etj.
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë	**Bujqësia** Ekonomia rurale në Kosovë ende karakterizohet nga infrastruktura e dobët (megjithëse disa përmirësime janë bërë viteve të fundit), përdorimi i tokës në mënyrë jo të duhur, konsolidimi i tokës jo i plotë, dhe privatizimi jo i plotë i tokës në pronësi shoqërore me paqartësi të të drejtave të pronësisë dhe shfrytëzimit. Fermat e vogla janë prodhuesit kryesorë në Kosovë që do të thotë se produktiviteti dhe qëdrueshmëria e tyre janë qendrorë sa i përket performancës së bujqësisë së Kosovës në përgjithësi. Për këtë arsye, komercializimi i këtij grupi të fermerëve është krucial për rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë e bujqësisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve në zonat rurale. **Pylltaria** Kërcënimet më të mëdha për pyjet dhe pylltarinë si një degë e ekonomisë së Kosovës kanë të bëjnë me zjarret në pyje si rezultat i temperaturave të larta dhe neglizhencs, aktivieteve të pakontrolluara, prerjes ilegale dhe menaxhimin e dobët në përgjithësi. Menaxhimi jo adekuat i pyjeve pengon zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe pylltarisë. Aktualisht, ka rregullim, monitorim dhe kontroll të kufizuar të përdorimit të pyjeve publike dhe private. Raporti i Inventarit Pyjor i publikuar në vitin 2013 Zhvillimit Rural tregon që 90% e prerjes së pyllit nuk është në pajtim me planet e menaxhimit të pyjeve, politikat dhe rregullat e zbatueshme. Ka një potencial të madh ekologjik, social dhe ekonomik, i cili nëse menaxhohet në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshme, sektori pyjor do të mund të ishte një burim i rëndësishëm i punësimit për komunitetet e varfëra rurale, dhe në përgjithësi të përmirësojë kushtet e jetesës në zonat rurale. **Gjuetia** Çështja kryesore lidhur me aktivitetet e gjuetisë në Kosovë është gjuetia ilegale. Ekzistojnë raporte të shumta nga terreni lidhur me vrasjen ilegale të kafshëve të egra, e edhe të specieve të rrezikuara ë cilat kërcënohen me zhdukje, megjithëse zyrtarët përgjegjës të Ministrisë e mohojnë këtë. Kafshët shpesh mbahen në robëri si atraksione nëpër restorante apo objekte tjera të ngjashme dhe vriten kryesisht për trofe. Megjithëse ka përpjekje të shumta brenda komunitetit për të mbrojtur dhe ruajtur jetën e egër në Kosovë, nuk ka veprime të mjaftueshme nga institucionet zyrtare si Ministria, policia dhe inspeksionet e gjuetisë. **Minierat dhe industria si aktivitete kryesore ekonomike** Gjendja e tanishme e sektorit minerar kërkon implementimin e reformave të përshatshme ekonomike dhe strukturale që mundësojnë një përdorim më racional të resurseve natyrore dhe njerëzore. Mungesa e investimeve në pajisje, objekte dhe zhvilllimin e minierave të reja dhe industrinë e përpunimit në përgjithësi. Në këtë sektor ka potencial të rëndësishëm për investime të huaja, megjithatë situata politike i bën këto investime shumë të vështira.

Zhurma	Ndotja nga zhurma është veçanërisht e rëndësishme në vendet në zhvillim, si Kosova. Kjo është kryesisht për shkak të trafikut rrugor. Në zonat me trafik të rënduar, nivelet e presionit të zërit gjatë ditës mund të arrijnë 70 dB (A). Ndotja e rritur e zërit ka ndikime negative në shëndetin e njeriut. Burimet kryesore të ndotjes së zerit përfshijnë: trafikun, industrinë, ndërtimin, etj.
Infrastruktura dhe shërbimet publike	Sistemi aktual elektrik i shtetit është i dalë afati, jo adekuat dhe jo i besueshëm – duke paraqitur kështu sfida të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike e pengojnë investimin dhe prishin prodhimin, pengojnë shërbimet në arsim dhe shëndetësi. Shumë qytetarë ende djegin dru për ngrohje dhe për gatim. Që shkakton ndotje të ajrit e të cilat pastaj shkaktojnë probleme respiratore dhe të tjera. Në këtë moment nuk ka infrastrukturë funksionale dhe treg të gazit natyror – Kosova nuk është e lidhur me ndonjë nga rrjetet e furnizimt me gaz natyror. Kosova nuk ka as prodhim të naftës së papërpunuar, as importe të naftës së papërpunuar. Pellgjet ujore të Kosovës pritet të provojnë një rritje të stresit të ujit gjatë 20 viteve të ardhshme me rritjen e popullsisë, kufizime të resureve dhe rritje të kërkesave për përforcimin e sektorëve të ujitjes, minierave dhe energjisë. Për më tepër, shumica e këtyre pellgjeve janë ndërkufitare dhe të ndjeshme ndaj rreziqeve si përmbytjet, thatësirat dhe ndotja. Sektori bujqësor i vendit është shumë i varur nga uji (me 140 milion m^3/në vit nxjerrje) – megjithëse infrastruktura e varfër dhe mungesa e investimeve e kufizon disponibilitetin e tij. Megjithatë, vetëm një përqind e popullsisë aktualisht shfrytëzon shërbimin e trajtimit të ujit të kanalizimit. Infrastruktura e vjetërsuar e ujitjes dhe mungesa e mirëmbajtjes e kanë reduktuar përdorimin e sistemit të ujitjes duke ndikuar kështu në zhvillimin e bujqësisë. Shumica e skemave të sistemit të ujitjes janë ndërtuar në vitet 1970 dhe kanë filluar të shfaqin shenja të rrënimit.
Mbeturinat	Çështjet kryesore në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë: ■ Shumica e deponive nuk janë në pajtim me kriteret e vendosura në Direktivën e BE-së për deponitë, ■ Kapacitet i pamjaftueshëm dhe mungesë e objekteve për trajtimin e mbeturinave ■ Prania e deponive ilegale të mbeturinave dhe hedhja e pa kotrolluar e mbeturinave ■ Mungesë e të dhënave apo të dhëna me cilësi të dobët mbi praktikat e menaxhimit të mbeturinave

6 - OBJEKTIVAT E MBROJTJES SË MJEDISIT TË HARTUARA PAS PËRMBYLLJES SË TRAKTATEVE DHE MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE ME RËNDËSI PËR ZHG

6.1 - Harmonizimi i objektivave të ZHG dhe objektivave për mbrojtjen e mjedisit në bazë të traktateve dhe marrëveshjet ndërkombëtare

Në vijim janë përcaktuar objektivat për mbrojtjen e mjedisit të vendosura pas përmbylljes së marrëveshjeve ndërkombëtare që janë relevante për planin.

Çështja mjedisore	Objektiva e mbrojtjes mjedisore	Pajtueshmëria me dokumentin relevant
Ajri dhe ngarkesa emisioneve ekzistuese	Përmirësimi i cilësisë së ajrit me anë të reduktimit të lirimit të substancave ndotëse (SO_2, NOx, PM, CO_2, HCl, HF) nga fabrikat industriale/energjetike me anë të transicionit të karburanteve me përbërje të ulët karboni, p.sh. gazi natyral	Konventa për ndotjen e ajrit të spektrit të gjerë ndërkufitar - CLRTAP Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 24 nënorit 2010 mbi emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) Strategjia e cilësisë së ajrit 2013-2023 Plani i veprimit për implementimin e Strategjië për cilësinë e ajrit 2018-2020
Klima dhe ndryshimi klimatik	Parandalimi i transmisionit ndërkufitar të ndotjes së ajrit mbrojtja e strukturave dhe bimëve nga përmbytja dhe të reshurat ekstreme	Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin Klimatik (UNFCCC) Konventa mbi ndotjen e ajit të spektrit të gjerë ndërkufitar - CLRTAP Strategjia dhe Plani Kosovar i Veprimit për ndryshimin klimatik 2017-2026 Strategjia për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve të Kosovës 2013-2020
Gjeomorfologjia Peizazhi	Ruajtja e vlerave lokale dhe karakteristikave të peizazhit Përmirësimi i peizazhit Mundësimi i menaxhimit dhe planifikimit të peizazhit	Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022
Ujërat	Përmirësimi dhe ruajtja e kushteve të mira të trupave të ujërave sipërfaqësorë nga perspektiva kimike dhe mjedisore dhe kushteve të mira të ujit nëntokësr nga perspektiva kimike	Direktiva kornizë e BE-së për ujin 2000/60/EC-WFD Strategjia kombetare e ujit 2017-2022
Toka dhe bujqësia	Reduktimi i lirimit të substancave të dëmshme dhe grimcave në tokë Brojtja e tokës së cilësisë së mirë Mbrojtja dhe sigurimi i zonës së lirë për përdorim të bagëtive Mbrotja e tokës nga erozioni	Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi themelimin e kornizës për mbrojtjen e tokës dhe Direktiva plotësuese 2004/35/EC Strategjia për konsolidimin e tokës 2010-2020 Plani kombëtar për zhvillimin bujqësor dhe rural 2010-2013 Strategjia kosovare për mundësitë në bujqësi
Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura	Reduktimi i presionit direkt mbi pyjet dhe habitatet e ujërave të freskëta dhe barishtet e thata, dhe sigurimi i pikave të nxehta për diversitet biologjik Parandalimi i përhapjes së specieve invazive	Direktiva e BE-së për zogjtë 79/409/EEC Direktiva e BE-së për habitatet 92/43/EEC Konventa e Bernës Strategjia kombëtare e Kosovës për mjedisin dhe plani kombëar i veprimit për mjedisin (2014) Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020
Pyjet dhe pylltaria	Kontributi për menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e	UNCED (konferenca e KB mbi mjedisin dhe zhvillimin), 1992., Deklarata e parimeve të pyllit Strategjia e BE për pyllin (2013)

	qëndrueshëm të pyjeve dhe pylltarisë	Konferenca e Ministrave për mbrojtjen e pyjeve në Evropë, Helsinki 1993 (Rezoluta H1 - "Parimet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Europë ", Rezoluta H2 - "udhëzimet e përgjithshme për ruajtjen e biodiversitetit në pyjet evropiane ", Rezoluta H4 - "adaptimi i pyjeve të evropës ndaj ndryshimit klimatik ") Strategjia për zhvillimin e pyjeve 2010-2020
Trashëgimia kulturore	Mbrojtja e trshëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore	Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore botërore Programi për zhvillimin e kulturës 2106-2020 (Propozimi, Mars 2016) Strategjia kombëtare e Kosovës për trashëgimi kulturore 2017-2027
Shëndeti i njeriut	Reduktimi i ekspozimit të popullsisë ndaj sëmundjeve ngjitëse dhe të frymëmarrjes	Politika e re europiane për shëdetin Health-2020 Strategjia e sektorit të shëndetësisë 2017-2021
Popullsia dhe vendbnimet	Rritja e mundësive për punësimin e popullsisë lokale Mbrojtja e zonave të rëndësishme turistike	Strategjia e BE për zhvillim të qëndrueshëm, 2006 Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (NDS) 2020

6.2 - Analiza e pajtueshmërisë së zbatimit të ZHG me objektivat për mbrojtjen e mjedisit

Kjo analizë ofron një vlerësim ë përgjithshëm të ndikimeve të mundshme të implementimit të ZHG në arritjen e objektivave relevante për mbrojtjen e mjedisit.

Çështja mjedisore	Objektiva e mbrojtjes së mjedisit	Koment
Ajri dhe ngarkesa ekzistuese e emisioneve	Përmirësimi i cilësisë së ajrit me anë të reduktimit të lirimit të substancave ndotëse (SO_2, NOx, PM, CO_2, HCl, HF) nga fabrikat industriale/energjetike me anë të transicionit të karburanteve me përbërje të ulët karboni, p.sh. gazi natyral.	Implementimi i ZHG mund të arrijë realizimin e kësaj objektive për mbrojtjen e mjedisit nëse gazifikimi zgjatet po ashtu deri tek fabrikat industriale. Gazifikimi i planifikuar mund të shpiejë deri tek përmirësimi i cilësisë së ajrit në zonat urbane.
Klima dhe ndryshimi klimatik	Parandalimi i transmisionit ndërkufitar të ndotjes së ajrit mbrojtja e strukturave dhe bimëve nga përmbytja dhe të reshurat ekstreme	Lista kombëtare e indikatorëve NK02 të reshurat vjetore (indikatori shtetëror) NK03 përdorimi i substancave që dëmtojnë mbështjellësin e ozonit (indikatori i presionit) NK04 trendi i lirimit të gazrave serë (indikatori i presionit) NK05 Projektimet e lirimeve te gazrave sere (indikatori i presionit)
Gjeomorfologjia Peizazhi	Ruajtja e vlerave lokale dhe karakteristikave të peizazhit Përmirësimi i peizazhit Mundësimi i menaxhimit dhe planifikimit të peizazhit	Ndikimi në natyrë lidhet me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e gazsjellësit, duke shkaktuar degradime të strukturës fizike të peizazhit dhe më të dukshmet janë në pyje në formë të spastrimit pyjor. Ndërtimi po ashtu shkakton ndryshim të morfologjisë së terrenit natyror dhe më i dukshëm është në rastin e kalimit mbi rrjedhat ujore dhe në pjesët e pjerrëta të terrenit malor. Prandaj është e domosdoshme të shmangen zonat natyrore me vlerë të posaçme dhe peizazhet e çmueshme, e po ashtu kalimi përtej kanioneve të organizohet në një mënyrë që nuk është i dëmshëm për shpatet e kanionit apo rrjedhat apo pellgjet ujore.

Ujrat	Përmirësimi dhe ruajtja e kushteve të mira të trupave të ujërave sipërfaqësorë nga perspektiva kimike dhe mjedisore dhe kushteve të mira të ujit nëntokësr nga perspektiva kimike	Ndërtimi dhe përdorimi i rrjetit të gazsjellësit pritet të mos ketë ndikim në gjendjen e mjedisit ujor për shkak të faktit se gazsjellësi si një objekt infrastrukturor nuk shkakton emisione të mbeturinave. Një ndikim të mundshëm negativ gjatë ndërtimit të gazsjellësit kur kalohen rrjedhat ujore, mund të ketë vetëm karakter lokal dhe të përkohshëm dhe nuk do të ketë ndikim negativ në gjendjen e ujit, prandaj ZHG konsiderohet që nuk është në kundërshtim me objektivat për mbrojtjen e ujrave. Është e domosdoshme të kalohet përreth zonës I të mbrojtjes sanitare të burimeve të ujrave të pijshëm gjatë procesit të projektimit detajuar të gazsjellësit, për të gjitha aktivitetet brenda kësaj zone përveç aktivitetit për marrjen e ujit, trajtimit të ujit dhe transportit në sistemin e furnizimit me ujë. Përveç kësaj, është e domosdoshme të shmanget brezi i mbrojtjes sanitare 2 m nga boshti kryesor i tubacionit të furnizimit me ujë për deri 200 banorë. Brenda këtj brezi të mbrojtjes nuk lejohet ndërtimi i strukturave, instalimi i pajisjeve dhe aktivitetet që potencialisht mund të ndotin ujin në çfarëdo mënyre apo të rrezikojnë stabilitetin e tubacionit të furnizimit me ujë. Nuk ka kufizime lidhur me ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësit brenda zonave të mbrojtjes sanitare II dhe III.
Toka dhe bujqësia	Reduktimi i lirimit të substancave të dëmshme dhe grimcave në tokë Brojtja e tokës së cilësisë së mirë Mbrojtja dhe sigurimi i zonës së lirë për përdorim të bagëtive Mbrotja e tokës nga erozioni	Implementimi i ZHG nuk do të shkaktojë lirim të substancave të dëmshme dhe grimcave në tokë, as që do të uzurpojë zona për përdorimin e lirë të kafshëve. Nuk pritet ndikim negativ në implementimin e objektivave mjedisore për faktin se linjat e gazsjellësit nuk janë planifikuar të zënë sasi të madhe të tokës bujqësore. Varësisht nga terreni i linjave të planifikuara, është i mundshëm erozioni i dheut.
Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura	Reduktimi i presionit direkt mbi pyjet dhe habitatet e ujërave të freskëta dhe barishtet e thata, dhe sigurimi i pikave të nxehta për diversitet biologjik Parandalimi i përhapjes së specieve invazive	Implementimi i ZHG mund të krijojë preion lokal në habitatin e pyllit për shkak të nevojës për të siguruar punën dhe zonat e mbrojtura. Përveç kësaj, është i mundshëm presioni lokal në habitatet e ujrave të freskëta varësisht nga metodat e zgjedhura të kalimit të rrjedhave ujore. Nuk pritet ndikim i rëndësishëm në habitatet karstike, përveç në rast se linja e planifikuar gjendet në afërsi direkte me strukturat speleologjike. Mund të ketë shpërndarje të specieve invazive në veçanti në pjesët e linjës që kalon mes habitateve pyjore për shkak të punëve në mirëmbajtjen e korridorit mbrojtës.
Pyjet dhe pylltaria	Kontributi për menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe pylltarisë	Ndërtimi i gazsjellësit, apo të disa nga linjat e gazsjellësit, në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të pyjeve dhe të pylltarisë në Kosovë. Për më tepër, përdorimi i gazit si alternativë e lëndëve djegëse fosile likuide dhe solide që mund të përmbajnë nivele të larta të sulfurit dhe të lirojnë shumë lëndë pluhuri, sigurisht që do të shkaktojë reduktimin e ndotjes së atmosferës dhe do të inkurajojë menaxhim të qëndrueshëm të resurseve pyjore që ndikojnë në përdorimin e shtuar të biomasës si burim energjie me neutralitet karboni. Zona pyjore qe do të ketë nevojë për ndryshim të përdorimit të përhershëm për ndërtimin e gazsjellësit (një zonë prej 5 m nga secila anë e boshtit të gazsjellësit) në këtë rast mund të konsiderohet e parëndësishme, për shkak se këto janë pyje cungishe pa ndonjë vlerë të madhe ekonomike.

Trashëgimia kulturore	Mbrojtja e trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore	Megjithëse nuk priten ndikime veçanërisht të rëndësishme të gazsjellësit në trashëgiminë arkeologjike dhe arkitekturore, ekzistojnë disa zona konflikti. Ky ndikim kryesisht pasqyrohet në shkatërrimin potencial të vendeve të zbuluara dhe të pazbuluara arkeologjike dhe shkatërrimin e konekstit kulturor, derisa shkatërrimi direkt i trashëgimisë arkitektonike përjashtohet për shkak të obligimit për të qenë në pajtueshmëri me rregullativën.
Shëndeti i njeriut	Reduktimi i ekspozimit të popullsisë ndaj sëmundjeve ngjitëse dhe të frymëmarrjes	Ndërtimi dhe përdorimi i gazsjellësit nuk do të ketë potencial për të shkaktuar rritjen e sëmundjeve të transferueshme dhe prandaj nuk do të shkaktojë dëmtim të shëndetit.
Popullsia dhe vendbanimet	Rritja e mundësive për punësimin e popullsisë lokale Mbrojtja e zonave të rëndësishme turistike	Megjithëse nuk pritet ndikim i rëndësishëm në popullsi (veçnërisht gjatë periudhës së përdorimit dhe operimit të gazsjellësit), mund të pritet ndikim te popullata në rastin e kalimit të linjave përmes apo në afërsi të zonave të populluara për shkak se do të zërë tokën përreth. Ky ndikim manifestohet në okupimin e zonës së ndërtimit në gjerësi të zonës së sigurisë së gazsjellësit (rreth 60 m) brenda së cilës nuk do të jetë i mundur asnjë ndërtim i mëvonshëm. Në rast të planifikimit të linjës në atë mënyrë që linjat kalojnë në afërsi direkte të strukturave tashmë të ndërtuara, duke shkaktuar kështu dëmtim të tokës dhe pronës së paluajtshme, prandaj për pronarët e paluajtshmërive është e mundur ulja e vlerës së pronës. Në këto raste do të merrën masa të veçanta për mbrojtjen e njerëzve dhe pronës, me qëllim të sigurimit të stabilitetit të gazsjellësit dhe shmangies së aksidenteve. VSNM ka vlerësuar dhe analizuar nëse zonat e populluara gjenden brenda linjës së gazsjellësit me qëllim të identifikimit të zonave të konfliktit. ZHG nuk konsiderohet të jetë në kundërshtim me ndonjë nga objekivat sociale dhe të mbrojtjes së popullatës.

7 - NDIKIMET E MUNDSHME MBI MJEDISIN DHE SHËNDETIN E NJERIUT

Bazuar në përshkrimin e karakteristikave kryesore të ZHG, është konkluduar që ndikime kryesore mund të priten nga ndërtimi i rrjetit të gazsjellësit, dhe në pajtim me këtë, Raporti VSM fokusohet në analizimin e ndikimeve të mundshme në pjesë të caktuara të ambientit brenda korridoreve të propozuara të transportit të gazsjellësit.

Ndërtimi i sistemit të shpërndarjes së gazsjellësit nuk është analizuar në detaje nga VSM, pasi që ai është më së shumti i vendosur nën rrugët publike, paralelisht me elementet tjera të infrastrukturës komunale, duke i respektuar rregullat dhe standarded e distancës nga ndërtesat, objektet tjera mbikotësore dhe pajisjet e tjera nëntokësore paralele me to.

Tabela në vijim paraqet metodologjinë e vlerësimit të ndikimit në secilin komponent të mjedisit.

Çështja	Metodologjia e vlerësimit të ndikimit
Ajri dhe ngarkesa emisioneve ekzistuese	Ndikimi i projektit në cilësinë e ajrit vlerësohet duke përcaktuar emisionet e ndotesve të ajrit gjatë ndërtimit dhe operimit normal të projektit. Burimet e njohura të emisioneve gjatë ndërtimit janë punët ndërtimore dhe makineria e rëndë e nevojshme për ndërtim. Gjatë operimit normal, disa emisione priten nga dhomat e bojlerëve në objektet mbitokësore.
Klima dhe ndryshimi klimatik	Ndikimet e ndryshimit klimatik në projekt vlerësohen në përputhje me *Udhërrëfyesin Teknik mbi mbrojtjen klimatike të infrastrukturës në periudhën 2021-2027* të Komisionit Europian. Udhërrëfyesi bazohet në sensitivitetin, ekspozimin dhe ndjeshmërinë e projektit. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në projekt vlerësohen duke kalkuluar emisionet e gazrave serë dhe reduktimit potencial të emisioneve për shkak të përdorimit të lëndëve tjera djegëse fosile dhe biomasës.
Gjeomorfologjia Peizazhi	Zona e studimit ndikohet nga rreziqet gjeologjike si shkarjet aktive tektonike, rrëshqitjet potenciale të dheut dhe përmbytjet. Me qëllim të vlerësimit se si aktivitetet e ndërtimit mund të rritin efektin e gjeorreziqeve (rrëshqitjet, erozioi) në zonën e projektit, apo si gjeorreziqet mund të ndikojnë në projekt (shkarjet aktive, lëngëzimi, termetet), janë identifikuar zona potencialisht të rrezikshme sipas llojit dhe linjave të projektit. Për secilin rrezik janë përshkruar efektet e mundshme.
Ujërat	Ndikimi kryesor negativ mbi ujërat shkaktohet nga ndërtimi i gazsjellësit. Gazsjellësit dhe kalimet mbi trupat ujore përcaktohen dhe vlerësohen me anë të përdorimit të sistemeve gjeoinformatike. Ndikimi i ndërtimit të gazsjellësit do të përcaktohet në bazë të gjatësisë së kryqëzimeve dhe intensitetit të punëve tokësore. Zonat e ndjeshme që mund të ndikohen nga ndërtimi i projektit janë rrjedhat e ujërave dhe ujrat nëntokësore. Gazsjellësi kalon kryesisht mbi rrjedha ujore relativisht të vogla dhe të mesme të cilat kryesisht janë me ndërprerje sa i përket sezonës dhe shkarkimit të ujit. Ndikimi potencial në ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore potencialisht mund të ngritet nga aktivitetet e ndryshme të ndërtimit që mund të shkaktojnë ndotje ose rënie të ujit. Vlerësimi i ndikimeve të projektit në burimet ujore është bazuar në karakteristikat lokale të rrjedhave ujore (p.sh. lloji, sezonaliteti) dhe në karakteristikat hidrogjeologjike të akuiferëve mbi të cilët kalon gazsjellësi. Aktivitetet e ndërtimit që mund të kenë efekt negativ në ujëra dhe kalime mbi lumenj janë (metoda hap-prej) dhe hidrotestimi (rënia e ujit në sezon të thatë dhe shkarkimi). Akuiferët përgjatë gazsjellësit po ashtu mund të ndikohen në situata aksidentale (derdhjet dhe rrjedhjet e naftës, vajit, lubrifikantëve etj.) nëse shtresa e sipërme e tokës është shumë e hollë.
Dheu dhe bujqësia	Vlerësimi i ndikimit të projektit në tokë bazohet në analizimin e të dhënave ekzistuese (harta digjitale e llojit të tokës në Kosovë), derisa analiza e ndikimit në tokën bujqësore bazohet në analizën e tokës ekzistuese (CORINE). Si bazë për përcaktimin e llojeve më të zakonshme të tokës përreth linjave dhe korridoreve të tyre, janë përdorur të dhëna të marra nga teknologjia GIS e linjave të mbivendosura të gazsjellësit me të dhënat e vektorëve të llojeve të tokës në Kosovë. Vlerësimi i ndikimeve në bujqësi konsiderohet shkalla deri ku ato kalojnë nëpër tokat bujqësore dhe kullosa, dhe nëse ka ndikime të mundshme në prodhimin e tanishëm apo të planifikuar bujqësor. Nga aspekti i analizës së dheut, janë ekzaminuar llojet bazike përreth gazsjellësit, si dhe ndotja e tyre e mundshme gjatë ndërtimit dhe operimit të linjave të planifikuara. Një vëmendje e veçantë gjatë vlerësimit u është kushtuar plantacioneve permanente (pemisheve dhe vreshtave).

Çështja	Metodologjia e vlerësimit të ndikimit
Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura	VSM ka analizuar nëse korridoret dukshëm kalojnë përmes zonave të habitateve sensitive dhe qendrave të biodiversitetit me qëllim të identifikimit të zonave të konfliktit. Të dhënat GIS të zonave të mbrojtura – parqet nacionale, parqet rajonale dhe është përdorur sistemi informativ natyror evropian. Po ashtu, janë rishikuar planet lokale të veprimit për biodiversitetin, si dhe dokumente të tjera, kur kanë qenë në dispozicion, me qëllim të identifikimit të pikave të nxehta apo disa zona të tjera të konsideruara të rëndësishme në nivel më të ulët. Vlerësimi i ndikimit në pyje është bërë duke analizuar hartën ekzistuese të mbulueshmërisë pyjore (CORINE), matjen globale të lartësisë së drurit "*tree canopy height*" (glad.umd.edu), dhe më të rëndësishmen imazhet satelitore multispektrale Sentinel-2. Territori i Kosovës mbulohet me katër pamje satelitore Sentinel-2 të cilët janë bashkuar dhe pastaj janë analizuar me nënshkrimin spektral, i cili ka rezultuar në një gjeneratë të ashtuquajtur NDVI, indeksi i diferencës së normalizuar të vegjetacionit. Me fjalë të thjesha, NDVI tregon sasinë e vegjetacionit, d.m.th. biomasën e bimëve në disa zona dhe përdoret gjerësisht për hartimin e zonave pyjore. Një burim tjetër i të dhënave ishte modeli digjital i terrenit (DTM) i marrë nga uebfaqja Copernicus (https://land.copernicus.eu/imagery-in-situ/eu-dem/eu-dem-v1.1). Këto të dhëna janë përdorur për të definuar zonat sensitive ndaj erozionit (zonat me pjerrtësi më të madhe se 15°), derisa pamje nga Sentinel-2 janë përdorur për të përcaktuar llojin e pyllit (shkurre, cungishte, pyje ta larta). Bazuar në këto të dhëna, është përgatitur një hartë me zona sensitive, dhe janë vlerësuar ndikime në zonën e projektit, dhe janë përshkruar masat lehtësuese kontigjente. Përveç kësaj, do të përdoren edhe harta e e habitatit EUNIS dhe harta CORINE e sipërfaqes së tokës si të dhëna plotësuese për përcaktimin e llojeve të pyllit. Këto informata do të përdoren si indikative për shkak të rezolucionit të ulët, derisa të dhënat nga Sentinel-2 me rezolucion prej 20 metrash do të përdoren për përcaktim më preciz të mbulesës pyjore përgjatë linjës.
Peizazhi	Zonat e vlevshme natyrore në Kosovë janë përcaktuar duke përdorur hartën topografike dhe ortofotografikie, si dhe me anë të analizave të zonave natyrore të mbrojtura dhe formave të çmueshme gjeomorfologjike që po ashtu përmbajnë vlera të larta natyrore. Ndikimet në peizazh definohen si: ■ Ndikime direkte fizike në elementet e peizazhit, ■ Ndikimet vizuele dhe ndryshimi i karakterit të peizazhit, Ortofotot dhe hartat topografike janë përdorur për të vlerësuar ndikimin në peizazh. Linjat dhe korridoret e tyre 200 + 200 m janë mbivendosur, ashtu që është analizuar nëse ka zona të konfliktit ku mund të ketë ndikime të mëdha negative në zona më të çmueshme.
Trashëgimia kulturore	Ndikimi potencial në trashëgiminë kulturore dhe historike merret parasysh nga aspekti i ndikimeve potenciale negative në formë të shkatërrimit të mundshëm fizik apo dëmtimit të kontekstit kulturor. Zona e ndikimit negativ potencial direkt fizik definohet si zonë me distancë të shtar të vendeve të trashëgimisë së vlefshme kulturore. Si burim i të dhënave shërben e gjithë literatura profesionale dhe një sërë hartash të shkallës së gjerë. Gjatë fazës së ndërtimit ndikimi fizik është i mundur gjatë operimit të makinërisë dhe nxjerrjes së dheut. Ndikimet indirekte janë të mundshme përmes perceptimit negativ të afërsisë së një objekti të trashëgimisë kulurore me elemenet e gazsjellësit. Objektet e lidhura me gazsjellësin e planifikuar kanë karakter teknogjenik dhe prandaj kanë karakteristika që mund të jenë në kundërshtim me elementet e trashëgimisë kulturore dhe kontekstit kulturor.
Shëndeti i njeriut	Çështjet e shëndetit (cilësia e ajrit, vlereësimi i cilësisë së ujit të pijshëm, sëmundjet infektive dhe venerike etj.) janë përshkruar duke përdorur dokumentacionin (studimet relevante, raportet, planet, strategjitë, artikujt etj.). VSM vlerëson rrezikun potencial për shendetin e njeriut në një nivel të përgjithshëm si të tërë. Ndikimet e mundshme në shëndetin e komunitetit gjatë fazës operacionale mund të ndodhin në rast të rrjedhjeve të gazsjellësit apo situatave aksidentale. Siguria dhe shëndeti publik gjatë operimit është marrë parasysh gjatë projektimit të objekteve dhe është bërë vlerësimi i riskut. Përdorimi i gazsjellësit nuk do të ketë potencialin për incidencë të shtuar të sëmundjeve ngjitëse, prandaj nuk shkakton përkeqësim të shëndetit. Projekti në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë në qasjen në kujdesin shëndetësor.
Popullsia dhe vendbanimet	Vlerësimi i ndikimeve në popullsi dhe vendbanime në Republikën e Kosovës është vlerësuar duke përdorur të dhëna hapësinore të linjave të gazsjellësve të planifikuara për indikatorët demografikë të ofruar nga Agjencia Kosovare e Statistikave, OECD, Banka Botërore dhe raporte tjera publike duke përfshirë të dhënat e Regjistrimit të përgjithshëm, të dhënat vjetore statistikore si dhe burime tjera

Çështja	Metodologjia e vlerësimit të ndikimit
	të shkruara për të identifikuar zona të mundshme të konfliktit përgjatë korridorit të gazsjellësit ku gjenden zonat e banuara. Vlerësimi ka marrë parasysh udhërrëfyesin nga dokumenti *"EBRD's Environmental and Social Policy* 2019", për të mbështetur procedurat e VNM në një fazë të mëvonshme të projektit. Të dhënat për nivelet e zhurmës janë përshkruar duke marrë parasysh legjislacionin (standardet e zhurmës), hartat dhe dokumentacioni tjetër (studimet relevante, raportet, planet etj.) Ndikimi i zhurmës dhe vibrimit nuk është adresuar nga VSM, siç mund të pritet gjatë fazës së ndërtimit nëse punët kryhen në afërsi të zonave të populluara. Gjatë fazës së operimit, ndikimet mund të priten në objektet mbitokësore. Ndikimet, veçanërisht në këtë nivel të përpunimit, konsiderohen të parëndësishme.
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë	Për qëllim të vlerësimit, ndikimet janë definuar sipas aktivitetit të performuar për qëllim të ndërtimit të gazsjellësit: ▸ Ndikimi për shkak të formimit të brezit të ndërtimit ▸ Ndikimi për shkak të ndërtimit të objekteve mbitokësore Për qëllim të vlerësimit të ndikimeve, ndikimet janë definuar sipas aktivitetit të performuar për qëllim të operimit të gazsjellësit: ▸ Zona e sigurisë së gazsjellësit - 5 metra në secilën anë të aksit të gazsjellësit (zona e sigurisë apo e drejta e kalimit) nuk mund të mbillen bimë me rrënjë të thella. ▸ Zona e sigurisë - 30 m nga secila anë e aksit të gazsjellësit nuk mund të ndërtohen shtëpi individuale apo ndërtesa. ▸ Ndikimi për shkak të objekteve mbitokësore – ndikim permanent
Zhurma	Të dhënat mbi nivelin e zhurmës janë përshkruar duke përdorur legjislacionin (standardet e zhurmës), hartat dhe dokumentacionin tjetër (studime, raporte, plane etj.) Ndikimi i zhurmës dhe vibrimit nuk është adresuar nga VSM, siç mund të pritet gjatë fazës së ndërtimit nëse punët kryhen në afërsi të zonës së populluar. Gjatë fazës së operimit, ndikime mund të priten në objektet mbitokësore. Ndikimet, veçanërisht në këtë nivel të përpunimit, konsiderohen të parëndësishme.
Infrastruktura dhe shërbimet publike	Elementet e sistemit të infrastrukturës (transporti, electriciteti, etj.) është përshkruar duke përdorur hartat dhe dokumentet tjera (studime, raporte, plane, politika, strategji, artikuj etj.). VSM analizon në një nivel më të përgjithshëm ndikimet potenciale të trafikut në rritje. Nuk planifikohet kohë e ndërtimit në këtë fazë.
Aksidentet	VSM ka ofruar vetëm një përshkrim të përgjithshëm të ndikimeve potenciale të situatave të aksidenteve. VSM do të analizojë në nivel të përgjithshëm ndikimet potenciale të ndodhjes së aksidenteve për të dalluar zonat e konfliktit ku këto ndodhi mund të shkaktojnë ndikime të dukshme në jetën dhe shëndetin e njeriut dhe në mjedis.
Mbeturinat	Në raportin VSM është kryer rishikimi i kornizës ligjore të menaxhimit të mbeturinave dhe po ashtu është bërë vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese për trajtimin/riciklimin e mbeturinave.

Zona e ndikimit potencial është zona në të cilën mund të ndodhin ndikimet direkte apo indirekte, fizike, biologjike, sociale apo kulturore, apo mjedisore. Në këtë kuptim edhe është definuar zona e ndikimit varësisht nga komponenta në fjalë.

Për qëllime të VSM, zona e ndikimit potencial nga gazsjellësi është përcaktuar si një korridor 400 m përgjatë aksit të gazsjellësit të propozuar (200 m i gjerë në secilën anë të linjës së gazsjellësit) dhe 400 m nga kufiri i objekteve mbitokësore të propozuara.

Gjatë vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme është përdorur klasifikimi në vijim.

TABELA 43 – VLERËSIMI I PËRDORUR NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT

Vlerësimi	Rëndësia	Përshkrimi
+2	Ndikim pozitiv i rëndësishëm	Pritet kontribut i rëndësishëm për arritjen e objektivës së mbrojtjes mjedisore. Synohen masa për rritjen e ndikimit të pritur.
+1	Ndikim pozitiv i moderuar	Pritet kontribut i moderuar në objektivën e mbrojtjes së ambientit. Synohen masa për për rritjen e ndikimit të pritur.
0	Ndikim i parëndësishëm	Pritet kontribut i parëndësishëm deri te i ulët për arritjen e objektivave të mbrojtjes mbjedisore. Implementimi i ZHG nuk do të ketë ndikim në arritjen e objektivës për mbrojtje e mjedisit. Synohen masa për lehtësimin e ndikimeve negative apo rritje e atyre pozitive.
-1	Ndikim negativ i moderuar	Priten vështirësi të moderuara në arritjen e objektivës së mbrojtjes mjedisore. Synohen masa për lehtësimin e ndikimeve të pritura.
-2	Ndikim negativ i rëndësishëm	Priten vështirësi të rëndësishme në arritjen e objektivës së mbrojtjes mjedisore. Implementimi i planit mund të parandalojë arritjen e objektivës së mbrojtjes së mjedisit. Masat mjedisore janë të domosdoshme për të bërë programin më të pranueshëm.

Për të vlerësuar ndikimin e ZHG në mjedis, në vijim jepet një përshkrim i përgjithshëm i ndikimit në tërë rrjetin e gazsjellësit në Kosovë në komponentat individuale të mjedisit.

Tabelat që përmbajnë elementet e mëposhtme janë përdorur për të vlerësuar ndikimin mjedisor për secilin gazsjellës:

- Shtylla e parë rendit çështjet mjedisore,
- Shtylla e dytë përshkruan ndikimin e secilit gazsjellës për çështje mjedisore,
- Në shtyllën e tretë ndikimi është verësuar duke përdorur klasifikimin e paraqitur në TabELA 434. Nëe ndikimi potencial vlerësohet si pozitiv dhe negativ në të njëjtën kohë, paraqiten të dyja klasifikimet.

7.1 - Përmbledhje e përgjithshme e ndikimeve të pritshme

7.1.1 - Cilësia e ajrit

Ndikimi i pritur i ZHG në cilësinë e ajrit mund të ndahet në dy pjesë, ndikimet gjatë ndërtimit të gazsjellësve dhe objekteve mbitokësore dhe ndikimet gjatë operimit normal të gazsjellësit. Për procesin e ndërtimit nevojiten buldozerë, rolerë, kamionë, dhe makineri tjetër. Pjesa më e madhë e kësaj makinerie përdor naftën dizel si burim primar të energjisë kryesisht për shkak të largësisë së lokacionit të ndërtimit, densitetit të naftës dhe gjasave më të vogla të djegies aksidentale krahasuar me karburantet tjera. Djegia e naftës prodhon kryesisht gazra të oksidit të azotit, monoksid të karbonit dhe grimca të materieve. Këto emisione janë të pashmangshme mirëpo për shkak se punët e ndërtimit do të lëvizin sipas përfundimit të sektorëve, ndikimi total në ndërtim pritet të jetë i parëndësishëm.

Gjatë operimit normal, priten disa emisione nga dhomat e boilerëve në objektet mbitokësore. Këta boilerë me shumë gjasë do të përdorin gazin natyror si burim energjie, i cili ka emisionet më të ulëta nga të gjitha lëndët djegëse fosile. Emisionet nga objektet mbitokësore monitorohen në pajtim me rregullativën relevante e cila siguron që nuk do të ketë tejkalim të vlerave të kufizuara. Nëse vlerat e kufizuara tejkalohen, duhet të implementohen masa për reduktimin e emisioneve.

Gjatë operimit normal, priten disas gazra devijues nga gazsjellësi dhe objektet mbitokësore. Emisionet devijuese më së shumti janë lirime metani me pjesë të vogla të gazrave tjerë. Nuk ka rregullore për nivelet e lirimit të metanit dhe të koncentrimit të tij në ajër, për mbrojtje të ajrit. Po ashtu, këto lirime pritet të jenë relativisht të vogla, dhe ndikimi i tyre vlerësohet si i parëndësishëm për cilësinë e ajrit.

Pritet ndikim pozitiv indirekt i projektit në cilësinë lokale të ajrit nga përdorimi i gazit natyror në vend të lëndëve tjera djegëse fosile dhe biomasës. Djegia e lëndëve djegëse fosile dhe biomasës, kryesisht të përdorura për ngrohje, prodhojnë ndotje të rëndësishme të ajrit. Gazi natyror ka dukshëm më pak emisione të ndotësve të ajrit, veçanërisht të lëndës së grimcave.

Pasi që ndikimi në nivelin e VSM nuk dallon nga gazsjellësit, ndikimi potencial nuk paraqitet më tutje për linjat specifike të gazsjellësit.

7.1.2 - Klima dhe ndryshimi klimatik

Ndikimet klimatike vlerësohen në dy mënyra, ndikimet e ndryshimit klimatik në projekt dhe ndikimet e projektit në ndryshimin klimatik. **Ndikimi i ndryshimit klimatik në projekt** vlerësohet në pajtim me *Udhërrëfyesin Teknik mbi mbrojtjen klimatike të infrastrukturës në periudhën 2021-2027* të Komisionit Europian. Ndikimi i ndryshimit klimatik bazohet në sensitivitetin, ekspozimin dhe ndjeshmërinë e projektit. Gazsjellësi është i groposur në tokë, prandaj ndjeshmëria e gazsjellësit është e parëndësishme në efektet e klimës. Objektet mbitokësore më shumë janë të ekspozuara ndaj ndryshimit klimatik dhe kushteve ekstreme të motit si përmbytjet, stuhitë e furishme, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut të cilat mund të shkaktojnë dëmtime të objekteve. Kosova ka një klimë të moderuar me ekspozim relativisht të ulët ndaj këtyre ngjarjeve ekstreme. As parashikimet e ndryshimeve klimatike nuk parashikojnë rritje të rëndësishme ngarjeve të motit ekstrem që mund ta rrisnin ekspozimin e objekteve mbitokësore ndaj efekteve të ndryshimit klimatik. Gjatë ndërtimit, moti ekstrem mund të shkaktojë disa vonesa dhe dëmtime të ndërtimeve të ndjeshme ndaj motit, mirëpo këto efekte pritet të zgjasin shkurt dhe ndërtimi pritet të vazhdojë sipas planit. Një analizë më e detajuar e ndryshimit klimatik për secilin seksion të gazsjellësit duhet të bëhet si pjesë e VNM. Ndjeshmëria totale e ZHG në ndryshimin klimatik mund të vlerësohet si e vogël dhe rreziqet e efekteve të ndryshimit klimatik si të pranueshme.

Ndikimet direkte të projektit në ndryshimin klimatik obzervohen përmes emisioneve të gazrave serrë. Emisionet mund të ndahen në emisione gjatë fazës së ndërtimit dhe emisione gjatë operimit normal. Emisionet e fazës së ndërtimit priten të jenë të parëndësishme por duhet të llogariten për secilin seksion të gazsjellësit gjatë fazës VNM. Për operimin normal të gazsjellësit nevojiten boilerë dhe kompresorë të cilët e shfrytëzojnë gazin natyror për energji. Disa emisione devijuese po ashtu priten nga gazsjellësi dhe objektet mbitokësore. Ky ndikim po ashtu pritet të jetë i parëndësishëm dhe duhet të vlerësohet më tutje gjatë fazës VNM.

Një ndikim i rëndësishëm indirekt pritet nga përdorimi gazit natyror në industri dhe banim. Gazi natyror ka dukshëm më pak emisione të gazrave serrë krahasuar me lëndët e tjera djegëse dhe drurin që përdoren aktualisht. Me zëvendësimin e lëndëve djegëse tradicionale me gazin natyror pritet një ulje e rëndësishme në emisionin e gazrave serrë. Një parashikim i konsumit final të energjisë me dhe pa projektin është kalkuluar në dokumentin *Gas development plan and regulatory framework review and assistance - gas demand assessment* (rishikimi dhe asistenca për planin e zhvillimit të gazit dhe kornizës ligjore – vlerësimi i kërkesës për gaz). Parashikohet që gazi natyror do të jetë burim tranzicional i energjisë për periudhën deri në vitin 2060 për të reduktuar përdorimin produkteve të naftës dhe ndikimeve të saj në ambient. Rezultatet e vlerësimit japin konsum të energjisë në katër sektorë kryesorë (Industri, banim, shërbime, dhe transport) për secilin burim karburanti deri në vitin 2060. Për të kalkuluar ndikimin indirekt të projektit në ndryshimin klimatik, këto të dhëna janë përdorur si një input për kalkulimin e karbonit. Faktorët e emisionit janë marrë nga udhërëfyesi i IPCC i vitit *2019 "Refinement to the 2006 IPCC Guidelines for National Greenhouse Gas Inventories"*.

TABELA 44 – REDUKTIMI TOTAL I EMISIONEVE TË GAZRAVE SERRË * [KT] NGA ZHG PËR VITET E PËRZGJEDHURA

Sektori	2019	2025	2030	2035	2040	2045	2050	2055	2060
Industri	0.0	0.0	-290.3	-428.3	-536.3	-615.2	-641.7	-563.9	-359.6
Banim	0.0	19.2	-29.6	-134.2	-191.1	-208.4	-183.6	-133.9	-77.1
Shërbime	192.8	184.4	155.3	146.9	149.2	133.9	123.8	-480.1	-474.0
Transport	0.0	-4.9	2.2	7.1	10.6	19.4	-64.8	-262.3	-685.8
Total	192.8	198.7	-162.3	-408.5	-567.6	-670.2	-766.3	-1,440.1	-1,596.5

*Vlerat pozitive paraqesin rritjen e emisioneve tw GHG *dhe vlerat negative zbritjen*

Përdorimi i gazit natyror parashihet të arrijë pikën kulmore në vitin 2045 dhe ngadalë të ulet deri në vitin 2060. Për shkak të rritjes në përdorimin e gazit natyror në skenarin me projektin, ka rritje edhe në emisionet e gazrave serrë. Me uljen e përdorimit të gazit natyror, emisionet për të dyja skenarët ulen, me ulje më të dukshme me projektin.

7.1.3 - Gjeomorfologjia

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së ndërtimit mund të definohen si ndryshime fizike me karakteristika gjeomorfologjike. Gërryerja dhe hapja e kanaleve në shpate të pjerrëta rrisin potencialin për rrëshqitje, rrëshqitje dheu dhe erozion.

Lokacionet e zonave të mbrojtura me vlera të evidentuara gjeomorfologjike (shpellat, kanionet...) në zonat më të gjera të gazsjellësve të planifikuar janë jashtë distancës kritike nga intervenimi i planifikuar.

Ndikimi potencial në gjeomorfologji bëhet gjatë hapjes së kanaleve të gazsjellësit dhe ndërtimit dhe rindërtimit të rrugëve për qasje.

Është i mundur një ndikim i lehtë në ndryshimin e shpateve dhe erozion në pjesën e gazsjellësve që shtrihen në shpate të pjerrëa në mënyrë të moderuar deri te moderuar e pjerrët.

Në rastin e mbivendosjes me forma mikro-relievore, është i mundur degradimi apo mbishtresimi i këtyre formave. Janë të mundura ndryshime të vogla në format gjeomorfologjike në shpate të pjerrëta në zona kodrinore dhe përmes formave mikro-relievore.

Faza e operimit nënkupton operimin e pandërprerë të të gjithë elementeve vitale të procedurës së planifikuar. Një punë e tillë përfshin intervenime të reja në formë të ndërhyrjes dhe nxjerrjes së dheut dhe gurëve. Për këtë arsye, ndikimi në karakteristikat gjeomorfologjike të relievit dhe mikrorelievit në fazen e operimit është përjashtuar.

Pasi që ndikimi konsiderohet potencialisht i papërfillshëm/i vogël, nuk janë kryer analiza të mëtejme për gazsjellësit specifikë.

7.1.4 - Gjeorreziqet

Sipas të dhënave në dispozicion, projekti i planifikuar më së shumti ndikohet nga përmbytjet. Përmbytja e zonës së ndërtimit mund të ketë efekt negativ në cilësinë e ujit si dhe mund të shkaktojë dëmë në pajisje.

Linjat e gazsjellësit të projektit kalojnë mbi linjat e vatrave aktive dhe këto mund të ndikojnë në sigurinë e projektit.

Aktivitetet e ndërtimit në përgjithësi përfshijnë formimin e një shiriti të punës, hapjen e llogoreve, ndërtimin e rrugëve për qasje, etj. të cilat mund shkaktojnë rrëshqitje të dheut apo të krijojnë jostabilitet në shpate.

7.1.5 - Ujrat

Gjatë ndërtimit, ndikim negativ në cilësinë e ujit mund të ndodhë për shkak të:

- Mungesës së sistemit sipërfaqësor të kullimit të ujit në zonat e manovrimit,
- Mungesës së një zgjidhjeje të duhur për ujrat e zeza sanitare që gjenerohen në zonën e ndërtimit,
- Trajtimit dhe ruajtjes jo të duhur të produkteve të naftës, vajrave dhe lubrifikantëve, apo ruajtjes së tyre në konteinerë të papërshtatshëm,
- Mbushjes me naftë të makinave të transportit dhe makinave tjera operuese,
- Riparimeve të domosdoshme në zonë në formë të rrjedhjes, dhe ku nuk ka procedurë të pastrimit kimik.

Këto pengesa mund të shkaktojnë ndotje të mundshme të ujit.

Gjatë ndërtimit, mund të ndodhë ndotje e papritur në rast të aksidenteve:

- Prishjes së makinerisë së ndërtimit dhe të veglave të përdurura gjatë ndërtimit,
- Zbrazja apo trajtimi i qëllimshëm apo aksidental i mbeturinave të rrezikshme kimike në kanale apo rrjedha ujore,
- Gjatë ndodhjes së rasteve të paparashikueshme në rast të përmbytjeve apo rrëkeve.

Gjatë punëve të ndërtimit në lokacionin e projektit ka mundësi për ndikime negative në ujërat sipërfaqësorë përgjatë linjës:

- Hedhja e materialeve të ndërtimit dhe materialeve tjera (dheut, mbeturinave tjera) në lumenj/kanale,
- Dëmtimi i shtratit të lumit/kanalit për shkak të punës së makinerisë së rëndë kur zbatohet metoda hap-prej (kjo metodë mund të shkaktojë ndikim të shkurtër negativ në cilësinë e ujit mbitokësor për shkak të sedimentit të varur i cili mund të shkaktojë shtëllunga sedimentale të shkallës së ulët).

Gjatë ndërtimit uji do të përdoret për:

- Të shpuar tokën (për metoda të kalimit pa kanal), pastrim, përgatitjen e betonit dhe përdorim civil,
- Hidrotestim (testim i presionit).

Zonat përgjatë linjës së gazsjellësit që konsiderohen më të ndjeshme janë ato ku akuiferi është relativisht i cekët me nivele të larta të uji nëntokësor, të mbuluara me një shtresë të hollë të depozitave poroze.

Prerja perpendikulare e gazsjellësit me lumin/përroin do të kërkojë përdorimin e metodës së shpimit. Gërmimi i kanalit për të shtrirë tubat në ujërat më të vogla bëhet mekanikisht, por para gërmimit të kanalit, nëse ka nevojë rrjedha e ujit do të devijohet në kanalin e gërmuar paralel me shtratin ekzistues të ujit. Pas shtrirjes së tubave, pengesa do të largohet dhe kanali i kullimit do të mbushet me ujë, që do të thotë se terreni do të restaurohet.

Metoda e gërmimit (hap-prej) mund të krijojë një ndikim negativ të shkurtë, të kthyeshëm në cilësinë e ujit sipërfaqësor për shkak të sedimentit të varur që mund të shkaktojë ngarkesa të sedimentit të shkallës së ulët. Me këtë metodë më së shumti do të kalohen rrjedha ujore të vogla të përhershme dhe ato të kohëpaskohshme.

Gjatë fazës së operimit, infrastruktura e gazsjellësit nuk ka ndikim në ujërat mbitokësorë apo nëntokësorë. Një objekt, i tillë si gazsjellësi operativ groposet dhe nuk ndikon negativisht në regjimin e ujit sipërfaqësor në mënyrë të pakthyeshme.

7.1.6 - Toka dhe bujqësia

Pjesa më e madhe e të 15 linjave të gazsjellësit janë pozicionuar mbi një zonë që dominohet nga bujqësia. Nga 369,5 km e gazsjellësit të planifikuar, 288 km kalojnë përmes tokës bujqësore dhe kullosave, që përbëjnë gati 78% të gjatësisë së rrugës. Gjatë fazës së ndërtimit priten ndikime negative në tokë dhe në tokën bujqësore në formë të gërmimit të dheut, trazimit të strukturës dhe kompaktësisë së dheut nga makineria e rëndë dhe heqja e shtresës së humusit dhe të bimëve të mbjella. Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit do të ndodhë në formë të heqjes së kulturave bujqësore në gjerësinë e rripit punues. Një ndikim i tillë do të jetë i përkohshëm dhe do të ndalojë pas përfundimit të fazës së ndërtimit, ashtu që nuk do të ketë ndikim të madh në prodhimin bujqësor.

Pas fazës së ndërtimit, ndikimi negativ në bujqësi dhe tokën bujqësore ka të bëjë me zonën mbrojtëse të gazsjellësit (5+5 m) nga linja e gazsjellësit ku ndalohet kultivimi i plantacioneve bujqësore me rrënjë më të thella se 1 m dhe plantacioneve që kërkojnë lëvrim të tokës më shumë se 0,5 m. Ky ndikim kryesisht lidhet me kulturat permanente (pemishtet dhe vreshtat). Bimët tjera bujqësore mund të rriten brenda zonës së mbrojtur, për çka edhe ndikimi në tokën e punueshme është i përkohshëm dhe ka të bëjë vetëm me fazën e ndërtimit.

7.1.7 - Biodiversiteti

Në zonën e projektit, tipet më të përhapura të habitatit janë I1 toka e punueshme dhe kopshtet e tregut që mbulojnë rreth 43% të sipërfaqes, E2 barishte mesike që mbulojnë rreth 28%, dhe G1 pyjë gjethegjera gjetherënëse që mbulon rreth 15.5% të sipërfaqës së projektit.

Gjatë fazës së ndërtimit të projektit, pritet që mbulesa e vegjatacionit të dëmtohet apo të largohet brenda korridorit të punës si pasojë e operimit të makinerisë së rëndë dhe punëve të gërmimit në të gjitha lokacionet. Gjerësia e korridorit të punës do të varet nga lloji i mbulesës së tokës dhe pjerrtësisë së terrenit; dhe po ashtu nga diametri i gazsjellësit.

Ndikimi në habitatet dukshëm të ndikuar antropogjenikisht (toka bujqësore, ndërtesat e densitetit të ulët, zonat afër rrugëve etj.) do të jetë i vogël pasi që këto habitate janë nën shqetësim konstant për shkak të përdorimit aktual të tokës. Këto habitate kanë kapacitet specifik që spontanisht me kalimin e kohës të rigjenerojnë vegjetacionin që ka qenë prezent më parë, për derisa gjatë periudhës së operimit prodhimi bujqësor do të mbetet i mjaftueshëm me disa kufizime sa u përket rrënjëve të bimëve. Lokacionet ku është bërë dëmtimi apo largimi i vegjetacionit do të jenë në rrezik më të madh për shpërndarjen e specieve invazive. Këto specie do të shpërndahen më shpejt gjatë punëve të ndërtimit. Po ashtu këto habitate kanë një rrezik më të lartë për paraqitjen e specieve të reja invazive.

Efekti në barishte dhe habitate pyjore do të jetë më i madh për shkak të largimit të vegjetacionit në korridorin e punës.

Largimi dhe dëmtimi i vegjetacionit pyjor pritet të ndodhë brenda korridorit. Pritet që vegjetacioni bimor të rigjenerohet në përputhje me kushtet lokale ekologjike, deri sa rikuperimi në zonën e pyllit dhe shkurreve do të jetë më i kufizuar për shkak të mirëmbajtjes së korridorit të sigurië prej 5+5 m. Zonat me vegjetacion të larguar apo të dëmtuar shumë do të jenë të cenueshme nda ndërhyrjes së specieve invazive të bimëve. Largimi i përkohshëm i vegjetacionit të pyllit brenda korridorit të punës do të rezultojë në copëtimin e habitateve të pyllit. Ky efekt më shumë do të theksohet në zonat që kanë një mbulesë mirë të zhvilluar të vegjetacionit. Pjesa më e madhe e vegjetacionit drunor brenda korridorit të punës do të rivendoset pas një kohe pas përfundimit të punëve të ndërtimit. Përbërja e tehut (afër korridorit prioritar të sigurisë prej 5+5 m) do të ndryshohet në favor të specieve drunore që preferojnë kushte me më shumë dritë (speciet shkurre).

Sa i përket ndikimit të dëmit dhe largimi të shtresës së vegjetacionit të habitateve të tokave barishtore, ndikimi do të jetë më pak i theksuar se në pyje. Po ashtu, pastrimi permanent brenda zonës prioritare të sigurisë (5+5 m) do të ketë efekte të parëndësishme pasi që pastrimet e kohëpaskohshme janë të zakonshme në këto lloje të habitateve. Shtresa e vegjetacionit barishtor do të shërohet spontanisht pas kompletimit të punëve të ndërtimit. Ndikimi i shpërndarjes së specieve invazive po ashtu mund të ndërhyjë në rikuperimin spontan të specieve. Në habitatet e karakterizuara me mbulesë të rrallë të vegjetacionit, ndikimi gjatë punëve të ndërtimit do të jetë i papërfillshëm pasi që do të paraqesë ndryshime të vogla në këto specie.

Gjatë punëve ndërtimore në habitatet ujore, pritet një shpërndarje e lokalizuar e sedimentit në ujë, i cili do të shkaktonte një flluskë të lokalizuar sedimenti (rritje e turbullirës dhe ndryshime në kushtet fizio-kimike). Kjo do të shkaktojë trazim afatshkurtë, të përkohshëm dhe të lokalizuar të faunës ujore prezente. Intensiteti i ndikimit të mundshëm gjatë kalimit të lumit varet nga metoda se si do të vendoset gazsjellësi. Çdo ndikim në habitatet ujore do të jetë i përkoshëm.

Pritet që një shtresë pluhuri të formohet në vegjetacion afër lokacioneve të ndërtimit ashtu që procesi i fotosintezës dhe evapotranspirencës do të ndërprehen përkohësisht. Mbulesa e pluhurit do të jetë e kufizuar në hapësirë, e përkohshme (varësisht nga kushtet meteorologjike) dhe prandaj nuk do të paraqesë ndikim të rëndësishëm në realizueshmërisë e bimëve.

Për shkak të operimit të automjeteve të ndërtimit, zona e punëve të ndërtimit do ë jetë përkohësisht barierë për lëvizjet rutinore të specieve he do të jetë burim i zhurmës dhe trazimit. Ndikimi gjatë ndërtimit do të jetë i përkohshëm dhe lokal duke ndikuar veëm në lforën dhe faunën prezente lokalisht. Gjatë përdorimit të

gazsjellësit, ndikimi i zhurmës dhe vibrimit në faunën lokale mund të përshkruhet si i lokalizuar dhe i intensitetit të ulët për shkak të natyrës së projektit.

Ndërtimi i gazsjellësit mund të shkaktojë copëtim minor të habitateve të cilat pastaj mund të ndikojnë në habitatet e specieve kryesore si dhia e egër "chamois" (*Rupicapra rupicapra*), dhe ujku (*Canis lupus*). Sidoqoftë, gjatë dërtimit ato do të shmangin zonën e punës. Habtatet e specieve të mbrojtura si ariu i kaftë (*Ursus arctos*) dhe rrëqebulli (*Lynx lynx balcanicus*) janë brenda zonës së mbrojtur dhe nuk janë afër gazsjellësit.

Speciet e zogjve target si shqiponjat e mbrojtura (*Aquila heliaca* dhe *Aquila chrysartos*) dhe fajkoi (*Falco naumanni*) mund ta përfshijnë zonën e gazsjellësit si pjesë të rrezes së tyre habitatit. Gjatë ndërtimit ata do të shmangin zonën e ndërtimit.

Fatalitete të individëve lokalë priten vetëm në rast të organizmave të palëvizshëm ujorë. Duke supozuar që nuk do të ketë ndërprerje të rrjedhës ujore gjatë kalimit, nuk do të ketë ndikim negativ potencial në speciet prezene të peshqve migrues, si ngjala europiane e rrezikuar *Anguilla a*nguilla) e pranishme në lumin Drini i Bardhë. Përveç këaj, dy speciet rajonalisht të rrezikuara, salamandri alpin (*Salamandra atra*) dhe salamandri triton (*Triturus alpestris*), gjenden në liqenë të ngritura, asnjëri nga të cilët nuk është në zonën e gjerë të projektit.

Gjatë punëve të gërmimit në terrenin karstik, është e mundshme që të gjenden shpella të reja pa hyrje sipërfaqësore. Po ashtu, disa shpella të reja me hyrje sipërfaqësore të panjohra më parë mund të gjenden në terrene karstike të paeksploruara. Shpellat mund të jenë të banuara nga fauna nëntokësore e cila është shpesh e rrallë dhe endemike. Prandaj duhet të merren masa për të mbrojtur shpellat. Në rast se shpella zbulohet gjatë punëve të ndërtimit, autoritetet ligjore të Kosovës duhet të kontaktohen menjëherë dhe të gjitha punën e ndërtimit duhet të ndalohen derisa autoriteti kompetent të japë lejen për të vazhduar nuk priten ndikime në shpella gjatë përdorimit të rregullt të gazsjellësit.

Gjatë punëve ndërtimore, habitatet brenda zonës së projektit do të trazohen nga makineria dhe prezenca njerëzore. Çdo habitat i trazuar paraqet rrezik më të madh për shpërndarjen e specieve invazive. Ekziston mundësia që speciet invazive të marrin kontrollin mbi habitatet respekive, prandaj duhet të merren masa lehtësuese.

Gjatë ndërtimit janë të mundshme efektet negative në rast të një ngjarjeje të papritur, (p,sh., derdhja e substancave të rrezikshme, zjarri), mirëpo do të parandalohet me anë të organizimit të duhur dhe ndërtimit të zonës së punës dhe mrëmbajtjes së pajisjeve në pajtim me rregulloret relevante. Një ndikim i ngjashëm është i mundur edhe gjatë përdorimit dhe mund të parandalohet aplikimin e masave të përshkruaa teknike dhe pajtueshmërinë me rregllativën ligjore.

Brenda zonës prioritare të sigurisë 5+5 m mirëmbajtja do të përbëhet nga ky ndikim më së shumti do të afektojë habitatet. Ndërrimi i vegjetacionit pyjor në vegjetacion jo pyjor (habitat i dominuar nga speciet barishtore) brenda korridorit prioritar të sigurisë 5+5 m do të jetë permanent.

Një korridor permanent i sigurisë do të krijohet po ashtu në llojet tjera të habitateve që janë të pranishme në korridorin e sigurisë. Brenda korridorit të sigurisë do të jetë e ndaluar të rriten bimët me rrënjë më të thella se 1 metër apo bimë që kultivohen duke gërmuar më shumë se 0,5 metra dhe. Kjo mirëmbajtje nuk do të ndikojë habitatet e ndryshme të barishteve, zonat me vegjetacion të rrallë dhe tokën bujqësore. Përdorimi i mëhershëm i tokës në këto sipërfaqe do të vazhdohet pa nevojë për masa speciale.

Brenda zonës prioritare të sigurisë (5+5 m) në zonën pyjore ku rivendosja e vegjetacionit pyjor është e pamundur, speciet e kafshëve do të ndryshohen ne favor të specieve që preferojnë hapësira në pyll. Ky ndikim do të jetë lokal dhe permanent, por i intensitetit të ulët.

Gjatë mirëmbajtjes brenda zonave të pyllit (largimi i bimëve me rrënjë të thella), do të krijohet zhurmë e intensitetit të ulët. Ky ndikim në faunë është i parëndësishëm.

Pasiqë karakteristikat e habitateve që kanë qenë prezente më parë do të restaurohen (përveç vegjetacionit pyjor në korridorin e sigurisë), ndikimi në faunë nuk pritet të ndodhë gjatë fazës së operimit.

Lokacionet e objekteve mbitokësore dhe rrugët me qasje të përhershme (nëse planifikohen) do të konvertohen në mënyrë të përhershme, ashtu që nuk do të jenë të përshtatshme për faunën e pranishme më herët. Pasiqë këto objekte mbulojnë vetëm një sipërfaqe të vogël, impakti mbi faunën (për shkak të jodisponibilitetit të habitatit) do të jetë i rëndësisë së vogël.

Nuk duhet të përjashtohet mundësia që disa individë të specieve të bimëve invazive mund të paraqiten brenda korridorit të punës disa javë pas përfundimit të punë ndërtimore (gjatë fazës operuese të projektit). Prania e individëve të specieve të bimëve invazive mund të rrisin mundësinë e shpërndarjes së mëtejme të tyre dhe krijimi të popullimeve.

7.1.8 - Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura të natyrës shpallen me qëllim të mbrojtjes dhe kujdesit për biodiversitet, peizazh, karakteristika natyrore dhe trashëgimi kulturore dhe për ofrimin e një menaxhimi ligjor dhe me mjete të tjera. Gazsjellësi i planifikuar Prizren-Gjakova kalon përmes zonave të mbrojtura, Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë, dhe gazsjellësit Ferizaj-Prizren kalon afër Trungjet e Qarrit (Quercus cerris), në Jezerc në një distancë prej 96m.

Gazsjellësi Kufiri SHQ-Prizren kalon afër parkut natyror Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës, në distancë prej rreth 130m; ndërsa interkoneksioni Maqedoni e Veriut-Kosovë kalon afër zonës Ligatina e Hencit/ Radevës në distancë rreth 120m. Duke marrë parasysh distancën nga zonat e ndërtimit dhe gjendjen aktuale të zonave të mbrojtura, nuk pritet ndonjë ndikim i rëndësishëm permanent gjatë fazës së ndërtimit.

Zona e mbrojtur Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë ka për qëllim të mbrojë gryken e Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë dhe ky qëllim nuk do të ndikohet nga ndërtimi i gazsjellësit. Ndikim i mundshëm pritet në habitatet ujore të Drinit të Bardhë, siç shpjegohet në kapitullin për ndikimin në biodiversitet.

Për shkak të natyrës së projektit të planifikuar dhe distancës nga zona e ndërtimit mund të konkludohet që Trungjet e Qarrit (Quercus cerris), në Jezerc nuk do të përballen me ndonjë ndikim.

Me anë të qasjes së marrjes së masave paraprake dhe duke marrë parasysh vlerat e zonave të afërta të mbrojtura, janë vlerësuar ndikimet e mundshme të përkohshme. Gjatë punimeve të ndërtimit, zonat e mbrojtura do të jenë nën presion më të madh të shkaktuar nga prania e shtuar e njerëzve. Kjo do të shkaktojë trazim dhe stres te fauna lokale prezente. Pritet që zogjtë do të shmangin zonën e ndërtimit.

Vegjetacioni do të largohet dhe shpërndarja e habitateve do të ndryshohet. Çdo habitat i trazuar paraqet rrezik më të madh për shpërndarjen e specieve invazive. Ekziston mundësia e shpërndarjes dhe paraqitjes së specieve të reja invazive, prandaj edhe propozohen masa sanuese.

Mirëmbajtja e zonës prioritare të sigurisë do të shkaktojë prani të shtuar njerëzore dhe zhurmë, e cila përkohësisht do të largojë faunën e panishme lokale në zonën më të gjerë të zonave të mbrojtura. Të gjitha ndikimet në faunën lokale do të jenë të përkohshme, të kufizuara në hapësirën e zons së prioritetit të lartë dhe të intensitetit të ulët.

7.1.9 - Peizazhi

Gjatë fazës së ndërtimit ndikimet në karakteristikat e peizazhit mund të ndahen në dy grupe:

- Ndkimi fizik në elementet e peizazhit,
- Ndikimi vizuel.

Punët në gërmim dhe mbushje, ndërtimi i objekteve dhe rrugëve për qasje shkakton degradim vizuel dhe struktural. Pas gërmimit dhe mbushjes në disa vende mbetet tokë e zbrazët me ngjyrë të ndryshuar e cila është në kundërshtim me gjendjen e saj natyrale.

Largimi i vegjetacionit të lartë ndryshon pamjen e hapësirës dhe kjo është njohur si një ndikim potencial i rëndësisë së madhe. Kjo përfshin largimin e përkohshëm për punimet dhe largimin e përhershëm të vegjetacionit në zonën e sigurisë. Pas punimeve do të ndodhë rehabilitimi biologjik i vijimësisë natyrore në pjesën e dëmtuar. Në këto pjesë ndikimi negativ do të jetë shumë i reduktuar apo i eliminuar fare. Në pjesët ku kjo nuk është e mundur (zona e sigurisë) vegjetacioni do të largohet.

Ndërtimi i objekteve mbitokësore shfaq elemente antropogjenike në peizazhe natyrore apo kulturore. Këto elemente paraqesin një element të padëshiruar vizual.

Gjatë fazës së ndërtimit ndikimi vizuel është i rëndësishëm, dhe shkaktohet nga prania e punës së makinerive, materialeve ndërtimore dhe më së shumti nga punët e gërmimit dhe mbushjes. Disa pjesë të këtyre ndikimeve janë të përkohshme dhe zhduken me përfundimin e punëve, dhe pjesa më e madhe e projektit është e dukshme gjatë fazës së ndërtimit dhe më vonë. Për këtë arsye, ndikimi vizuel përpunohet në fazën operative të projektit.

Gjatë vazës së operimit ndikimet në karakeristikat e peizazhit mund të ndahen në dy grupe:

- Ndikimet vizuele,
- Karakteri i peizazhit.

Në fazën e operimit pritet një reduktim gradual i ndikimeve negative. Pas rivendosjes së hapësirës punuese dhe gjatë suksedimit natyror peizazhi vizualisht dhe funksionlisht do t'i adaptohet situatës së re në mënyrë të pjesërishme.

Ndikimet vizuele më së shumti theksohen në rast të objekteve mbitokësore. Këto ndikime nuk mund të shmangen në nivel të përgjithshëm mirëpo janë disa masa të cilat mund ta lehtësojnë atë.

Ndikimet në karakterin e peizazhit manifestohen në ndryshimin permanent të karakteristikave të peizazhit në vendet e objekteve mbitokësore dhe zonës së sigurisë në pyll. Kjo do të rezultojë në ndryshim të karakeristikave vizuele, dhe pjesërisht në mënyrën se si do të përdoret peizazhi.

7.1.10 - Trashëgimia kulturore

Gjatë fazës së ndërtimit në këtë zonë, ndikimi fizik është shumë i mundshëm gjatë operimit të makinerisë së ndërtimit dhe nxjerrjes së dheut. Ndikimet fizike negative janë kryesisht të mundshme në formë të shkatërrimit tëvendeve të njohura dhe të panjohura arkeologjike. Zonat e ndërtuara të trashëgimisë kulturora dhe zonat arkeologjike janë të mbrojtura me me ligjin përkatës dhe praktikat e mirë gjatë ndërtimit. Këto përbëhen nga ndërtesat e shenjta, elementet e trashëgimisë arkitekturore dhe zonat e vlerës kulturore komunale si varrezat dhe monumentet tjera. Gjatë fazës së ndërtimit të gazsjellësit të planifikuar dhe të objekteve mbitokësore, aktivitetet e ndërtimit mund të shkaktojnë ndikime minore dhe të përkohshme në kontekstin kulturor të zonës. Ky ndikim maifestohet si shkelje e integritetit kulturor të zonës për shkak të pranisë së makinerisë ndërtimore, materialeve ndërtimore, materialeve ekskavuese dhe largimit të vegjetacionit.

Në fazën e operimit janë të mundshme ndikime indirekte në trashëgiminë kulturore përmes perceptimit negativ të afërsisë së zonës së trashëgimisë kulturore me elementet e gazsjellësit. Objektet që lidhen me gazsjellësin e planifikuar kane karakter teknogjenik dhe si të tilla kanë karakteristika që janë në kundërshim me elementet e trashëgimisë kulturore. Prania e elementeve të ndryshme në një zonë më të vogël mund të ndikojë negativisht përvojën e një elementi më sensitiv, i cili në këtë rast është element i trashëgimisë kulturore. Ky ndikim karakterizohet si negativ. Kjo formë e ndikimit është më e rëndësishme në zonat historikisht të ruajtura që ngërthehen me asete të vlefshme dhe të mbrojtura.

7.1.11 - Shëndeti i njeriut

Ndikime të mundshme mund të ndodhin në shëndetin e komunitetit gjatë fazës operative në rast të rrjedhjes së tubave apo situatave aksidentale. Rrjedhet e mëdha nga tubat mund të kenë ndikim në shëndetin e njeriut dhe në florën dhe faunën afër gazsjellësit. Në rast të ekspozimit ndaj gazit simptomat janë frymëmarrja e vështirësuar, marrje mendsh, turbullim, kokëdhimbje, irritim në sy dhe fyt, të përziera, dhimbje në gjoks, fishkëllimë në vesh etj. Në rastet më të këqija ekspozimi i madh ndaj gazit mund të shkaktojë vdekjen.

Për shkak të djegshmërisë së lartë të gazit natyror, rrjedhjet mund të shkaktojnë zjarre dhe eksplodime që mund të kenë shumë ndikime negative në lokacionin e gazsjellësit dhe në vendbanimet më të afërta.

Shëndeti dhe siguria publike gjatë operimit është marrë parasysh gjatë projektimit të objekteve dhe vlerësimi i rrezikut është bërë.

Për të adresuar trajtimin e rriskut nga mbetjet të shoqëruar me ngjarje jo-rutinore gjatë operimit, menaxhmenti i projektit do të krijojë një plan të reagimit emergjent (ERP) i cili do të specifikojë veprimet në rast të një incidenti. Ky plan i veprimit do të zhvillohet sipas kritereve vendore dhe të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare të industrisë dhe praktikave më të mira. Zhvillimi i ERP do të përfshijë konsultimet me autoritetet kompetente, shërbimet emergjente, mbrojtjen civile dhe administratat komunale përgjatë linjës së gazsjellësit dhe stacionet e kompresimit. Familjet në komunitetet në afërsi do të pranojnë informata me anë të fletushkave që këshillojnë si të sillen në rast të një rrjedhjeje apo aksidenti.

Si me çdo lloj të burimit të energjisë, përdorimi i gazit mund të ndikojë në shëndetin e popullsisë, si gjatë përdorimit të rregullt të gazit ashtu edhe gjatë parregullsive (rrjedhjet, problemet me oxhakë, etj.). megjithatë, për shkak se kjo i intereson konsumatorit, ko është një çështje që duhet të adresohet nga shpërndarësit lokalë të gazit dhe kompanitë e angazhuara për instalimin e lidhjeve, oxhakëve, bojlerave, stufave etj., përmes mirëmbajtjes së rregullt, dhe jo nga operatori i projektit.

Punët e mirëmbajtes lidhur me operimin e gazsjellësit vijnë me rreziqet në vijim: rreziku nga goditja elektrike, drita joadekuate, rreziqet gjatë mirëmbajtjen dhe operimit të sistemeve të çkyçjes, mungesat e shenjave të paralajmërimit, rreziqet e përshkruara nëse nuk përdoren pajijet e mbrojtjes personale, etj. E gjithë puna e mirëmbajtjes duhet të kryhet në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm nacional dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, veçanërisht ato lidhur me parandalimin e aksidenteve.

Gjatë fazës së operimit, zhurma mund të vijë nga shfryrja e gazit në stacionet e bllok-valvulave dhe në reduktimin e presionit në stacionet matëse.

Zhurma nga shfryrja e gazit mund të jetë e pakëndshme pasi që mund shkojë deri në 100 dB (A) 50 m larg nga stacioni bllokues dhe ka një veti fërshëllyese për shkak të lëshimit të gazit përmes valvulave shfryrëse. Ky proces mund të zgjasë deri në 2 orë. Shfryrja mund të jetë e planifikuar dhe periodike kur nevojitet për mirëmbajtjen e gazsjellësit (një herë në vit deri në një herë në pesë vjet) dhe banorët lokalë mund të njoftohen paraprakisht dhe të përgatiten për zhurmën. Po ashtu mund të jetë e nevojshme në rast të emergjencës/aksidentit në gazsjellës.

Përdorimi i gazsjellësit nuk do të ketë potencialin për shtim të sëmundjeve infektuese, prandaj nuk shkakton përkeqësimin e shëndetit. Projekti në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë në qasjen e njerëzve në kujdesin shëndetësor.

Pasiqë ndikimi në nivel të VSM nuk dallon mes gazsjellësve, nuk paraqitet ndikimi tjetër potencial për linja specifike të gazsjellësit.

7.1.12 - Popullsia dhe vendbanimet

Plani i Zhvillimit të Gazit (ZHG) sipas linjave të propozuara të gazsjellësit identifikohet si plan me shumë ndikime pozitive për popullatën brenda vendbanimeve të Republikës së Kosovës. Ndikimi direkt pozitiv idenifikohet përmes ofrimit të gazit në zonat urbane dhe rurale që mund të kontribuojë në përmirësimin afatgjatë të

kushteve të jetesës. Me anë të ofrimit të më shumë mundësive në punësim duke ofruar energji të qëndrueshme për sektorin e ekonomisë, në mënyrë indirekte ofron përmirësime në indikatorët demografikë duke përfshirë rritjen e popullsisë, shkallën e fertilitetit, dhe mund të inkurajojë që më shumë të rinjë të vendosin të rrijnë në këto zona për të kontribuar në ekonominë dhe mirëqenien lokale. Gjatë operimit gazsjellësit nuk janë pika të rrezikshme, prandaj nuk kanë ndikim në popullsinë që jeton në afërsi të gazsjellësit.

Megjithatë disa efekte negative të popullata mund të shfaqen, për shkak të aktiviteteve lidhur me ndërtimin të cilat mund të prodhojnë zhurmë dhe pluhur, por që mund të lokalizohet dhe është afatshkurtër. Përveç kësaj, ndikime mund të priten në rast se linja kalon përmes apo shumë afër zonës së populluar, që ka të bëjë me okupimin e tokës brenda zonës së sigurisë. Nëse linja kalon shumë afër një ndërtese ka mundësi që pronarit t'i dëmtohet aseti në formë të zhvlerësimit të pronës së paluajtshme. Në këtë ast do të merren masa speciale të mbrojtjes së njerëzve dhe pasurisë për të siguruar stabilitetin e gazsjellësit dhe për të shmagur aksidentet potenciale.

Në shumicën e rasteve, ndikimet negative do të jenë të përkohshme dhe do të përfundojnë pas kompletimit të fazës së ndërtimit dhe mund të sanohen përmes një kombinimi të mekanizmave të planifikimit dhe resurseve të menaxhimit në vend të ngjarjes.

Ndikim negativ mund të ketë për pronarët e tokave dhe bartësit e të drejtave në tokat e identifikuara si të humbura përgjithmonë në gjerësinë e rripit mbrojtës permanent ("e drejta e kalimit"), i cili nënkupton 5 metra tampon në dy anët e boshtit të gazsjellësit, dhe në lokacionet e objekteve mbitokësore. Këto ndikime negative mund të lehtësohen me shmangien e zonave të populluara përgjatë linjës gjatë fazës së projektimit si dhe me anë të riparimit duke ofruar konsultime dhe mjete kompensimi.

7.1.13 - Aktivitetet kryesore të popullsisë

Pjsa më e madhe e të 15 linjave të gazsjellësit janë të pozicionuara mbi rajon bujqësor. Nga 369,5 kilometrat e gazsjellësit të planifikuar, 288 km kalojnë mes tokës bujqësore dhe kullotave, që përbëjnë deri në 78% të gjatësisë së linjës. Pasi që familjet jourbane në përgjihësi kanë konsum më të madh të produkteve nga prodhimet e tyre, vçanërisht ato ushqimore, një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet shpenzimeve të familjeve, të cilat as nuk paraqesin blerje të vërtetë, as shpenzim të vërtetë dhe të cilat lidhen me qiranë e ngarkuar dhe konsumin nga prodhimet e veta, të përfshihen në shpenzimet e konsumit të familjes. Në këtë mënyrë, ekziston një ndikim potencial në projekt në uljen e konsumit të produkteve nga prodhimtaria bujqësore e familjes në zonën e projektit si rezultat i largimit të kulturave bujqësore në gjerësi të rripit punues. Një ndikim i tillë do të jetë i përkohshëm dhe do të ndalojë pas përfundimit të fazës së ndërtimit, prandaj nuk do të ketë ndikim të madh në prodhimin bujqësor. Këto efekte po ashtu do të jenë të kufizuara dhe do të sanohen me anë të përgatitjes dhe implementimit të Planit të monitoritmit të menaxhimit ambiental dhe social. Sa i përket çështjes së qirasë së ngarkuar, nuk do të ketë ndonjë ndikim pasi që nuk do të ketë lëvizje të përhershme apo të përkohshme të banorëve.

Përveç ndikimit në shpenzimet e familjes, duhet të pritet edhe një rritje në shpenzimet e banimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse për shkak të nevojës së pastrimit të terrenit në pjesët e pyllit. Pastrimi i terrenit në pjesën e pyllit do të përfshijë prerjen e drurëve gjatë ndërtimit të projektit dhe ndërtimit të rrugëve dhe kampeve, gjë që do të kishte ndikim sekondar në eksploatimin e pyllit për furnizim bazik me dru zjarri, që për pasojë i rrit shpenzimet familjare të banimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse. Siç u përmend më sipër, pjesa më e madhe e tërë 22 linjave të gazsjellësit të parashikuara janë pozicionuar mbi sipërfaqe të rrafshëta kryesisht bujqësore me pak ose fare ndikim në pylltari si aktivitet ekonomik. Të vetmet pjesë ku pyjet do të ndikohen janë ato ku linjat shtrihen mbi zona pyjore sensitive (shpate me pjerrtësi më shumë se 15°, pyje me lartësi të madhe dhe me forma të larta silvikulturale) dhe zonat e larta silvikulturale. Pjesa më e madhe e ndikimeve negative do të ndodhin gjatë fazes së ndërtimit, dhe më e rëndësishmja është prerja dhe pastrimi i zonës së brezit punues për vendosjen e oborrit të punës. Megjithatë këto ndikime do të jeë të përkohshme dhe do të ndalojnë pas kompletimit të fazës së ndërtimit, prandaj nuk do të ketë asnjë ndikim të madh negativ në shpenzimet e familjeve. Kur bëhet fjalë për pylltarinë si një degë e ekonomisë, të gjithë druri që do të pritet për ndërtim do t'u dorëzohet pronarëve formalë, personave shtetërorë apo privatë. Ndikimi në humbjen e

përhershme të pyllit në gjerësi të brezit permanent mbrojtës ("e drejta e kalimit"), i cili merr 5 metra bafer nga të dyja anët e aksit të gazsjellësit, do të jetë i parëndësishëm.

Ndikimi në gjueti do të jetë i dyfishtë: ndikim negativ do të ndodhë gjatë fazës së ndërtimit, pasi që të gjitha kafshët do të largohën nga zona e gjerë e ndërtimit dhe aktivitetet e gjuetisë do të pezullohen gjatë ndërtimeve. Sidoqoftë ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe do të ndalojë pas kompletimit të fazës së ndërtimit, pas së cilës kafshët e gjuetisë do të kthehen në zonën e ndikuar. Në anën tjetër, ndikimim gjatë fazës së operimit do të jetë pozitiv – brezi permanent i sigurisë 10 metra i gjerë ofron mbulesë (zona të strehuara me shkurre e kaçuba që përdoren nga speciet e ndryshme të kafshëve të gjahut për ushqim e fshehje), por po ashtu kushte të favorshme për gjueti si vende për gjuajtje për shkak të pamjes më të mirë të terrenit.

Nuk ka ndikime direkte negative në projekt sa i përket punësimit lokal në fazën e ndërtimit, pasi që projekti kryesisht do t'i kontribuojë punësimit lokal. Megjithatë, përfitimet potenciale nga projekti për punësimin lokal janë të kufizuara në spektër, që do të thotë se më së shumti do t'u referohen grupeve vulnerabël, që janë punëtorët e pakualifikuar, pa shkollim, me shkallë të ulët shkrim-leximit. Pritet që punëtorët e pakualifikuar do të përfitojnë më pak nga mundësitë në punësim të krijuara nga Projekti se sa popullsia e gjerë. Këto kufizime mud të kufizohen me anë të përgatitjes dhe implementimit të Strategjsë së punësimit dhe planit të menaxhimit të punëtorëve.

Ndikimet pozitive

Do të ketë rritje të mundësive direkte dhe indirekte për punësim për shkak të nevojës për fuqi punëtore në ndërtim. Gjatë fazës së ndërtimit objeket dhe kampet e personelit, pajisjet dhe materialet e ndërtimit do të gjenden përreth lokacionit të projektit. Mund të pritet që secili kamp i ndërtimit të punësojë punëtorë të kualifikuar dhe gjysmë të kualifikuar për të ofruar shërbime në mirëmbajtje, ushqim, siguri dhe transport (numrat dhe pozitat ende nuk janë llogaritur). Megjithëse punëtorët do të jenë në gjendje të vizitojnë qytetet më të mëdha gjatë ditëve të pushimit, shpenzimet jashtë kampit nuk pritet të jenë domethënëse apo afatgjata sa për të rezultuar në krijimin e punësimit. Në këtë kuptim, mund të pritet që faza e ndërtimit do të krijojë së pari rritje të mundësive direkte dhe indirekte në punësim (më së shumti të pa kualifikuar) dhe pastaj përfitime të shkallës më të vogël të ekonomisë lokale për shkak të rritjes së konsumit sa u përket mallrave dhe shërbimeve. Pasi që të gjitha kampet e ndërtimit janë të karakterit të përkohshëm dhe do të largohen plotësisht pas periudhës së ndërtimit, këto ndikime priten vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

Aranzhime të veçanta do të bëhen për fjetjen dhe mirëqenien e personelit të nevojshëm për ndërtimin e gazsjellësit me anë të kontraktorëve duke ndërtuar, pajisur dhe mirëmbajtur ndërtesat e përkohshme dhe kampet. Do të ketë nevojë për akomodim të shkallës së ulët në qytetet dhe vendbanimet e afërta gjatë fazës para ndërtimit. Kjo do të krijojë mundësi për banorët lokalë që të ofrojnë shërbime mbështetëse si: ushqim, transport dhe banim për punëtorët e ndërtimit dhe të tjerë të involvuar në përfundimin e projektit. Këto ndikime megjithatë pritet të jenë të shkallës së ulët dhe të përkohshme vetëm para fazës para ndërtimit. Varësisht nga aftësia për të bërë biznes dhe mundësitë e popullsisë lokale, kompanitë lokale do të kenë mundësinë që t'u ofrojnë operatorit dhe kontraktorëve të tij shërbimet apo mallërat e veta, gjë që pa dyshim do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë lokale dhe në përgjithësi në perceptimin e banorëve lokalë për projektin.

Konsumi i materialeve të lëndës së parë do të rritet gjatë fazës së ndërtimit. Materialet e kërkuara (rëra dhe zhavori) do të merren nga separacionet lokale të aprovuara. Në këtë kuptim, sektori i industrisë pritet të prosperojë gjatë fazës së ndërtimit në komunat nga të cilat mund të merret lënda e parë. Në kontekst nacional, aktivitete të tilla rritin të hyrat për qeverinë e cila pastaj do t'i shpenzojë për shërbime publike, mirëqenie dhe qëllime të tjera përmes tatimit në të ardhura rriten të ardhurat e punëtorit; taksa korporative vendoset në profitin e kompanisë; kontributet e sigurimit social si te punëtorit ashtu edhe të punëdhënësit; dhe të hyrat nga TVSH rriten si rezulat i rritjes së konsumit.

Kosova nuk ka rrjet vendor të furnizimit të gazit dhe as nuk është e lidhur me rrjetin rajonal apo evropian të gazit, prandaj dhe nuk ka treg të gazit në Kosovë. Ndikimi kryesor për shkak të operimit të projektit do të jetë

rritja e mundësisë për përdorimin e një burimi më të pastër të energjisë dhe rritja e e efikasitetit të energjisë në Kosovë duke përmirësuar besueshmërinë dhe qendrueshmërinë e furnizimit me energji. Diversifikimi i furnizimit me energji është krucial për sigurinë në energji, dhe projekti i gazsjellësit mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Kjo do t'i krijojë kushtet për një furnizim afatgjatë, të sigurt dhe të besueshëm për të gjithë konsumatorëët e gazit natyror në Kosovë.

Peizazhi	Ndikimi i mundshëm mbi peizazh ndodh gjatë gërmimit të kanaleve të gazsjellësit dhe ndërtimit dhe rindërtimit të rrugëve hyrëse. Peizazhi pyjor/malor do të dëmtohet përkohësisht në brezin e punës. Gjatë operimit do të formohet një vijë e përhershme bari nëpër pyll, por nuk do të jetë e dukshme nga zonat e banuara.	-1	
Trashëgimia kulturore	Në afërsi të konsiderueshme të projektit të planifikuar nuk ka asete kulturore nga lista e pasurive kulturore dhe natyrore të UNESCO. Sipas të dhënave të trashëgimisë kulturore, nuk ka objekte arkeologjike apo elemente të ndërtuara të trashëgimisë kulturore në afërsi.	0	
Popullsia dhe vendbanimet	Linja e planifikuar e gazsjellësit shmang zonat e populluara duke marrë parasysh afërsinë e vendbanimeve për të siguruar shpërndarjen e gazit në zonat e popullsisë urbane dhe rurale të Komunës së Hanit të Elezit. Zhvillimi i gazifikimit brenda linjës së planifikuar të gazsjellësit mund të kontribuojë drejt përmirësimeve afatgjata të mirëqenies dhe kushteve të jetesës, si dhe përmes ndikimit indirekt të sektorit ekonomik që mund të përfitojë nga zëvendësimi i burimeve të energjisë dhe të ofrojë mundësi punësimi duke mbështetur mirëqenien dhe kushtet më të mira të jetesës dhe indirekt mund të inkurajojë më shumë të rinjtë të qëndrojnë në këto zona duke përmirësuar treguesit demografikë, duke përfshirë rritjen e popullsisë, shkallën e lindshmërisë. Mund të lindin disa efekte negative në popullatë për shkak të aktiviteteve të lidhura me ndërtimin, të cilat mund të prodhojnë zhurmë dhe pluhur që ka të ngjarë të jenë të lokalizuara dhe në afat të shkurtër. Gjatë funksionimit, pronarët e tokave dhe bartësit e të drejtave në tokën e identifikuar mund të përballen me ndikime negative nëpërmjet humbjes së përhershme të tokës në gjerësinë e brezit tampon të përhershëm ("e drejta e kalimit"), që një tampon 5 metra nga të dyja anët e aksit të gazsjellësit dhe në vendndodhjet e objekteve mbitokësore. Për më tepër, ,mund të krijohen ndikime negative për pronarët e tokave dhe bartësit e të drejtave të tokës në lidhje me zënien e tokës brenda zonës së sigurisë (supozoni 30 m tampon nga të dy anët e aksi të gazsjellësit) ku mund të zbatohen disa kufizime ndërtimi.	+1	-1
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë/Fitimi i jetesës	Gjatë fazës së ndërtimit priten ndikime të mundshme negative të gazsjellësit në shfrytëzimin e tokës dhe lidhur me mjetet për fitimin e jetesës, për shkak të krijimit të brezit të punimeve për gazsjellësin në kushtet e humbjes së përkohshme të tokës/aseteve dhe dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës ku kalon gazsjellësi/ përgjatë gazsjellësit. Këto ndikime do të shfaqen drejtpërdrejt në humbjen e përkohshme të tokës/aseteve dhe dëmtimin e mundshëm të infrastrukturës ku kalon gazsjellësi/përgjatë gazsjellësit dhe indirekt në humbjen e të ardhurave. Humbja e të ardhurave të mundshme që rrjedhin nga përdorimi i tokës/aseteve. Ndikimet e tilla do të prekin pronarët e	+1	-1

Tema	Ndikimet e pritshme	Vlerësimi	
	tokave/bartësit e të drejtave të tokës dhe aseteve brenda korridorit të punimeve, në vendndodhjen e objekteve mbitokësore, kampet dhe pronarët e tokave dhe pronarët dhe bartësit e të drejtave të infrastrukturës që përshkohet nga gazsjellësi. Pas ndërtimit, pjesa më e madhe e tokës do të restaurohet dhe do t'u kthehet pronarëve të tyre, përveç tokës në lokacionet e objekteve mbitokësore që do të blihet. Gjatë funksionimit, pjesa më e madhe e aseteve të tjerave të kërkuara do të jepen me qira ose mundësohen dhe pronarët e tokave do të mbajnë pronësinë e tyre. Operatori i gazsjellësit do të ketë nevojë për servitutet afatgjata të tokës (e drejta e kalimit) për zonën e sigurisë prioritare të gazsjellësit (5+5m) dhe zonën e sigurisë (30+30m). Në këtë rast operatori i gazsjellësit ka të drejtë të hyjë në të (për punët e mirëmbajtjes, për shembull) dhe të vendosë kufizime të caktuara në mënyrën se si toka përdoret për ciklin e jetës së gazsjellësit. Funksionimi i gazsjellësit do të shkaktojë kufizime për të ruajtur integritetin e gazsjellësit brenda zonës prioritare të sigurisë dhe zonës së sigurisë.		

7.16 - Gazsjellësi Prizren – Kufiri SHQ/KOS


7.16.1 - Përshkrimi i linjës

Ky gazsjellës transmisioni është afërsisht 20,0 km i gjatë dhe nga pika kufitare SHQ/KOS shkon përgjithësisht në drejtimin verilindor mbi zonat e banuara në korridorin e autoudhës kryesore Kukës-Prishtinë, E851 (R7). Lartësitë variojnë nga 310 m në 530 m (a.s.l.).

Pikënisja është pika kufitare ALB/KOS dhe pika përfundimtare e seksionit është SKT/SMRP Prizren. Linja e krahasueshme e këtij seksioni është planifikuar në kuadër të studimit paraprak të fizibilitetit të interkonjeksionit të gazit ALKOGAP dhe si e tillë konsiderohet si pjesë e Planit Zhvillimor të Gazit të Kosovës.

Korridori përshkon autoudhën Kukës-Prishtinë E851 (R7) tri herë, në lokacione të ndryshme. Që nga fillimi i tij, në pikën kufitare, gazsjellësi shkon drejt Vërmicës, vazhdon mbi një kodër të thyer pranë fshatit Zhur dhe më pas kalon nëpër rrafshnalta në jug të Vlashnjes. Korridori përshkon autoudhën kryesore Kukës – Prishtinë ndërmjet Zhurit dhe fshatit Vlashnje dhe mbetet në anën veriore të tij deri në SKT/SMRP Prizren.

FIGURA 71 – HARTA PËRMBLEDHËSE – GAZSJELLËSI PRIZREN – KUFIRI SHQ/KOS



7.16.2 - Përmbledhje e ndikimit të pritshëm

Tema	Ndikimet e pritshme	Vlerësimi	
Klima dhe ndryshimet klimatike	Gjatë ndërtimit priten disa emisione të gazrave serrë nga automjetet dhe makineritë që përdorin lëndë djegëse fosile. Ky efekt është i pashmangshëm dhe do të përfundojë me përfundimin e ndërtimit. Gjatë funksionimit normal priten disa emisione të gazeve serrë nga boilerët e gazit natyror dhe emisione të largëta nga gazsjellësi dhe objektet mbitokësore. Këto emisione pritet të jenë të vogla. Priten efekte pozitive nga përdorimi i gazit natyror pasi ka emisione më të pranueshme në krahasim me lëndët djegëse të tjera fosile.	+1	-1
Gjeorreziqet	Gazsjellësi gjendet në zonë me potencial shumë të lartë për përmbytje.	-1	
Ujërat	Gazsjellësi kryqëzohet me këtë lumë: ■ Lumi Lumbardhi i Prizrenit Ndërtimi i gazsjellësit mund të shkaktojë përkohësisht një ndikim negativ të kthyeshëm në trupin ujor për shkak të presionit hidromorfologjik dhe shkëputjes së sedimentit.	-1	

Tema	Ndikimet e pritshme	Vlerësimi
	Gazsjellësi është kryesisht i vendosur në zonën e akuiferit. Ndërtimi i gazsjellësit mund të shkaktojë ndotje të trupave ujorë nëntokësorë në rast derdhjesh të vajrave/kimikateve.	
Dheu dhe bujqësia	Pjesa më e madhe e linjës ndodhet në zonën e tokës kafe, të kuqe dhe të shkrifët. Zona dominohet nga toka e punueshme pa ujitje dhe nga modele komplekse kultivimi. Rreth Prizrenit, ka disa vreshta dhe pemishte të vendosura afër rrugës. Linja kalon në një gjatësi prej 17,5 km nëpër tokë bujqësore. Gjatë punimeve të ndërtimit pritet ndikim negativ mbi tokën bujqësore nga punimet e gërmimit. Sipërfaqja e tokës me bimësi mbuluese ose kultura bujqësore do të hiqet nga toka bujqësore, në gjerësinë e korridorit të punimeve, gjatë ndërtimit të disa objekteve mbitokësore dhe ndërtimit të rrugëve hyrëse. Pas përfundimit të ndërtimit, toka bujqësore do të kthehet në gjendjen e saj origjinale dhe mund të rifillojë kultivimi i kulturave (vetëm kufizimet janë në zonën tapon të linjës 5+5 m për kulturat me rrënjë që rriten më thellë se 1m ose kultura që kanë nevojë për trajtim të tokës më thellë se 0,5 m). Ndikimi mbi tokën bujqësore gjatë fazës së ndërtimit pritet të jetë i përkohshëm, linear dhe lokal sepse lidhet me periudhën e punimeve të ndërtimit dhe me korridorin e punimeve. Vetëm gjatë fazës së funksionimit ndikimi mbi tokën bujqësore pritet të jetë në zonën 5 m nga aksi i linjës së gazsjellësit (zona tampon e gazsjellësit) dhe do të ndalohen kulturat me rrënjë që rriten më thellë se 1 m ose kulturat që kanë nevojë për trajtim të tokës më thellë se 0,5 m. Ky ndikim më së shumti i referohet kulturave të përhershme (pemishte, vreshta, etj.). Në zonën e ndërtimit të objekteve mbitokësore priten ndryshime të përhershme të përdorimit të tokës dhe humbje të përhershme të tokës bujqësore.	-1
Biodiversiteti	Linja kalon në mënyrë të konsiderueshme përmes llojeve të habitateve E2 (kullota) dhe J4 (industriale). Habitatet I1 (bujqësore), FB dhe G1 (pyjore), J3 (industriale) dhe E1 (kullota) janë gjithashtu të pranishme. Në fund të linjës ndodhet një përqendrim i plantacioneve të shkurreve nga SKT/SMRP. Gjatë ndërtimit, do të ketë humbje të përhershme të florës fillestare brenda zonës së punimeve. Pas ndërtimit do të mbetet një korridor 5+5 m, i pastruar nga flora e pyllëzuar. Ky habitat nuk është i ndjeshëm, ndikimi mendohet të jetë i dobët dhe i lokalizuar. Pjesa e mbetur pyjore gjendet në zonën më të gjerë dhe nuk do të ndikohet. Gjatë ndërtimit, bimësia kullotore do të hiqet nga brezi i punës dhe fauna do të largohet përkohësisht nga zona. Gjatë përdorimit, bimësia do të kthehet në një gjendje pothuajse identike. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e gazsjellësit do të ndërtohet përgjatë infrastrukturës antropogjene tashmë të pranishme duke ulur më tej ndikimet tashmë të lokalizuara dhe të papërfillshme. Po ashtu, nga kjo pikë gazsjellësi i propozuar kalon mbi 4 rrugë ujore të ndryshme. Ndërtimi do të shkaktojë shtëllungë të lokalizuar të sedimentit dhe do të sjellë shqetësime afatshkurtra dhe të lokalizuara në faunën ujore aktuale. Intensiteti i ndikimit të mundshëm varet nga mënyra se si do të vendoset gazsjellësi dhe nga madhësia dhe rrjedha e ujit. Vdekjet e individëve të pranishëm lokalisht priten vetëm në rastin e organizmave të mundshëm ujorë. Ndikimi mbi peshqit migrues varet nëse gazsjellësi do të ndikojë në rrjedhën e ujit.	-1

Tema	Ndikimet e pritshme	Vlerësimi	
Zonat e mbrojtura	Zona e mbrojtur Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës shtrihen 130m nga gazsjellësi. Për shkak të natyrës së projektit dhe largësisë nga zona e mbrojtur, nuk priten ndikime negative.	0	
Peizazhi	Ndikimi i mundshëm në peizazh ndodh gjatë gërmimit të kanaleve të gazsjellësit dhe ndërtimit dhe rindërtimit të rrugëve hyrëse. Në brezin e punës do të dëmtohet përkohësisht peizazhi kodrinor me vendbanime, kullota fushore dhe copa pyjore. Ndikimi i përkohshëm në pamjet dhe përvojën e peizazhit do të jetë nga vendbanimet e afërta. Gjatë funksionimit do të formohet një vijë e përhershme bari përmes pjesëve të pyjeve. Rreth vendbanimit të Vërmicës gazsjellësi kalon pranë parkut natyror Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës (pranë liqenit të Fierzës), ndërmjet rrugës lokale dhe autoudhës. Duke pasur parasysh objektet ekzistuese të infrastrukturës në zonë, ndikimi i gazsjellësit të planifikuar në parkun natyror do të jetë i papërfillshëm. E gjithë linja është kryesisht e pozicionuar së bashku me elementin ekzistues të infrastrukturës (rruga dytësore R-206) e cila minimizon ndikimin në karakterin e peizazhit..	-1	
Trashëgimia kulturore	Ndërmjet vendbanimeve Vlashnje dhe Poslishtë është planifikuar një linjë dhe në atë zonë ndodhen lokalitetet arkeologjike Vlashnje dhe Poslishte. Vlashnje është e vendosur ndërmjet 300 dhe 600 m në veri, dhe Poslishte është e vendosur ndërmjet 250 dhe 550 m në jug. Afërsia e zonave arkeologjike është tregues dhe mundësia për të hasur në zona arkeologjike të pazbuluara është rritur. Vendndodhja më e afërt e UNESCO – Kisha e Virgjëreshës Levisa është rreth 5 km në jug, brenda strukturës urbane të Prizrenit..	-1	
Popullsia dhe vendbanimet	Linja e planifikuar e gazsjellësit shmang zonat e dendura të populluara duke marrë parasysh afërsinë e vendbanimeve për të siguruar shpërndarjen e gazit në zonat e popullsisë urbane siç janë vendbanimet brenda Komunës së Prizrenit. Zhvillimi i gazifikimit brenda linjës së planifikuar të gazsjellësit mund të kontribuojë drejt përmirësimeve afatgjata të mirëqenies dhe kushteve të jetesës, si dhe përmes ndikimit indirekt të sektorit ekonomik që mund të përfitojë nga zëvendësimi i burimeve të energjisë dhe të ofrojë mundësi punësimi duke mbështetur mirëqenien dhe kushtet më të mira të jetesës dhe indirekt mund të inkurajojë më shumë të rinjtë të qëndrojnë në këto zona duke përmirësuar treguesit demografikë, duke përfshirë rritjen e popullsisë, shkallën e lindshmërisë. Mund të priten ndikime negative në rastin e kalimeve të trasesë nëpër zonat e populluara si vendbanimi Vërmicë në Komunën e Prizrenit. Nëse rruga kalon afër ndërtesës ose objektit të ndërtuar tashmë, ekziston mundësia e dëmtimit të pasurisë së pronarit të tokës në formën e zhvlerësimit të pasurive të paluajtshme. Disa efekte negative në popullatë mund të lindin për shkak të aktiviteteve të lidhura me ndërtimin, të cilat mund të prodhojnë zhurmë dhe pluhur që ka të ngjarë të lokalizohet dhe në afat të shkurtër. Nëse rruga kalon afër ndërtesës ose objektit të ndërtuar tashmë, ekziston mundësia e dëmtimit të aseteve të pronarit të tokës në formën e zhvlerësimit të pasurive të paluajtshme. Gjatë operimit, mund të ketë ndikim negativ për pronarët e tokave dhe bartësit e të drejtave në tokën e identifikuar nëpërmjet humbjes së përhershme të tokës në gjerësinë e brezit mbrojtës të përhershëm ("e drejta e kalimit"), i cili supozon një tampon 5 metra nga të dyja anët e aksit të gazsjellësit dhe në vendndodhjet e objekteve mbitokësore. Për më tepër, ndikimi negativ për pronarët e tokave dhe bartësit e të drejtave në tokë mund të lindë në lidhje me zënien e tokës	+1	-1

Tema	Ndikimet e pritshme	Vlerësimi	
	brenda zonës së sigurisë (supozoni 30 m tampon nga të dy anët e aksit të gazsjellësit) ku mund të ketë disa kufizime ndërtimi.		
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë/Fitimi i jetesës	Gjatë fazës së ndërtimit priten ndikime të mundshme negative të gazsjellësit në shfrytëzimin e tokës dhe lidhur me mjetet për fitimin e jetesës, për shkak të krijimit të brezit të punimeve për gazsjellësin në kushtet e humbjes së përkohshme të tokës/aseteve dhe dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës ku kalon gazsjellësi/ përgjatë gazsjellësit. Këto ndikime do të shfaqen drejtpërdrejt në humbjen e përkohshme të tokës/aseteve dhe dëmtimin e mundshëm të infrastrukturës ku kalon gazsjellësi/përgjatë gazsjellësit dhe indirekt në humbjen e të ardhurave. Humbja e të ardhurave të mundshme që rrjedhin nga përdorimi i tokës/aseteve. Ndikimet e tilla do të prekin pronarët e tokave/bartësit e të drejtave të tokës dhe aseteve brenda korridorit të punimeve, në vendndodhjen e objekteve mbitokësore, kampet dhe pronarët e tokave dhe pronarët dhe bartësit e të drejtave të infrastrukturës që përshkohet nga gazsjellësi. Pas ndërtimit, pjesa më e madhe e tokës do të restaurohet dhe do t'u kthehet pronarëve të tyre, përveç tokës në lokacionet e objekteve mbitokësore që do të blihet. Gjatë funksionimit, pjesa më e madhe e aseteve të tjerave të kërkuara do të jepen me qira ose mundësohen dhe pronarët e tokave do të mbajnë pronësinë e tyre. Operatori i gazsjellësit do të ketë nevojë për servitutet afatgjata të tokës (e drejta e kalimit) për zonën e sigurisë prioritare të gazsjellësit (5+5m) dhe zonën e sigurisë (30+30m). Në këtë rast operatori i gazsjellësit ka të drejtë të hyjë në të (për punët e mirëmbajtjes, për shembull) dhe të vendosë kufizime të caktuara në mënyrën se si toka përdoret për ciklin e jetës së gazsjellësit. Funksionimi i gazsjellësit do të shkaktojë kufizime për të ruajtur integritetin e gazsjellësit brenda zonës prioritare të sigurisë dhe zonës së sigurisë. Përfitimet e mundshme të projektit për punësimin lokal janë të kufizuara në fushëveprim, përkatësisht, ai do t'i referohet më së shumti grupeve në nevojë, që i referohet punëtorëve të pakualifikuar, për shkak të nivelit të ulët të përfundimit të shkollës, shkallës së ulët të shkrim-leximit. Pritet që punëtorët e pakualifikuar të përfitojnë më pak nga mundësitë e punësimit të krijuara nga Projekti sesa popullsia e gjerë.	+1	-1

7.17 - Përmbledhje e ndikimeve të mundshme

	Klima dhe ndryshimet klimatike		Gjeorreziqet	Ujërat	Dheu dhe bujqësia	Biodiversiteti	Zonat e mbrojtura	Peizazhi	Trashëgimia kulturore	Popullsia dhe vendbanimet		Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsise/Fitimi i jetesës	
Gazsjellësi Maqedoni e Veriut/kufiri KOS drejt Prishtinës	+1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Ferizaj – Prizren	+1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Prizren – Gjakovë	+1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	-1	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Gjakovë – Pejë	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	0	-1	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Pejë – Istog	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	0	-1	+1	-1	+1	-1
Gas pipeline Istog – Skenderaj	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Prishtina 1 – Drenas	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	0	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Drenas – Skenderaj	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Skenderaj – Mitrovicë	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Mitrovicë – Vushtrri	+1	-1	-1	0	-1	0	0	0	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Krushe e Madhe – Rahovec	+1	-1	-1	0	-1	-1	0	0	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Ferizaj – Gjilan	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	0	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Prishtinë – Podujevë	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	-1	+1	-1	+1	-1

	Klima dhe ndryshimet klimatike		Gjeorreziqet	Ujërat	Dheu dhe bujqësia	Biodiversiteti	Zonat e mbrojtura	Peizazhi	Trashëgimia kulturore	Popullsia dhe vendbanimet		Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsise/Fitimi i jetesës	
Gazsjellësi SBV Hani i Elezit drejt Sharrcem	+1	-1	0	0	0	-1	0	-1	0	+1	-1	+1	-1
Gazsjellësi Prizren – kufiri SHQ/KOS	+1	-1	-1	-1	-1	-1	0	-1	-1	+1	-1	+1	-1

7.18 - Rrjeti potencial i shpërndarjes së gazit

Sistemet e shpërndarjes së gazit nëpër qytete dhe vendbanime të tjera zakonisht përbëhen nga këta komponentë (nëse shohim në drejtimin e rrjedhës së gazit):

- Stacion odorizues me linjën lidhëse nga SMRP
- Linja e shpërndarjes së presionit të lartë (PL)
- Rrjeti i gazit me presion të mesëm (PM)
- Rrjeti i gazit SMRR me presion të ulët (PU)
- Rrjeti i gazit me presion të ulët (PU)

Gama e lejuar e presionit punues të gazit në sistemin e shpërndarjes (që kufizohet me presionin punues minimal dhe maksimal) ku ndodh shpërndarja e gazit ndahet në tri klasë:

- Presion i ulët (deri në dhe përfshirë 0,1 bar),
- Presion i mesëm (0.1 bar deri në dhe përfshirë 5 bar) dhe
- Presion i lartë (më shumë se 5 bar)

Sistemi i shpërndarjes fillon me stacionin për reduktimin dhe matjen e presionit (SRMP), që normalisht është pronë e operatorit të sistemit të transmisionit (OST).

SRMP në pronësi të OST përgjithësisht nga dy dalje në sistemin e shpërndarjes së gazit: njëra ku presioni reduktohet në 5 bar (për furnizimin e rrjetit të gazit PM dhe një tjetër ku presioni reduktohet në 16 bar (për furnizimin e linjës së shpërndarjes për PL).

Stacioni odorizues (SO) zakonisht është në pronësi të shpërndarësit të gazit (SHPG) ndërtohet në vendndodhje të përshtatshme, shpeshherë pranë ndonjë stacioni të matjes dhe rregullimit (SMRR). Qëllimi i SO është aromëzimi i gazit, sepse gazi natyror nuk ka ngjyrë, aromë apo shije, ndaj i shtohet një aromëzues me kundërmim karakteristik, që të mundësojnë detektimin e pranisë së gazit përmes shqisës së të nuhaturit. Odorizimi i gazit bëhet në përputhje me rregulloren teknike të zbatueshme "Odorizimi i gazit".

Sistemi i furnizimit me gaz në PM dhe PU mundëson gazifikimin e plotë (gazi si karburant për ngrohje, ujë të nxehtë, gatim dhe freskim) të objekteve ekzistuese dhe të ardhshme, ndërsa linja e shpërndarjes së PL zakonisht përdoret për furnizimin me gaz të konsumatorëve të mëdhenj, kryesisht industrialë ose për të transportuar gazin në SMRR në pjesë të largëta të qytetit ose të fshatit.

Tubacionet e gazsjellësit e PM dhe PU bëhen nga tuba polietileni dhe testohen në përputhje me standardet e zbatueshme si EN 1555 Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me karburantë në gjendje të gaztë – Polietilen (PE) -- Part 2: tubat (EN 1555-2) Tubat dhe pajisjet standarde janë cilësia PE 100, ndërsa madhësitë dhe klasat e seksionit (SDR) janë në përputhje me kushtet e punës dhe të testimit.

Tubacionet e shpërndarjes së PL bëhen nga tuba HP çeliku të prodhuar dhe të testuar në përputhje me standardet e zbatueshme: EN 10208-2 Tuba çeliku për tubacionet për lëngje të ndezshme – Kushtet e dërgesës teknike – Pjesa 2: Tubat e klasës së kërkuar B (EN 10208-2). Cilësia dhe trashësia e pareteve është në përputhje me kushtet e punës dhe të testimit.

Përmasat finale të tubacioneve për shpërndarjen e gazit përcaktohen nga përllogaritjet hidraulike gjatë fazës paraprake apo të projektimit të hollësishëm.

Tubacionet për shpërndarjen e gazit kryesisht shtrihen në rrugë publike, paralelisht me infrastrukturën tjetër komunale.

Tubacionet e PM dhe PU zakonisht groposen me mbulesë minimale dheu prej 0.80 m, ndërsa tubacionet e gazit PL groposen me mbulesë dheu minimale 1.0 m. Gjerësia e kanalit të tubacionit zakonisht shkon nga 0.40 në 0.70 m. Tubat e polietilenit për shpërndarjen e gazit shtrihen mbi shtrat rëre, përafërsisht 15 cm të trashë.

Pas shtrimit dhe testimit të linjës, kanali mbushet me material ranor të imët deri në një nivel të caktuar mbi tubacion. Përmbi rërë, mbushja bëhet me shtresa deri në nënbazë të sipërfaqes. Sipërfaqet si trotuari, shtigjet anësore dhe zonat e gjelbëruara më pas restaurohen në gjendjen fillestare.

Distanca e tubacionit nga ndërtesat, strukturat e tjera mbitokësore dhe instalimet nëntokësore paralele të, si dhe kryqëzimet e instalimeve të tjera komunale është në përputhje me rregullat dhe standadet për instalimin e tubacioneve, si rregullat teknike për tubacionet e çelikut për presionin maksimal punues mbi 16 bar, EN 1594 Infrastruktura e gazit – Tubacione për presionin maksimal funksionues mbi 16 bar – Kërkesat funksionale (EN 1594), Rregullat teknike: Tubacione të çelikut për presionin maksimal funksionues mbi 5 bar – Mirëmbajtja dhe EN 12007-1 Infrastruktura e gazit – Tubacione për presionin maksimal funksionues deri në dhe përfshirë 16 bar – Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme funksionale.

Lkryqëzimi i tubacioneve me hekurudhat dhe rrugët kryesore zakonisht bëhet me metoda të shpimit në thellësinë e kërkuar, ndërsa zgjidhjet tipike teknike për kryqëzimin e tubacionit me rrugë ujore përfshin metodën e hapjes së kanalit, pra, groposjen e tubacionit në thellësinë e duhur poshtë shtratit të rrugës ujore, me mbrojtëse nga betoni.

Tubat e shpërndarjes pothuajse ekskluzvisht instalohen nën dhe, gjë që rrit edhe më shumë nivelin e sigurisë së funksionimit.

Për të optimizuar shtrirjen e zhvillimit të sistemit të gazit, është bërë vlerësimi teknik i rrjeteve të shpërndarjes së gazit në vendbanime të përshtatshme.

Procesi i identifikimit të zonave potenciale për shpërndarjen e gazit natyror kanë marrë në shqyrtim zona me popullsi më të dendur në pjesë të komunave pasi zhvillimi i rrjetit të gazit përgjithësisht nuk është me efektivitet të kostos në fshatra më të largët, më pak të populluar. Për pjesët e përzgjedhura të komunës, u bë supozimi i mbulesës prej 100%[28], pra u ofrua lidhja me rrjetin për secilën ekonomi familjare apo konsumatorë të tjerë (shërbime, industri), duke e vendosur rrjetin në secilën rrugë drejt secilit konsumator potencial. Sistemet e shpërndarjes u zhvilluan me dorë dujke përdorur softuerin Google Earth, Open Street View, hartat e duhura topografike dhe dokumenta të tjerë në dispozicion. Për këto rrjete të planifikuara të shpërndarjes, u përllogarit gjatësia totale e rrjetit për komunë (TabELA 49). Secili rrjet i shpërndarjes përbëhet nga elementë të ndryshëm, përfshirë tuba të diametrave të ndryshëm në varësi të sasive dhe presioneve të përllogaritur.

Rrjetet e shpërndarjes që janë shqyrtuar janë paraqitur në ZHG për këto vendbanime të radhës: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Prizren, Ferziaj, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë dhe Mitr. e Veriut, Vushtrri, Suharekë, Gllogoc (Drenas), Lipjan, Rahovec, Malishevë, Skenderaj, Viti, Deçan, Klinë, Kamenicë, Istog, Dragash, Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit dhe Mamushë.

Për shkak të shtrirjes së rrjetit të shpërndarjes së gazit në rrugë publike brenda vendbanimeve dhe për shkak të natyrës nëntokësore të projektit, ndikimi i përgjithshëm mbi mjedisin është i papërfillshëm.

---

[28] Në realitet, mbulesa e vendbanimeve rrallëherë është 100%, mirëpo për shkak të rritjes së pritshme të pjesëve urbane të vendbanimeve (ku parashihet gazifikimi), rrjeti i gazit duhet të shtrihet përtej vendbanimeve aktuale urbane, kështu, vlerësimi I 100% të madhësisë së sotme të vendbanimeve urbane është i arsyeshëm.

TABELA 49 – GJATËSIA E TË GJITHË RRJETIT TË SHPËRNDARJES TË ZHVILLUAR FILLIMISHT

Komuna	Qarku	Gjatësia e rrjetit të shpërndarjes (km)
Prishtina	Prishtina	942
Fushë Kosovë	Prishtina	
Obiliq	Prishtina	
Prizren	Prizren	302
Ferizaj	Ferizaj	286
Pejë	Peja	157
Gjakovë	Gjakova	140
Gjilan	Gjilan	247
Podujevë	Prishtina	111
Mitrovicë	Mitrovica	258
Mitr. e Veriut	Mitrovica	52
Vushtrri	Mitrovica	113
Suharekë	Prizren	32
Gllogoc (Drenas)	Prishtina	46
Lipjan	Prishtina	104
Rahovec	Gjakova	66
Malishevë	Prizren	30
Skenderaj	Mitrovica	33
Viti	Gjilan	101
Deçan	Gjakova	35
Istog	Peja	29
Klinë	Peja	43
Kamenicë	Gjilan	82
Dragash	Prizren	21
Kaçanik	Ferizaj	32
Shtime	Ferizaj	50
Hani i Elezit	Ferizaj	21
Mamushë	Prizren	16
Totali		**3349**

8 - PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME TË KONSIDERUESHME NDËRKUFITARE MBI MJEDISIN

Në përputhje me praktikat më të mira për zhvillimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës lineare që përshkojnë disa vende, vëmendje i kushtohet ndikimeve të mundshme ndërkufitare të projektit. Konventa ESPOO për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar është transpozuar në legjislacionin e Kosovës. Vendi tjetër i përfshirë është Maqedonia e Veriut, e cila është gjithashtu nënshkruese e Konventës ESPOO. Për më tepër, standardet e institucioneve financiare ndërkombëtare kërkojnë që tema të trajtohet në procesin e vlerësimit strategjik të ndikimit mjedisor dhe social (VSM) për projektin e përgjithshëm.

Bazuar në lokacionet e projektit në Kosovë, kompleksitetin e projektit dhe ndikimet e identifikuara, është konstatuar se ndikimet ndërkufitare të gazsjellësit Prizren – kufiri SHQ/KOS mund të ndikojnë në Shqipëri, dhe ndikimet ndërkufitare të interkoneksionit Maqedoni të Veriut-Kosovë mund të ndikojnë në Maqedoninë e Veriut.

8.1 - Interkoneksioni Maqedoni e Veriut-Kosovë

Korridori i gazsjellësit të vjetër ekzistues lidh Shkupin dhe Prishtinën dhe konsulenti ka bërë përpjekje që korridori të shfrytëzohet sa më shumë. Është veçanërisht e rëndësishme që të përdoret pika e vjetër ekzistuese e lidhjes mes dy vendeve, e cila shkakton ndikim sa më të vogël në mjedis në këtë zonë kufitare.

Ndikimet e gazsjellësit në ndryshimet klimatike janë kryesisht të papërfillshme për shkak të sasisë së vogël të emisioneve. Kjo është e vërtetë për zonën më të vogël rreth gazsjellësit, por edhe në një shkallë më të madhe në territorin e Kosovës dhe vendit fqinj Maqedoninë e Veriut.

Ndikimi në cilësinë e ajrit të ndërtimit është i kufizuar në një zonë të vogël rreth kantierit të ndërtimit dhe për këtë arsye nuk pritet të ketë jë ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar. Nuk priten ndikime negative ndërkufitare gjatë funksionimit normal dhe në Maqedoninë e Veriut në zonat më afër gazsjellësit mund të shihet ndonjë ndikim i vogël pozitiv për shkak të ndryshimit në një burim më të pastër karburanti.

Nuk pritet asnjë ndikim ndërkufitar në pylltari dhe gjueti në pjesën fillestare të gazsjellësit, pikënisja e të cilit ndodhet në kufirin e Maqedonisë së Veriut, pasi karakteristikat dhe shtrirja e ndërhyrjes janë të tilla që nuk pritet asnjë ndikim mbi ajrin apo ujin apo çdo mjet tjetër jashtë kufijve të vendit. I vetmi ndikim ndërkufitar i pritshëm që mund të ndodhë në këtë pjesë të rrugës është përhapja ndërkombëtare e zjarreve pyjore. Ky ndikim do të reduktohet në një minimum të pranueshëm duke respektuar të gjitha rregulloret, masat dhe praktikat e mira për parandalimin e zjarreve në pyje.

Duke qenë se ndërhyrja e planifikuar ka karakterin e ndikimeve të lokalizuara në veçoritë gjeomorfologjike, vlerësohet se do të mungojnë karakteristika të rëndësishme ndërkufitare. Vendndodhja e gazsjellësit të planifikuar në kufirin shtetëror është në një kodër. Ndikimi është përcaktuar si i vogël dhe nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në territorin e Maqedonisë së Veriut.

Zbatimi i operacionit të planifikuar nuk do të ndryshojë elementet e peizazhit dhe mënyrën e përdorimit të peizazhit në territorin e Maqedonisë së Veriut. Ndryshime të vogla vizuale do të ketë në peizazhin në zonën e Kosovës, e cila është në afërsi të kufirit shtetëror dhe në vetë kufirin. Një ndryshim i tillë do të jetë dobët i dukshëm nga territori i Maqedonisë së Veriut. Kjo formë ndikimi mund të konsiderohet e vogël në të papërfillshme.

Duke qenë se ndërhyrja e planifikuar ka karakterin e ndikimeve të lokalizuara në lidhje me trashëgiminë kulturore, vlerësohet se nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm ndërkufitar. Sa i përket vendndodhjes së gazsjellësit të planifikuar në kufirin shtetëror, konsiderohet se nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në vendet kulturore nga Maqedonia e Veriut që janë më afër vendndodhjes së gazsjellësit.

Gazsjellësi i transmisionit nga Shkupi (Maqedonia e Veriut) në Prishtinë (Kosovë) do të krijonte një linjë të furnizimit me gaz për Kosovën. Kjo nga ana tjetër do të mundësonte fillimin e gazifikimit të Kosovës. Nga

perspektiva e Maqedonisë së Veriut krijimi i kësaj linje do të rriste vëllimet e bartjes së gazit përmes sistemit të transmisionit të gazit të Maqedonisë së Veriut, me çka do të përfitonte potencialisht tarifat e transmisionit, duke rritur më tej konkurrencën e gazit natyror. Përveç kësaj, gazsjellësi nga Shkupi në Prishtinë mund të lehtësojë gazifikimin e zonës përgjatë linjës së vet.

Ndikim i kufizuar ndërkufitar në popullatë mund të ndodhë në afërsi të kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën në rast aksidentesh. Ndikimi negativ mund të ndodhë në fazën e ndërtimit për shkak të të gjitha situatave aksidentale që mund të lindin në kantierin e ndërtimit dhe për shkak të shpërthimeve ose rrjedhjeve masive të gazit në fazën e funksionimit. Ndikime të kufizuara ndërkufitare mund të ndodhin në rast aksidentesh ose shpërthimesh, shfaqja e të cilave kufizohet nga masat e duhura të projektimit. Gjatë funksionimit të gazsjellësit do të bëhen aktivitete të rregullta mirëmbajtjeje.

8.2 - Gazsjellësi Prizren – kufiri SHQ/KOS

Linja e krahasueshme e këtij seksioni është planifikuar në kuadër të studimit të parafizibilitetit të interkoneksionit të gazit ALKOGAP. Projekti i Gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP) synon të ndërlidhë sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmisionit të gazit të Republikës së Shqipërisë (përfshirë projektin TAP) me sistemin e ardhshëm të projektuar të transmisionit të gazit të Republikës së Kosovës, dhe ndërlidhësit e transmisionit që janë pjesë të degës lindore të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë (ECGR). ALKOGAP synon të krijojë një linjë të re furnizimi me gaz natyror nga Lindja e Mesme dhe Rajoni i Kaspikut të transportuar nga Gazsjellësi Trans Adriatik, në veri-lindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Serbisë. Megjithatë, projekti ALKOGAP do të planifikohet si gazsjellës dy-drejtimësh, kështu që drejtimi i mundshëm i furnizimit mund të jetë gjithashtu veri-jug, nga ECGR, ose burime të tjera. Ndërtimi i këtij gazsjellësi do të mundësonte gazifikimin e Shqipërisë dhe Kosovës dhe do të siguronte një furnizim të larmishëm dhe të qëndrueshëm me gaz natyror.

Ndikimet e gazsjellësit në ndryshimet klimatike janë kryesisht të papërfillshme për shkak të sasisë së vogël të emisioneve. Kjo është e vërtetë për zonën më të vogël rreth gazsjellësit, por edhe në një shkallë më të madhe në territorin e Kosovës dhe Shqipërisë fqinje.

Ndikimi në cilësinë e ajrit të ndërtimit është i kufizuar në një zonë të vogël rreth kantierit të ndërtimit dhe për këtë arsye nuk pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm ndërkufitar. Nuk priten ndikime negative ndërkufitare gjatë funksionimit normal dhe në Shqipëri në zonat më afër gazsjellësit mund të shihet një ndikim i vogël pozitiv për shkak të ndryshimit në një burim më të pastër karburanti.

Nuk pritet asnjë ndikim ndërkufitar në pylltari dhe gjueti në pjesën fillestare të gazsjellësit, pikënisja e të cilit ndodhet në kufirin shqiptar, pasi karakteristikat dhe shtrirja e ndërhyrjes janë të tilla që nuk pritet asnjë ndikim në ujë ose ajër apo mjet tjetër jashtë kufijve të vendit. I vetmi ndikim ndërkufitar i pritshëm që mund të ndodhë në këtë pjesë të linjës është përhapja ndërkombëtare e zjarreve në pyje. Ky ndikim do të reduktohet në një minimum të pranueshëm duke respektuar të gjitha rregulloret, masat dhe praktikat e mira për parandalimin e zjarreve në pyje.

Duke qenë se ndërhyrja e planifikuar ka karakterin e ndikimeve të lokalizuara në veçoritë gjeomorfologjike, vlerësohet se do të mungojnë karakteristika të rëndësishme ndërkufitare. Vendndodhja e linjës së planifikuar në kufirin shtetëror është në një kodër. Ndikimi është përcaktuar si i vogël dhe nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në territorin e Shqipërisë.

Zbatimi i operacionit të planifikuar nuk do të ndryshojë elementët e peizazhit dhe mënyrën e përdorimit të peizazhit në territorin e Shqipërisë. Në peizazhin në zonën e Kosovës do të ketë ndryshime të vogla vizuale, pasi është në afërsi të kufirit shtetëror dhe me vetë kufirin. Këto ndryshime do të jetë pak të dukshme nga territori i Shqipërisë. Kjo formë ndikimi mund të konsiderohet e vogël në të papërfillshme.

Duke qenë se ndërhyrja e planifikuar ka karakterin e ndikimeve të lokalizuara në lidhje me trashëgiminë kulturore, vlerësohet se nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm ndërkufitar. Për sa i përket vendndodhjes së

gazsjellësit të planifikuar në kufirin shtetëror, konsiderohet se nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në vendet kulturore në Shqipëri që janë më afër vendndodhjes së gazsjellësit.

ALKOGAP do të krijonte një linjë furnizimi me gaz për Kosovën. Kjo nga ana tjetër do të mundësonte fillimin e gazifikimit të Kosovës. Nga këndvështrimi shqiptar, krijimi i kësaj linje do të rriste vëllimet e transmisionit të gazit përmes sistemit shqiptar të transmisionit të gazit, duke përfituar potencialisht tarifat e transmisionit, duke rritur më tej konkurrencën e gazit natyror. Gjithashtu, gazsjellësi nga Shqipëria në Kosovë mund të lehtësojë gazifikimin e zonës përgjatë linjës së vet.

Në aërsi të kufirit me Shqipërinë dhe Kosovën mund të ketë ndikim të kufizuar ndërkufitar në popullatë në rast aksidentesh. Ndikimi negativ mund të ndodhë në fazën e ndërtimit për shkak të të gjitha situatave aksidentale që mund të lindin në kantierin e ndërtimit dhe për shkak të shpërthimeve ose rrjedhjeve masive të gazit në fazën e funksionimit. Ndikime të kufizuara ndërkufitare mund të ndodhin në rast aksidentesh ose shpërthimesh, shfaqja e të cilave kufizohet nga masat e duhura të projektimit. Gjatë funksionimit të gazsjellësit do të bëhen aktivitete të rregullta mirëmbajtjeje.

9 - PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE KUMULATIVE

9.1.1 - Cilësia e ajrit

Gjatë ndërtimit priten disa efekte negative lokale në cilësinë e ajrit. Duke qenë se ky ndikim do të jetë shumë i lokalizuar dhe relativisht i shkurtër, ai vlerësohet si i papërfillshëm. Meqë lokacioni i punimeve të ndërtimit lëviz përgjatë linjës së projektit, ndikimi gjithashtu do të lëvizë, kështu që ndikimi kumulativ vlerësohet gjithashtu si i papërfillshëm.

Ndryshimi i lëndëve djegëse fosile dhe biomasës aktuale me gaz natyror si burim energjie në familje dhe industri mund të ketë një ndikim pozitiv kumulativ në cilësinë e ajrit lokal, veçanërisht në zonat më të dendura të populluara ose zonat me emisione të larta industriale.

9.1.2 - Klima dhe ndryshimet klimatike

Efektet negative të projektit në ndryshimet klimatike gjatë ndërtimit vlerësohen të jenë të papërfillshme dhe ndikimi do të ndalet me përfundimin e ndërtimit. Gjatë funksionimit normal priten ende disa emisione nga objektet mbitokësore dhe emisionet e liruara. Ky ndikim vlerësohet si i papërfillshëm për çdo seksion gazsjellësi, ndërsa ndikimi kumulativ mund të jetë i matshëm, por ende pritet të jetë relativisht i vogël. Për më tepër, ky ndikim mund të reduktohet duke ndjekur masat e propozuara zbutëse.

Një ndikim domethënës pozitiv i projektit pritet nga shndërrimi nga lëndët djegëse fosile dhe biomasa në gaz natyror si burim energjie pasi gazi natyror ka emisione dukshëm më të ulëta të gazeve serrë. Kumulativisht ky ndikim është dukshëm më i madh se ndikimi negativ relativisht i vogël i funksionimit normal të gazsjellësit. Ndikimi kumulativ përllogaritet në seksionin **Error! Reference source not found.**Klima dhe ndryshimet klimatike.

9.1.3 - Gjeorreziqet

Pritet ndikim negativ kumulativ aty ku kryqëzohen zona të shumta të gjeorreziqeve të ndryshme. Zonat e përmbytjeve dhe tërmetet mund të aktivizojnë zonat e mundshme për rrëshqitje të dheut.

9.1.4 - Ujërat

Ndikimi negativ kumulativ pritet në zonën ku gazsjellësi kalon shumë herë të njëjtin lumë/përrua. Ndërtimi i gazsjellësit përgjatë lumenjve/përrenjve shkakton presion hidrologjik në trupin ujor dhe mund të ndryshojë përkohësisht rrjedhën dhe cilësinë e lumit/përroit, gjë që mund të ketë ndikim negativ në biodiversitetin që varet nga i njëjti lumë/përrua.

9.1.5 - Dheu dhe bujqësia

Ndikimi kumulativ pritet të jetë i mundur gjatë punimeve të ndërtimit në formën e gërmimit të materialit të tokës, prishjes së strukturës dhe ngjeshjes së tokës dhe për shkak të heqjes së shtresës së humusit dhe kulturave ekzistuese, e cila është shumë lokale, lineare dhe e përkohshme. Gjatë funksionimit të gazsjellësit nuk do të ketë ndikim në tokë dhe tokë bujqësore, pasi i gjithë prodhimi, rrënjët e të cilit nuk kalojnë thellësinë 1 m mund të vazhdojë.

9.1.6 - Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura

Ndikimi negativ kumulativ pritet gjatë ndërtimit në zonat ku gazsjellësi kalon pranë ose në zona të mbrojtura dhe zona të pasura me biodiversitet. Biodiversiteti mund të ndikohet nga shkatërrimi ose transformimi i habitateve aktuale dhe të ndjeshme (p.sh., kalimi i shumëfishtë i lumenjve dhe përrenjve duke ndikuar në rrjedhën e lumenjve, kalimi nëpër zona pyjore të cilat mund të krijojnë skaje të reja pyjore dhe të shkaktojnë fragmentim dhe erozion), emisionet e zhurmës nga puna ndërtimore, materialet e rrezikshme dhe pluhuri që përhapet nga kantieret dhe futja e mundshme e specieve të huaja.

9.1.7 - Peizazhi

Gjatë ndërtimit, është e mundur të ketë ndikim kumulativ në strukturën e peizazhit dhe një përvojë vizuale e zonës së punës me objektet e infrastrukturës ekzistuese dhe të planifikuara të linjës. Ndikimi është i mundur në banesat e përhershme aty pranë.

Gjatë funksionimit, ndikimi kumulativ vizual i objekteve mbitokësore është i mundur në rast se ato ndodhen pranë objekteve industriale dhe tregtare të planifikuara ose ekzistuese. Ndikimi është i mundur në banesat e përhershme aty pranë.

9.1.8 - Trashëgimia kulturore

Ndikimet kumulative janë të mundshme në rastin e ndërtimit të objekteve mbitokësore të gazsjellësit të planifikuar, që ndodhen pranë elementëve të çmueshëm të trashëgimisë arkitekturore ose të ndërtimit. Vetë ndërtimi i objektit mbitokësor nuk do të shkaktojë një ndikim kumulativ, por nëse ka disa ndërhyrje të tjera të spikatura infrastrukturore në afërsi, mund të ketë një ndryshim më të fortë në kontekstin kulturor të zonës dhe rrjedhimisht ndikim në kontekstin kulturor të pronës kulturore.

9.1.9 - Shëndeti i njeriut

Ndikimet kumulative janë të mundshme vetëm në rastin e ndërtimit. Fluksi i fuqisë punëtore (migrimi në zonën e kantierit) për punimet e ndërtimit mund të çojë në një sërë rreziqesh dhe ndikimesh negative sociale dhe mjedisore. Ndërsa shumë nga këto ndikime mund të kenë qenë tashmë të pranishme ose mund të ndodhin pavarësisht nga fluksi i fuqisë punëtore, ato mund të intensifikohen potencialisht nga punimet e ndërtimit.

- Rritja e rrezikut të sëmundjeve ngjitëse dhe ngarkesa për shërbimet shëndetësore lokale: Fluksi i njerëzve mund të sjellë sëmundje ngjitëse në zonën e projektit, duke përfshirë sëmundjet seksualisht të transmetueshme (STD), ose punëtorët që vijnë mund të ekspozohen ndaj sëmundjeve ndaj të cilave kanë rezistencë të ulët. Kjo mund të rezultojë në një barrë shtesë për burimet shëndetësore lokale. Punëtorët me shqetësime shëndetësore në lidhje me abuzimin e substancave, çështjet mendore ose sëmundjet seksualisht të transmetueshme mund të mos dëshirojnë të vizitojnë objektin mjekësor të projektit dhe në vend të kësaj të shkojnë në mënyrë anonime te ofruesit lokalë mjekësorë, duke ngarkuar mëtej burimet lokale. Objektet lokale shëndetësore dhe të shpëtimit mund të jenë gjithashtu të mbingarkuar dhe/ose të papajisura keq për të adresuar aksidentet e mundshme që mund të ndodhin në një kantier të madh ndërtimi.

Problemet të zakonshme mund të jenë mosmarrëveshjet me banorët vendas, ndoshta prania e punëtorëve në bare dhe prania e prostitutave, duke çuar në rrezik për zënka, aksidente, rritje të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme etj.

9.1.10 - Infrastruktura dhe shërbimet publike

Në fazën e ndërtimit, ZHG mund të ketë ndikime kumulative mbi kantieret e tjera kryesore të ndërtimit nëse ato përkojnë. Kjo pengon përcaktimin e saktë të ndikimeve kumulative meqënëse nuk është caktuar afat i zhvillimit të ZHG dhe as nuk është e mundur të dihet se kur do të fillojnë zhvillimet e tjera.

Këto efekte negative mund të zbuten plotësisht duke marrë parasysh, gjatë fazës së projektimit të detajuar kryqëzimin e ZHG me infrastrukturën dhe projektet e tjera që duhet të marrë parasysh lartësitë dhe distancat e sigurisë të përshkruara në standardet teknike ekzistuese malazeze për ndërtimin e linjave të transmetimit.

Ndikimet kumulative në rajonin e Projektit mund të rrjedhin nga efektet e kombinuara të ZHG me aktivitete të tjera në vazhdim aktualisht ose në të ardhmen e arsyeshme të parashikueshme në zonën e studimit. Projekte të tjera të tilla janë identifikuar bazuar në një studim të dokumentacionit. Ndikimet mjedisore të ZHG lidhen kryesisht me fazën e ndërtimit, ndërkohë që funksionimi i rregullt rezulton me ndikime të një rëndësie të vogël.

Përveç kësaj, faza e projektimit të projektit të detajuar, duhet të marrë në konsideratë të gjitha projektet e planifikuara të infrastrukturës brenda zonës së projektit të gazsjellësit. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet

koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve të mundshëm, duke përfshirë qeverinë e njësisë, qeveritë e qarqeve dhe rretheve, autoritetet lokale (bashkitë) etj.

9.1.11 - Aksidentet

Ndikimi kryesor mjedisor ndodh gjatë aksidenteve (zjarri, shpërthimi, helmimi), dhe pas aksidenteve nuk pritet ndotje e mëtejshme e mjedisit. Prandaj, ndikimet e mundshme janë të lidhura kryesisht me rrezikimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe shkatërrimin e të mirave materiale, ndërsa pasojat mjedisore janë të një rëndësie të vogël.

Ndikimet e rëndësishme kumulative janë të mundshme vetëm në rast të të ashtuquajturit efekt domino. Mundësia e aksidentit është jashtëzakonisht e ulët.

9.1.12 - Mbeturinat

Gazsjellësit që janë subjekt i PBB mbulojnë një sipërfaqe të madhe të Kosovës dhe mundësia e ndikimeve kumulative me projekte të tjera nuk mund të shmanget. Ndikimet kumulative mjedisore janë të mundshme në rast të mbivendosjes së afateve kohore të ndërtimit të gazsjellësve të parashikuar/objekteve shoqëruese dhe projekteve të tjera të infrastrukturës së linjës (rrugë, hekurudha). Duke qenë se ka mungesë të dukshme të deponive sanitare dhe përgjithësisht mungesë të objekteve për trajtimin e mbeturinave në nivel kombëtar, duhen bërë përpjekje të konsiderueshme me synimin për t'i menaxhuar siç duhet ndikimet negative nga mbeturinat e prodhuara dhe për menaxhimin e tyre gjatë fazës së ndërtimit. Këto efekte negative mund të zbuten duke i marrë parasysh gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe duke zbatuar masa për minimizimin e mbeturinave, parimet e riciklimit të mbetjeve dhe koordinimin ndërmjet të gjithë palëve të interesit të mundshëm, përfshirë organet qeveritare dhe autoritetet lokale.

Gjatë fazës së funksionimit të gazsjellësit, mbeturinat e pritshme të prodhuara nga gazsjellësit dhe objektet shoqëruese janë të papërfillshme dhe pa potencial për ndikime kumulative me projekte të tjera në rajon.

10 - MASAT ZBUTËSE

10.1 - Masat e parapara për të parandaluar, reduktuar dhe eliminuar ndikimet tek shëndeti i njeriut dhe mjedisi

10.1.1 - Masat e përgjithshme

Tema	Masa zbutëse
Klima dhe ndryshimet klimatike	Gjatë zhvillimit të projektit, përgatitni dokumentacionin e projektit duke marrë parasysh çështjet e ndryshimeve klimatike, zbutjen dhe arritjen e neutralitetit klimatik, si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Gjeorreziqet	Në fazën e përgatitjes, duhet të shqyrtohet planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit: punimet e ndërtimit në zonat e përmbytura duhet të kryhen gjatë sezonit të thatë/me prurje të ulët. Duhet të zhvillohet hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Ujërat	Gjatë fazës përgatitore, planifikimi për korridoret e detajuar të gazsjellësit duhet të marrë parasysh: • Punimet e ndërtimit në rrjedhat ujore duhet të bëhen gjatë muajve të verës (stina me gjasa për prurje të ulëta). • Pas ndërtimit, shtretërit e lumenjve duhet të restaurohen në kushtet e mëparshme. Duhet të përdoret Plani për Kryqëzimin e Ujit që tregon metodat e ndërtimit dhe duhet të përgatiten masat mbrojtëse për zbatim. Plani i Erozionit dhe Kontrollit të Sedimenteve tregon se si rifuten në përdorim brigjet e trupave ujorë dhe si të mbrohen ato nga erozione, si shpatet pranë trupave ujore stabilizohen për të parandaluar erozionin nga derdhjet e shpateve në trupat ujorë.
Dheu dhe bujqësia	Në fazën e përgatitjes, planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit duhet të marrë parasysh gjelbërimin e shpateve dhe mbjelljen e përzierjeve të barit dhe shkurreve për terrene të pjerrëta. Duhet të përgatitet dhe zbatohet plani i restaurimit dhe rehabilitimit. Duhet të përgatitet dhe zbatohet plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentit. Gjatë fazës së planifikimit më të detajuar, rekomandohet të shmanget tokë e punueshme e çmueshme dhe toka e punueshme gjatë përzgjedhjes së vendit për vendosjen e rrugëve hyrëse dhe objekteve mbitokësore (për të minimizuar zhvendosjen ekonomike). Pronarët dhe bartësit e të drejtave që kanë kultura të përhershme (kultura me rrënjë që rriten më thellë se 1 m ose kultura që kanë nevojë për trajtim të tokës më thellë se 0,5) në zonën 5 + 5 m nga gazsjellësi duhet të kompensohen për sipërfaqen e dhënë me qira.
Biodiversiteti	Gjatë fazës përgatitore, planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit duhet të marrë parasysh: • shmangien e zonave të ndjeshme përgjatë linjës (pjerrësi të mprehta, zona të mbuluara me pyje, habitate ujore dhe ligatina). • në të gjitha vendet ku mbulesa bimore do të hiqet ose dëmtohet, përzierjet e barishteve dhe bishtajoreve duhet të mbillen menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe

Tema	Masa zbutëse
	rivendosjes së servitutit për të parandaluar erozionin e tokës, futjen dhe përhapjen e specieve bimore pushtuese. • Në zonat pyjore, pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, duhet të mbillen specie adekuate (në lloje dhe sasi) të pemëve dhe shkurreve brenda korridorit të punimeve (duke mos përfshirë korridorin e sigurisë 5+5 m) për të zbutur efektet e fragmentimit dhe për të parandaluar krijimin e specieve bimore pushtuese. • Bimësia bregore pranë lumit dhe habitatet e përrenjve të përhershëm (nëse ka) duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve të ndërtimit. • Transporti në rrjedhën e poshtme të sedimentit duhet të minimizohet gjatë punimeve për kryqëzimet e hapura gjatë kushteve me prurje të ulët. Nëse gjatë ndërtimit janë gjetur zgavra ose shpella brenda terrenit karstik, të gjitha punimet duhet të ndërpriten përkohësisht. Autoritetet ligjore duhet të informohen për këto gjetje. Punimet e mëtejshme ndërtimore duhet të vazhdojnë në përputhje me udhëzimet e autoriteteve ligjore. Bimësia bregore pranë lumit dhe habitateve të përrenjve të përhershëm (nëse ka) duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve të ndërtimit. Transporti në rrjedhën e poshtme të sedimentit duhet të minimizohet gjatë kryerjes së kryqëzimeve të hapura gjatë kushteve të rrjedhjes së ulët.
Zonat e mbrojtura	Gjatë fazës përgatitore, planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit duhet të marrë parasysh që të gjitha punimet e ndërtimit brenda zonës më të gjerë të ligatinave të mbrojtura Ligatina e Hencit duhet të kryhen jashtë periudhës së folezimit të shumicës së shpendëve të ligatinave që janë regjistruar në zonën më të zgjeruar të projektit.
Peizazhi	Gjatë fazës së projektimit, është e nevojshme të sigurohet integrimi sa më i mirë i gazsjellesit në peizazh.
Trashëgimia kulturore	Në fazat e mëtejshme të projektimit të Projektit, duhet të merren parasysh sa vijon: • Pjesët mbitokësore të gazsjellësit duhet t'u përshtaten kushteve kulturore lokale nga forma dhe materiali. • Rruga dhe pjesët mbitokësore të pamjaftueshme vizualisht duhet të mbulohen me bimë autoktone. • Duhet të shfrytëzohen burimet e trashëgimisë kulturore dhe të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të shmangur vendet/objektet e njohura të trashëgimisë kulturore gjatë përgatitjes së projektimit Burimet e trashëgimisë kulturore duhet të merren parasysh dhe të përfshihen në fazat e mëtejshme të projektimit të projektit dhe duhet të ndërmerren të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të shmangur vendet/objektet e njohura të trashëgimisë kulturore gjatë përgatitjes së projektimit. Nëse gjurma e gazsjellësit kalon pranë (deri në 200 m) elementëve të trashëgimisë arkitekturore, zonave kulturore dhe zonave me vlerë kulturore, parqeve kombëtare dhe zonave nën mbrojtjen e UNESCO-s dhe zonave të tyre tampon, pas kryerjes së punimeve, është e nevojshme që zonat të riparohen me materiale identike dhe për t'i kthyer ato në gjendjen fillestare.

Tema	Masa zbutëse
	Në rast të gjetjeve të rastësishme, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në kantieret e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Popullsia dhe vendbanimet	Planifikimi i gazsjellësit të transmisionit duhet të bazohet në shfrytëzimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, nëse është e mundur, në korridoret ekzistuese të përbashkëta të infrastrukturës, pra në korridoret e reja kur kushtet teknike, ekonomike dhe mjedisore e lejojnë këtë, me zbatimin e nevojshëm të masave mbrojtës. Në fazat e mëtejshme të projektimit: • Duhen shmangur zonat me popullsi të dendur. • Nëse linjat e gazsjellësit të transmisionit kalojnë nëpër zonën e ndërtimit të vendbanimit ose nga një distancë prej më pak se 30 m nga ngrehinat e ndërtuara (banesore), gazsjellësi duhet të ketë parete më të trasha, të instalohet më thellë dhe duhet të mbrohet me pllaka betonarmeje, në mënyrë që të përmbushet kërkesat për siguri shtesë. • Kryerja e punëve ndërtimore në pajtueshmëri me procedurat dhe afatet e ndërtimit dhe me praktikat e mira të menaxhimit të kantierit të ndërtimit. Duhet të zhvillohet Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit që vë theksin tek njerëzit që preken, tek grupet në nevojë dhe ata që përjetojnë zhvendosje ekonomike. Konsultimet me personat e prekur, veçanërisht grupet në nevojë të identifikuara, ku të gjitha informacionet për ndikimet e mundshme dhe masat zbutëse mund të prezantohen qartë dhe thjesht, së bashku me përfitimet e përgjithshme nga projekti duhet të mbahen gjatë të gjithë fazës së projektit. Duhet të ofrohen informata për të drejtat e kompensimit që do të zbatohen, si dhe mundësia e paraqitjes së ankesës. Të përdoren metodat më të përshtatshme të konsultimit - takimet publike, takimet e grupeve të fokusit, broshura e projektit, shenjat rrugore, faqja e internetit të projektit. Do të mbahen fushata informuese me komunitetet përgjatë linjës për të siguruar që nuk planifikohen apo ndërtohen ndërtesa të tjera brenda zonës së sigurisë 30+30 m dhe se kufizimet për zonën prioritare të sigurisë do të përcillen. Kompensimi për pronarët ose bartësit e të drejtave të tokës dhe aseteve të prekura kanë të drejtën e kompensimit për kufizimet e vendosura në zonat e sigurisë.
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë/Fitimi i jetesës	Duhet të maksimizohet punësimi lokal dhe prokurimi i mallrave nga furnitorët vendas. Të gjitha vendet e mundshme të punësimit dhe mënyrat për të aplikuar duhet të komunikohen qartë dhe informacioni duhet të jepet jo vetëm gjatë prezantimeve dhe konsultimeve, por edhe nëpërmjet fletëpalosjeve të projektit, faqes së internetit të projektit dhe informacionet duhet të jenë gjithmonë të disponueshme brenda çdo komune që përshkohet nga gazsjellësi.

Tema	Masa zbutëse
	Duhet të zbatohet një program me faza për ndërtimin e kapaciteteve që do t'u mundësojë kompanive vendore të arrijnë kualifikimet dhe potencialisht certifikimin me standardet dhe kërkesat përkatëse shumë përpara procesit të tenderimit. Si pjesë e procesit të tenderimit, kontraktorëve duhet t'u kërkohet të zhvillojnë një strategji blerjeje që përcakton se si do të optimizohet blerja lokale e mallrave dhe shërbimeve. Të gjitha vendet e lira duhet të reklamohen nga autoritetet lokale në mënyra që janë të qasshme për komunitetet lokale. Duhet të jepet informacion i qartë mbi numrin e vendeve dhe kërkesat për shkathtësi për mundësi punësimi. Duhen mbajtur konsultime dhe të jepet informacion mbi të drejtat e kompensimit që do të zbatohen në kuadër të Projektit, si dhe për mundësinë për të paraqitur ankesa. Duhet të mbahen takime në fokus grupe me pronarët e tokave bujqësore dhe pyjore, bartësit e të drejtave dhe punëtorët në bujqësi dhe pylltari në zonën e projektit që më së shumti ndikohen nga ndërtimi i gazsjellësit. Gjatë këtyre takimeve, do të jepen të gjitha informacionet mbi projektin, duke përfshirë të drejtat e kompensimit dhe do të prezantohen ndikimet dhe përfitimet e mundshme, si dhe informacioni se si të dorëzohet një ankesë. Duhet të ofrohet ndihmë juridike. Duhet të zhvillohet dhe të zbatohet plani i restaurimit të mjeteve të jetesës. Në rast të kompensimit për blerjen e të drejtës së servitutit në lidhje me kufizimet afatgjata operacionale në Zonat e Kufizimit (5+5 dhe 30+30) do të zbatohet e drejta e kompensimit..
Mbeturinat	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit të Mbeturinave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar për menaxhimin e mbeturinave, që ka të bëjë me organizimin e zonave të përkohshme të depozitimit (përfshirë kushtet e veçanta për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme), masat për minimizimin dhe riciklimin e mbeturinave dhe dinamikën e depozitimit. Duhet të krijohet dhe të mbahet një regjistër i mbeturinave. Duhet të kontraktohet një kompani e regjistruar për grumbullimin dhe riciklimin e materialeve të ricikluesshme. Mbeturinat e rrezikshme duhet të trajtohen dhe të depozitohen në përputhje me standardet e BE-së vetëm tek kompanitë e autorizuara.
Tjetër	Infrastruktura, Duhet të krijohet procedura për përcaktimin e gjendjes "origjinale" të elementeve të infrastrukturës që përshkohen nga gazsjellësi ose shtrihen përgjatë linjës, që përfshin dokumentimin e gjendjes "origjinale" me anë të fotografimit dhe video-regjistrimit. Ndërtimi duhet të bëhet në përputhje me procedurat dhe afatin e ndërtimit dhe praktikat e mira të menaxhimit të kantierit. Kontraktori duhet t'i sigurojë çdo drejtuesi të tij një hartë në shkallën e duhur të rrugëve të autorizuara për kryerjen e punimeve, duke treguar qartë shpejtësitë maksimale të autorizuara dhe të sigurojë që ato të kuptohen. Duhet të sigurohet qasja e përkohshme në vendbanime për banorët vendas duke vendosur pllaka çeliku mbi kanale gjatë orëve të kufizuara; në rastet kur

Tema	Masa zbutëse
	kufizimet në qasje nuk mund të shmangen, do të përcaktohen zgjidhjet alternative në konsultim me autoritetet lokale dhe drejtuesit e komunitetit. Aksidentet Duhet të përgatitet plani i reagimit ndaj emergjencave në konsultim me autoritetet kompetente, shërbimet emergjente/mbrojtjen civile dhe administratat komunale përgjatë linjës së gazsjellësit. Duhet të sigurohen absorbentë adekuatë për grumbullimin e lëngjeve të derdhura (produktet e naftës, kimikatet, etj.) pranë vendeve të karburantit dhe magazinimit, parkimit të kamionëve dhe makinerive të rënda dhe kantiereve të ndërtimit.

10.1.2 - Masat specifike për të identifikuar konfliktet e gazsjellësve individualë

Tema	Masa zbutëse
Linja e gazsjellësit MKD e veriut/KOS kufiri në Prishtinë	
Gjeorreziqet	Gjatë fazës përgatitore duhet të merret parasysh planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit që punimet e ndërtimit në zonat e përmbytura të kryhen gjatë sezonit me prurje të thatë/të ulët. Hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik duhet të kryhen për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Zonat e mbrojtura	Në fazën e mëtejshme të fazës së përgatitjes së zhvillimit të dokumentacionit të projektit, planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit duhet të ketë parasysh që të gjitha punimet e ndërtimit brenda zonës më të gjerë të ligatinave të mbrojtura Ligatina e Hencit duhet të kryhen jashtë periudhës së folezimit të shumicës së shpendëve të ligatinave që janë regjistruar në zonën më të gjerë të projektit.
Gazsjellësi Ferizaj – Prizren	
Gjeorreziqet	Gjatë fazës përgatitore duhet të merret parasysh planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit që punimet e ndërtimit në zonat e përmbytura të kryhen gjatë sezonit me prurje të thatë/të ulët. Hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik duhet të kryhen për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Këshilltari i Trashëgimisë Kulturore duhet të angazhohet për të siguruar që ndërtimi të bëhet në përputhje me PMMTK. Aktivitetet e ndërtimit duhet të monitorohen nga profesionistë.

Tema	Masa zbutëse
	Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Popullsia dhe vendbanimet	Në fazat e mëtejshme të projektit, duhet të shqyrtohet ripozicionimi shtesë i linjës për të shmangur strukturën e ndërtimit brenda korridorit 30+30 m. Në zonën ku gazsjellësi i transmisionit kalon në distancë më të vogël se 30 m nga ngrehinat e ndërtuara (banesore), paretet e gazsjellësit duhet të jenë më të trasha, instalimi të bëhet më në thellësi dhe të mbrohet me pllaka betonarmeje, në mënyrë që të përmbushen kërkesat shtesë të sigurisë.
Gazsjellësi Prizren – Gjakovë	
Gjeorreziqet	Gjatë fazës përgatitore duhet të merret parasysh planifikimi i detajuar i korridoreve të gazsjellësit që punimet e ndërtimit në zonat e përmbytura të kryhen gjatë sezonit me prurje të thatë/të ulët.
Zonat e mbrojtura	Në fazat e mëtejshme të projektimit të Projektit, duhet të merren parasysh sa vijon: • shmangia e zonave të ndjeshme përgjatë linjës (pjerrësi të thepisura, zona të mbuluara me pyje, habitatet ujore dhe ligatinat). • • në të gjitha vendet ku mbulesa bimore do të hiqet ose dëmtohet, përzierjet e barishteve dhe bishtajoreve duhet të mbillen menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe të rikthehet servituti për të parandaluar erozionin e tokës, futjen dhe përhapjen e specieve bimore pushtuese.
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Këshilltari i Trashëgimisë Kulturore duhet të angazhohet për të siguruar që ndërtimi të bëhet në përputhje me PMMTK. Aktivitetet e ndërtimit duhet të monitorohen nga profesionistë. Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Gazsjellësi Gjakovë – Pejë	
Gjeorreziqet	Punimet e ndërimit në zonat me përmbytje duhet të bëhen gjatë sezonit të thatë/me prurje të ulëta.
Ujërat	Duhet të përgatitet plani i kryqëzimit të ujit që tregon metodat e ndërtimit që do të përdoren dhe masat mbrojtëse që do të zbatohen. Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentit tregon se si brigjet e trupave ujorë do të restaurohen dhe mbrohen nga erozioni dhe si do të

Tema	Masa zbutëse
	stabilizohen shpatet ngjitur me trupat ujorë për të parandaluar erozionin nga shpatet që derdhen në trupa ujorë. Punimet e ndërtimit në rrjedhat ujore duhet të kryhen gjatë muajve të verës (me gjasë sezoni me prurje të ulët).
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Gazsjellësi Pejë – Istog	
Gjeorreziqet	Punimet e ndërimit në zonat me përmbytje duhet të bëhen gjatë sezonit të thatë/me prurje të ulëta.
Ujërat	Duhet të përgatitet plani i kryqëzimit të ujit që tregon metodat e ndërtimit që do të përdoren dhe masat mbrojtëse që do të zbatohen. Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentit tregon se si brigjet e trupave ujorë do të restaurohen dhe mbrohen nga erozioni dhe si do të stabilizohen shpatet ngjitur me trupat ujorë për të parandaluar erozionin nga shpatet që derdhen në trupa ujorë. Punimet e ndërtimit në rrjedhat ujore duhet të kryhen gjatë muajve të verës (me gjasë sezoni me prurje të ulët).
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Gazsjellësi Istog – Skenderaj	

Tema	Masa zbutëse
Gjeorreziqet	Punimet e ndërimit në zonat me përmbytje duhet të bëhen gjatë sezonit të thatë/me prurje të ulëta. Duhet të zhvillohen hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Ujërat	Duhet të përgatitet plani i kryqëzimit të ujit që tregon metodat e ndërtimit që do të përdoren dhe masat mbrojtëse që do të zbatohen. Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentit tregon se si brigjet e trupave ujorë do të restaurohen dhe mbrohen nga erozioni dhe si do të stabilizohen shpatet ngjitur me trupat ujorë për të parandaluar erozionin nga shpatet që derdhen në trupa ujorë. Punimet e ndërtimit në rrjedhat ujore duhet të kryhen gjatë muajve të verës (me gjasë sezoni me prurje të ulët).
Gazsjellësi Prishtina 1 – Drenas	
Gjeorreziqet	Duhet të zhvillohen hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Gazsjellësi Skenderaj – Mitrovicë	
Gjeorreziqet	Punimet e ndërimit në zonat me përmbytje duhet të bëhen gjatë sezonit të thatë/me prurje të ulëta. Duhet të zhvillohen hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Gazsjellësi Prishtinë – Podujevë	
Gjeorreziqet	Duhet të zhvillohen hartat inxhinierike gjeologjike dhe hulumtimi gjeoteknik për të identifikuar shpatet e rrezikshme/të paqëndrueshme dhe vendndodhjet e mundshme të lëngëzimit përgjatë linjës.
Ujërat	Gjatë fazave të mëtejshme të projektimit të Projektit duhet të merren parasysh sa vijon: • Ripozicionimi i linjës për të reduktuar numrin e kryqëzimeve me Lumin LLap • Punimet e ndërtimit në rrugët ujore duhet të bëhen gjatë muajve të verës (me gjasë sezoni me prurje të ulët). Duhet të përgatitet plani i kryqëzimit të ujit që tregon metodat e ndërtimit që do të përdoren dhe masat mbrojtëse që do të zbatohen. Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentit tregon se si brigjet e trupave ujorë do të restaurohen dhe mbrohen nga erozioni dhe si do të stabilizohen shpatet ngjitur me trupat ujorë për të parandaluar erozionin nga shpatet që derdhen në trupa ujorë.
Peizazhi	Gjatë fazës përgatitore të shqyrtohet ripozicionimi i linjës në atë mënyrë që të shmangë zonën e peziazhit të çmueshëm – peizazhi lumor i Lumit Llap.
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë

Tema	Masa zbutëse
	e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.
Gazsjellësi Prizren – kufiri SHQ/KOS	
Trashëgimia kulturore	Duhet të përgatitet Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Për të minimizuar mundësinë e shkatërrimit aksidental të zonave arkeologjike të pazbuluara gjatë përgatitjes së Studimit të Ndikimit në Mjedis për këtë itinerar, është e nevojshme të kryhet një studim arkeologjik në terren i linjës për të sugjeruar ndryshime të mundshme në linjë. Si pjesë e hulumtimit, është e nevojshme të merren parasysh elementet e trashëgimisë arkitekturore. Në rast të gjetjeve të rastit, është e nevojshme të ndërmerren veprime sipas Procedurave të Gjetjeve të Rastit, të cilat duhet të përgatiten, zbatohen dhe komunikohen me të gjithë personelin e ndërtimit në frontet e ndërtimit. Nëse kërkohet shpëtim arkeologjik në një gjetje të rastësishme, shpëtimi do të kryhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare.

11 - PLANI I MONITORIMIT PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË VSM

Në Kosovë po monitorohen një sërë parametrash mjedisorë. Duke qenë se ndikimet nuk janë të rëndësishme dhe kanë karakter lokal, monitorimi i mjedisit nuk parashikohet. Ndikimet nuk janë të përmasave që mund të ndryshojnë gjendjen e komponentëve të veçantë mjedisorë në afat të gjatë. Supozohet se në këtë fazë nuk ka nevojë për përcaktimin e monitorimit të veçantë mjedisor. Për të monitoruar ndikimin e mundshëm të zbatimit të ZHG në mjedis, nuk kërkohet ngritja e sistemeve (programeve) të reja të monitorimit të mjedisit.

Duke pranuar faktin se monitorimi i emisioneve GHG tashmë është i përshkruar në Kosovë (brenda fushës së monitorimit të ndryshimeve klimatike), rekomandohet të përfshihet përdorimi i gazit natyror dhe kontributi i tij në emisionet e GHG në llogaritjet pasi sistemi i gazifikimit të hyjë në funksion.

Po ashtu, janë krijuar mekanizmat e monitorimit të mjedisit nëpërmjet procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel projekti (nivel VNM).

12 - PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE TË PROPOZUARA NË ZHG

12.1 - Rrjeti fillestar i transmisionit të gazit

Në kuadër të zhvillimit fillestar të Planit të gazit, zhvillohet një rrjet i përkohshëm i transmisionit të gazit në mbarë Kosovën me qëllim që të arrijë të gjitha qendrat kryesore të konsumit në mënyrën më ekonomike dhe me ndikim minimal në mjedis. Koncepti i propozuar mbështetet në lidhjen me sistemin e transmisionit të gazit të Maqedonisë së Veriut. Paraqitja paraprake e sistemit të transmisionit të gazit të Kosovës përbëhet nga ndërlidhja e gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë, unaza e gazit të Kosovës që arrin te konsumatorët më të mëdhenj potencialë dhe degët e transmetimit të gazit siç tregohet në in **FigurA 72.**

FIGURA 72 – SKICA PARAPRAKE E GAZSJELLËSIT TË TRANSMISIONIT TË PLANIFIKUAR NË KOSOVË



Hartat zyrtare topografike 1:25000 janë përdorur krahas atyre në dispozicion në softuerin Google Earth për të shtruar linjat e gazsjellësit. Për gazsjellësit janë përzgjedhur korridore/linja të përshtatshme, duke minimizuar gjatësinë, koston dhe ndikimet mjedisore të sistemit të propozuar të gazsjellësit. Është zhvilluar edhe optimizimi bazë hidraulik.

Linjat e gazsjellësit përshkojnë peizazhe të ndryshme, që variojnë nga toka e sheshtë dhe e punueshme në rajonet malore dhe shkëmbore. Linjat e gazsjellësit kalojnë disa lumenj, hekurudha, autoudhë dhe rrugë më të

vogla. Përshtatshmëria e secilit vendkalim dhe teknika e propozuar e kalimit do të vlerësohet dhe konfirmohet për rrugët e zgjedhura në Portofolin e Projektit Prioritar.

Linjat e gazsjellësit të propozuara fillimisht janë si në vijim:

1	Linja e gazsjellësit MKD/KOS kufiri me Prishtinën	13	Linja e gazsjellësit Krushe e Madhe - Rahovec
2	Linja e gazsjellësit Ferizaj - Prizren	14	Linja e gazsjellësit Rahovec - Malisheve
3	Linja e gazsjellësit Prizren - Gjakova	15	Linja e gazsjellësit Ferizaj - Shtime
4	Linja e gazsjellësit Gjakova - Peja	16	Linja e gazsjellësit Peja - Kline
5	Linja e gazsjellësit Peja - Istog	17	Linja e gazsjellësit deri në Kacanik
6	Linja e gazsjellësit Istog - Skenderaj	18	Linja e gazsjellësit Prizren - Dragash
7	Linja e gazsjellësit Prishtina 1 - Drenas	19	Linja e gazsjellësit Prishtina - Podujeve
8	Linja e gazsjellësit Drenas - Skenderaj	20	Linja e gazsjellësit Suhareka - Mamushe
9	Linja e gazsjellësit Skenderaj - Mitrovicë	21	Linja e gazsjellësit BVS Hani i Elezit deri në Sharrcem
10	Linja e gazsjellësit Mitrovicë - Vushtrri	22	Linja e gazsjellësit Prizren – kufiri ALB/KOS
11	Linja e gazsjellësit Ferizaj - Gjilan		
12	Linja e gazsjellësit Gjilan - Kamenicë		

Në procesin e përgatitjes së ZHG janë përfshirë ekipet mjedisore dhe sociale, që në fillim të përcaktimit të linjës së gazsjellësit. U krijua bashkëpunim i ngushtë me ekipin teknik dhe u arrit optimizimi i linjës. Analiza e mjedisit dhe ajo sociale u bënë për të vlerësuar pengesat potenciale mjedisore dhe sociale të projektit, për të shqyrtuar

projektin dhe për të identifikuar mënyrat për përmirësimin e implementimit të projektit duke shmangur ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe sociale nga aktivitetet e projektit dhe duke rritur ndikimet pozitive. Që nga fillimi i shqyrtimit të linjës dhe analizimit të saj, është zbatuar hierarkia zbutëse e BERZH përë të shmangur dhe nëse kjo nuk do të ishte e mundur, për të minimizuar dhe zbutur të gjitha ndikimet e identifikuara.

Gjatë të gjithë procesit të përcaktimit të itinerarit dhe të vlerësimit është përdorur hierarkia e zbutjes, duke shmangur ndikimet mjedisore ose sociale të projektit që në fillim të zhvillimit të aktiviteteve, sa herë ka qenë e mundur.

Një nga qëllimet kryesore ka qenë shmangia e zhvendosjes fizike (zonat urbane) dhe ndikimet e konsiderueshme mbi biodiversitetin dhe trashëgiminë kulturore, si dhe minimizimi i zhvendosjes ekonomike.

12.1.1 - Vlerësimi ekonomik dhe opsionet për zhvillimin e sistemit

Analiza e kërkesës dhe ofertës për gaz rezultoi në paraqitjen paraprake të rrjetit të transmisionit të gazit, të treguar në **FigurA 72**

Figura tregon dy përbërësit kryesorë të rrjetit të ardhshëm për transmisionin e gazit: **gazsjellësi SKOPRI** (blu) dhe **Unaza e gazsjellësit** (e kuqe). Komunat (pikat e konsumit) kur është paraparë furnizimi me gaz janë paraqitur si pika të verdha. Në total janë 28 komuna (pika konsumi) për të cilat është paraparë kërkesa për gaz. Gjithashtu, vijat vjollcë tregojnë linjat që nevojiten për të lidhur disa nga zonat e shpërndarjes me rrjetin kryesor të transmisionit.

Sa i përket strukturës së kërkesës për gaz, janë supozuar këto kategori të konsumatorëve:

- Sektori i ekonomive familjare
- Sektori i shërbimeve
- Sektori i industrisë
- Sektori i gjenerimit të energjisë.

Për të përcaktuar se ku do të jetë i realizueshëm zhvillimi i rrjetit të gazit, është e rëndësishme të kuptohet se sa gaz pritet të konsumohet në secilën komunë. Nga 28 komuna, shtatë komuna përbëjnë 78% të të gjithë konsumit të gazit (përfshirë konsumin e gazit të prodhimit të energjisë elektrike në Prishtina, shprehur në bar).

Tarifa mesatare e ponderuar për shpërndarjen e gazit për të gjitha zonat e shpërndarjes në Kroaci në vitin 2020 ka qenë 6,68 EUR/MWh, që varion nga 4 EUR/MWh në 13,3 EUR/MWh[29]. Prandaj, gjatë analizës paraprake, Konsulenti ka marrë parasysh vetëm ato zona të shpërndarjes me tarife efektive të shpërndarjes së gazit (që përfshin lidhjen me rrjetin e transmisionit të gazit) prej 14 €/MWh ose më pak që do të ishte i realizueshëm ekonomikisht. Si rrjedhojë, 11 zonat e shpërndarjes në vijim kanë nivel të pranueshëm të tarifës së shpërndarjes së gazit, pra poshtë 14 €/MWh: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Vushtrri, Suharekë, Gllogoc, Lipjan, Skenderaj, Viti, Hani i Elezit.


Për më tepër, gjashtë komuna shtesë kanë tarifa ndërmjet 14 €/MWh dhe 20€/MWh. Edhe pse këto tarifa janë përcaktuar mbi kufirin e paracaktuar, Konsulenti i ka përfshirë këto komuna si qendra potenciale për kërkesë për gaz. Arsyetimi për përfshirjen e këtyre komunave është se tarifa e tyre e shpërndarjes, edhe pse është mbi kufirin e paracaktuar prej 14 €/MWh, ende nuk është skajshmërisht e lartë dhe autoritetet kosovare mund të vendosin ende të zhvillojnë rrjet të shpërndarjes së gazit në ato komuna (ose nëpërmjet linjës së gazsjellësit ose LNG/CNG). Këto gjashtë qendra për kërkesën për gaz përfshijnë komunat: Gjilan, Podujevë, Rahovec, Deçan, Istog, Mitr. e Veriut dhe të gjithë Mitrirovicën plus Vushtrrinë. Kjo qendër e fundit e konsumit u krijua duke kombinuar të gjithë Mitrovicën me komunën e Vushtrisë. Edhe pse komuna e Vushtrisë ka nivel të

---

[29] *Source: Croatian Energy Regulatory Agency, Annual report, 2020 available at https://www.hera.hr/hr/docs/HERA_izvjesce_2020.pdf*

pranueshëm të tarifës së shpërndarjes së gazit (9 €/MWh), Mitrovica nuk e ka (25 €/MWh), ndërsa Mitr. e Veriut po (17 €/MWh).

FIGURA 73 – PËRLLOGARITJA E TOTALIT TË TARIFAVE TË SHPËRNDARJES



Skica e nevojshme për sistemin e transmisionit të gazit për të mundësuar gazifikimin e zonës së shpërndarjes për të cilën Konsulenti përcaktuar nivelet e pranueshme oër tarifat e shpërndarjes së gazit (të gjelbra dhe të verdha) që paraqiten në **FigurA 74**.

Për komunat e gazsjellësit SKOPRI (me përjashtim të Podujevës dhe Gjilanit) kostot totale të rrjetit duket të jenë të arsyeshme në përputhje me standardet aktuale të industrisë. Nga ana tjetër, për shkak të kostove të larta të investimeve për ndërtimin e Unazës së gazsjellësit, kostot totale të rrjetit për shumë komuna jane relative, por jo aq të larta sa ta pengojnë projektin. Prandaj, nuk është e mundur që të përcaktohet pa mëdyshje realizueshmëria ekonomike e furnizimit të këtyre komunave me gaz. Gjithashtu, ndryshimet që priten të ndodhin në sektorin e energjisë që mund të rezultojnë në një rritje të të gjitha çmimeve të energjisë e bëjnë ndërtimin e Unazës të pranueshëm në aspektin ekonomik. Rrjedhimisht, për shkak të pasigurive të konsiderueshme, propozojmë dy skenarë: një më optimist që kërkon edhe ndërtimin e unazës së gazsjellësit (skenari i gazifikimit në shkallë të gjerë) dhe një më konservativ që kërkon ndërtimin vetëm të gazsjellësit SKOPRI (skenari i gazifikimit në shkallë të vogël).

Linjat e gazsjellësi për skenarin e gazifikimit në shkallë të gjerë paraqiten në tabelën më poshtë.

1	Linja e gazsjellësit MKD/KOS kurifi në Prishtinë	9	Linja e gazsjellësit Skenderaj - Mitrovicë
2	Linja e gazsjellësit Ferizaj - Prizren	10	Linja e gazsjellësit Mitrovicë – Vushtrri
3	Linja e gazsjellësit Prizren - Gjakova	11	Linja e gazsjellësit Ferizaj - Gjilan
4	Linja e gazsjellësit Gjakova - Pejë	12	Linja e gazsjellësit Krushe e Madhe - Rahovec

5	Linja e gazsjellësit Pejë - Istog	13	Linja e gazsjellësit Prishtina - Podujevë
6	Linja e gazsjellësit Istog - Skenderaj	14	Linja e gazsjellësit SBV Hani i Elezit në Sharrcem
7	Linja e gazsjellësit Prishtina 1 - Drenas	15	Linja e gazsjellësit Prizren – kufiri SHQ/KOS
8	Linja e gazsjellësit Drenas - Skenderaj		

12.2 - Skenari për gazifikimin në shkallë të gjerë

Linjat e gazsjellësit përshkojnë peizazhe të ndryshme, që variojnë nga toka e sheshtë dhe e punueshme në rajonet malore dhe shkëmbore. Linjat e gazsjellësit kalojnë disa lumenj, hekurudha, autoudhë dhe rrugë më të vogla. Përshtatshmëria e secilit vendkalim dhe teknika e propozuar e kalimit do të vlerësohet dhe konfirmohet për rrugët e zgjedhura në Portofolin e Projektit Prioritar.

Skenari i gazifikimit në shkallë të gjerë nënkupton zhvillimin bashkërisht të linjës SKOPRI dhe Unazës. Përsa i përket zhvillimit të zonave të shpërndarjes, ky skenar përjashton konsumin në komunat që vlerësohen të jenë ekonomikisht të paqëndrueshme: Malishevë, Klinë, Kamenicë, Dragash, Kaçanik, Shtime, and Mamushë (shënuar me të kuqe në **FigurA 74**).

Përshkrimet më të detajuara të linjave paraqiten në **Kapitullin 7** të këtij raporti për përcjellje më të lehtë.

FIGURA 74 – LINJA E GAZSJELLËSIT



12.2.1 - Parametrat e sistemit të transmisionit

Përllogaritja përkatëse hidraulike rezultoi në diametër DN600 të interkoneksionit MKD-KOS dhe nxori kërkesën për presion të valvulës prej 41 bar në Shkup; (41 bar kërkohen për DN 600 që të arrijnë 30 në CCGT të planifikuar pranë Prishtinës). Parametrat rezultues të tubave dhe hidraulikë dhe CAPEX përkatës paraqiten në Error! Reference source not found..

TABELA 50 – REZULTATET E PËRLLOGARITJES HIDRAULIKE DHE CAPEX PËR GAZSJELLËSIN E TRANSMISIONIT TË ZHVILLUAR NË KUADËR TË SKENARIT TË GAZIFIKIMIT NË SHKALLË TË GJERË

	Nr	Komuna	Qarku	Seksioni	Gjatësia (km)	Diam. (inçë)	Presioni në fund të seksionit (bar)	Total (mil €)
Interkoneksioni MKD-KOS	0	Republika e Maqedonisë së Veriut		Pika e lidhjes MKD – Kufiri MKD/KOS	27,0	24	**37,94**	**N/A**
	1-1	Hani i Elezit	Ferizaj	Kufiri MKD/KOS - BVS Hani i Elezit	17,5	24	**38,10**	
	1-2	Kacanik	Ferizaj	BVS Hani i Elezit - BVS Kacanik	17,5	24	**36,92**	
	1-3	Viti	Ferizaj	BVS Kacanik - Smire	14,2	24	**37,24**	**18,859**
	2	Ferizaj	Ferizaj	BVS/PRMS Smire - PTS/PRMS Ferizaj	16,2	24	**36,25**	**13,212**
	3	Ferizaj	Ferizaj	PTS/RMS Ferizaj - BVS Banulla	16,2	24		**13,671**
	4	Lipjan	Prishtina	PRMS Banulla - BVS/PRMS Lipjan	8,0	24	**35,06**	**7,672**
	5	Prishtina	Prishtina	BVS/PRMS Lipjan - PTS/PRMS Prishtina 1	6,7	24	**34,76**	**6,636**
	6	Obiliq	Prishtina	PTS/PRMS Prishtina 1 - PTS/PRMS Prishtina 2	12,7	24	**34,55**	**12,228**
	NËNTOTALI Interkoneksioni MKD/KOS:							**72,278**
Unaza e gazit	7	Shtime	Ferizaj	PTS/PRMS Ferizaj - PRMS Suharekë	39,6	10	**33,30**	**19,623**
	8	Suharekë	Prizren	PRMS Suharekë - PTS/PRMS Prizren	15,3	10	**32,24**	**6,366**
	9	Prizren	Prizren	PTS/PRMS Prizren - BVS Krushe e Madhe	13,3	10	**32,23**	**6,369**
	10	Gjakovë	Gjakova	BVS Krushe e Madhe - PRMS Gjakova	15,5	10	**31,95**	**6,197**
	11	Deçan	Gjakova	PRMS Gjakova - PRMS Decan	24,0	10	**31,49**	**8,800**
	12	Pejë	Peja	PRMS Decan - PTS/PRMS Peja	12,0	10	**31,65**	**5,535**
	13	Istog	Peja	PTS/PRMS Peja - PRMS Istog	24,0	10	**31,95**	**10,995**
	14	Skenderaj	Mitrovica	PRMS Istog - PTS/PRMS Skenderaj	28,0	10	**31,76**	**12,598**
	15	Gllogoc	Prishtina	PRMS Drenas - PTS/PRMS Skenderaj	17,7	10	**31,76**	**8,675**
	16	Fushë Kosovë	Prishtina	PTS/PRMS Prishtina 1 - PRMS Drenas	14,7	10	**33,30**	**8,389**
	NËNTOTAL Unaza e gazit:							**93,544**
Degët e transmisionit	17	Mitrovicë	Mitrovica	PTS/PRMS Skenderaj - PRMS Mitrovica	16,5	6	**25,63**	**6,545**
	18	Vushtrri	Mitrovica	PRMS Mitrovica - PTS/PRMS Vushtrri	7,2	6	**25,00**	**2,808**
	19	Ferizaj	Ferizaj	PTS/PRMS Ferizaj - PTS/PRMS Gjilan	24,9	6	**33,51**	**8,653**
	20	Rahovec	Gjakova	BVS Krushe e Madhe - PRMS Rahovec	8,0	4	**31,28**	**2,352**
	21	Podujevë	Prishtina	PTS/PRMS Prishtina 2 - PTS/PRMS Podujevo	33,0	4	**20,30**	**9,927**
	22	Hani i Elezit	Ferizaj	BVS Hani i Elezit - PRMS Hani i Elezit (Sharrcem)	2,7	4	**37,50**	**1,989**
	NËNTOTAL Degët e transmisionit:							**32,273**
TOTALI sistemi i transmisionit të gazit në Kosovë:								198,095

12.2.2 - Përllogaritjet ekonomike dhe tarifore

Skenari i gazifikimit në shkallë të gjerë nënkupton tarifë mesatare të transmisionit të gazit me 3.9 €/MWh që përshkruhet në hollësi në ZHG.

12.3 - Skenari për gazifikimin në shkallë të vogël

Skenari i gazifikimit në shkallë të vogël nënkupton zhvillimin e gazsjellësit SKOPRI. Sa i përket zonës së shpërndarjes, përfshin: Ferizajin, Smirën, Lipjanin, Prishtinën (përfshirë Obiliqin dhe Fushë Kosovën), Drenasin (Ferronikeli) dhe Hanin e Elezit.

12.3.1 - Parametrat e sistemit të transmisionit

Optimizimi hidraulik i këtij skenari ka rezultuar në dimensionin e tubacionit SKOPRI prej DN500. Presioni minimal që kërkohet në kufirin Bullgari/MKD duhet të jetë 45 bar, në mënyrë që të arrihet presioni prej 43 në Shkup, që më pas siguron 30 bar për CCGT Prishtinë.

Nëse sigurohet 54 bar në kufirin bullgar, infrastruktura e paraparë brenda këtij skenari mundëson furnizimin me gaz për orë në kohën e pikut prej 186.700 m^3/h. Kjo do të mundësonte gazifikimin edhe të zonaveshtesë të shpërndarjes, përshembull në Podujevë, Vushtrri, Mitrovicë dhe Gjilan përveç skenarit të gazifikimit në shkallë të vogël. Nëse edhe zona të tjera të shpërndarjes do të marrin gaz, duhet të instalohet stacion kompresor për të rritur kapacitetin maksimal të linjës DN500 SKOPRI.

Parametrat rezultues të linjës dhe ato hidraulike dhe CAPEX përkatës për skenarin e gazifikimit në shkallë të vogël paraqiten në **TabELA 51**.

TABELA 51 – REZULTATET E PËRLLOGARITJES HIDRAULIKE DHE CAPEX PËR LINJAT E TRANSMISIONIT TË ZHVILLUARA NË KUADËR TË SKENARIT TË GAZIFIKIMIT NË SHKALLË TË VOGËL

	Nr	Komuna	Qarku	Seksioni	Gjatësia (km)	Diam. (inçë)	Presioni në fund të seksionit (bar)	Totali (mil €)
Interkoneksioni MKD/KOS	0	Republika e Maqedonisë së Veriut		Pika e lidhjes MKD – Kufiri MKD/KOS	27,0	24	**39,58**	**N/A**
	1-1	Hani i Elezit	Ferizaj	Kufiri MKD/KOS - BVS Hani i Elezit	17,5	24	**39,74**	
	1-2	Kacanik	Ferizaj	BVS Hani i Elezit - BVS Kacanik	17,5	24	**38,46**	
	1-3	Viti	Ferizaj	BVS Kacanik - Smire	14,2	24	**38,72**	**16,684**
	2	Ferizaj	Ferizaj	BVS/PRMS Smire - PTS/PRMS Ferizaj	16,2	24	**37,59**	**11,271**
	3	Ferizaj	Ferizaj	PTS/RMS Ferizaj - BVS Banulla	16,2	24		**11,401**
	4	Lipjan	Prishtina	PRMS Banulla - BVS/PRMS Lipjan	8,0	24	**35,75**	**6,436**
	5	Prishtina	Prishtina	BVS/PRMS Lipjan - PTS/PRMS Prishtina 1	6,7	24	**35,27**	**5,476**
	6	Obiliq	Prishtina	PTS/PRMS Prishtina 1 - PTS/PRMS Prishtina 2	12,7	24	**34,72**	**10,251**
				NËNTOTALI i Interkoneksionit MKD/KOS:				**61,519**
Deët	7	Fushë Kosovë	Prishtina	PTS/PRMS Prishtina 1 - PRMS Drenas	14,7	10	**35,16**	**8,389**
	8	Hani i Elezit	Ferizaj	BVS Hani i Elezit - PRMS Hani i Elezit (Sharrcem)	2,7	4	**39,23**	**1,989**
				NËNTOTALi i degëve të transmisionit:				**10,378**
				TOTALI i sistemit të transmisionit të gazit në Kosovë:				71,897


12.3.2 - Përllogaritja ekonomike dhe tarifore

Skenari i gazifikimit në shkallë të vogël është shumë i ngjashëm me skenarin e zhvillimit të linjës SKOPRI që përshkruhet në **kapitullin 12.2.** Dallimet janë:

- Supozohet që Podujeva dhe Gjilani nuk do të lidhen me linjën SKOPRI. Ndërlikimet praktike janë që kërkesa për gaz në skenarin e gazifikimit në shkallë të vogël pakësohet nga kërkesa për gaz në Podujevë dhe Gjilan.
- Rrjeti i transmisionit shtrihet edhe në Drenas, duke nënkuptuar rritje në kostot totale të investimit.

Tarifa rezultuese për transmisionin e gazit në skenarin e gazifikimit në shkallë të vogël është 2,02 €/MWh. Sikurse tregon figura në vijim, me përjashtim të Hanit të Elezit që ka kosto totale të rrjetit prej 3 €/MWh, kostot e rrjetit për komuna të tjera janë 10 dhe 14 €/MWh, që është shprehur si nivel i pranueshëm i tarifave për transmisionin e gazit.

FIGURA 75 – KOSTOT E RRJETIT TË GAZIT PËR ZONAT E PËRZGJEDHURA PËR KONSUM NË SKENARIN E GAZIFIKIMIT NË SHKALLË TË VOGËL



12.4 - Skenari industrial

Përfituesi sugjeroi një skenar shtesë – "skenar industrial". Skenari industrial supozon se nuk ka rrjete të shpërndarjes së gazit dhe rritjen e kërkesës për gaz industrial. Për më tepër, nuk është parashikuar asnjë unazë gazi. Në rast se nuk është paraparë zhvillimi i unazës së gazit, Konsulenti ka vlerësuar edhe një rrugë alternative të kyçjes (nëpërmjet Obiliqit) me Drenasin, Mitrovicën dhe Vushtrinë..

12.4.1 - Parametrat e sistemit të transmisionit

Konsulenti ka zhvilluar analizën hidraulike të skenarit për të përcaktuar diametrin optimal të gazsjellësit të interkoneksionit MKD-KOS. Sistemi i transmisionit përfshin interkoneksionin e gazit MKD-KOS (SKOPRI) dhe degët drejt Mitrovicës dhe Vushtrrisë, si dhe degën e Hanit të Elezit. Modeli hidraulik (Block Flow Diagram) për këtë llogaritje jepet në shtojcat e raportit. Për shkak të kërkesës së reduktuar të kapacitetit të transmisionit, u vlerësua opsioni i zvogëlimit të diametrit SKOPRI (ulje në DN400). Krahasimi i rezultateve të llogaritjes me skenarin e gazifikimit në shkallë të vogël paraqitet në **Tabela 52** nën nënskenarët DN400 dhe Industrial DN500. Është konstatuar se dimensioni DN400 SKOPRI nuk lejon rritje shtesë të sasive për nevojat e ardhshme potenciale të industrisë për 30% siç propozohet nga Përfituesi. Në skenarin Industrial DN500, kur diametri i gazsjellësit është DN500, është e mundur të rritet konsumi i dhënë industrial me 30%, me presionin e kërkuar në kufirin Bullgari/MKD prej 43 bar.

Analiza e mëtejshme hidraulike tregoi se diametri DN500 lejon dyfishimin e sasive bazë të konsumit industrial, me presionin e kërkuar në kufirin Bullgari/MKD prej 45 bar. Rezultatet e atij skenari janë shumë të ngjashme me rezultatet e skenarit të gazifikimit në shkallë të vogël (Skenari 1 në **Tabela 52**). Prandaj, u arrit në përfundimin se shtrirja dhe parametrat e rrjetit siç parashikohen në skenarin e gazifikimit në shkallë të vogël janë të përshtatshme për "skenarin e gazifikimit industrial".

TABELA 52 – KRAHASIMI I REZULTATEVE HIDRAULIKE TË SKENARËVE TË GAZIFIKIMIT INDUSTRIAL KUNDREJT SKENARIT TË GAZIFIKIMIT NË SHKALLË TË VOGËL

Skenari	Kërkesa kulmore për gaz MKD	Kërkesa kulmore për gaz KOS	Presioni në kufirin MKD-Greqi	Presioni në kufirin me Bullgarinë	Presioni në dispozicion në Shkup	Diam. SKOPRI	Presioni CCGT Prishtina
	(m^3/h)	(m^3/h)	(bar)	(bar)	(bar)	DN (mm)	(bar)
PBB KOS, skenari i gazifikimit në shkallë të vogël (familjet, shërbimet dhe industria + CCGT)							
Gazifikimi në shkallë të vogël	230 600	157 000	55	**45**	**43**	**500**	**31**
KOS, skenarët e projektimit të ri (industri + CCGT)							
Industrial DN400	230 600	123 300	55	**51**	**49**	**400**	**31**
Industrial DN500	230 600	133 000	55	**43**	**42**	**500**	**33**

Shënime:
Volumi i kërkuar CCGT prej 91.000 m3/h përfshihet në totalin e Kosovës.
Skenari *Industrial DN400* tregon rezultatet hidraulike për kërkesën bazë industriale (pa) rritje prej 30%, pasi 30 bar në Prishtinë nuk mund të arrihen me 30% të rritjes së kërkesës industriale, ndërsa Skenari I*ndustrial DN500* tregon rezultatet hidraulike për kërkesën industrial t♪7 rritur me 30%.

TABELA 53 – REZULTATET E LLOGARITJEVE HIDRAULIKE DHE CAPEX PËR GAZSJELLËSIT E TRANSMISIONIT TË ZHVILLUAR NË SKENARIN E GAZIFIKIMIT INDUSTRIAL DN400

	Nr	Komuna	Qarku	Seksioni	Gjatësia (km)	Diam. (inç)	Presioni në fund të seksionit (bar)	Totali (mil €)
Interkoneksioni MKD/KOS	0	Republika e Maqedonisë së Veriut		Pika e lidhjes MKD – Kufiri MKD/KOS	27,0	16	**44,05**	**N/A**
	1-1	Hani i Elezit	Ferizaj	Kufiri MKD/KOS - SBV Hani i Elezit	0,4	16	**34,21**	
	1-2	Kacanik	Ferizaj	SBV Hani i Elezit - SBV Kacanik	7,5	16	**42,48**	
	1-3	Viti	Ferizaj	SBV Kacanik - Smire	9,8	16	**42,32**	**14,182**
	2	Ferizaj	Ferizaj	SBV/PRMS Smire - STP/SMRP Ferizaj	14,2	**16**	40,42	**9,580**
	3	Ferizaj	Ferizaj	PTS/RMS Ferizaj - SBV Banulla	16,2	16		**9,691**
	4	Lipjan	Prishtina	PRMS Banulla - SBV/PRMS Lipjan	8,0	**16**	37,10	**5,471**
	5	Prishtina	Prishtina	SBV/PRMS Lipjan - STP/SMRP Prishtina 1	6,7	**16**	36,18	**4,654**
	6	Obiliq	Prishtina	STP/SMRP Prishtina 1 - STP/SMRP Prishtina 2	12,7	**16**	34,85	**8,713**
		NËNTOTAL Interkoneksioni MKD/KOS (pa seksionin MKD):			**75,5**			**52,291**
Degëzimit	7	Fushë Kosovë	Prishtina	STP/SMRP Prishtina 1 - PRMS Drenas	14,7	10	**35,98**	**8,389**
	8	Drenas	Prishtina	PRMS Drenas- STP/SMRP Skenderaj	17,7	10	**35,75**	**8,675**
	9	Mitrovicë	Mitrovica	STP/SMRP Skenderaj – PRMS Mitrovica	16,5	6	**35,53**	**6,545**
	10	Vushtrri	Mitrovica	PRMS Mitrovica – PRMS Vushtrri	7,2	6	**35,42**	**2,808**
	11	Hani i Elezit	Ferizaj	SBV Hani i Elezit - PRMS Hani i Elezit (Sharrcem)	2,7	4	**44,04**	**1,989**
				NËNTOTAL Degëzimet e transmisionit:	**58,8**			**26,417**
				TOTAL sistemi i transmisionit të gazit Kosovë:	**134,3**			78,708

TABELA 54 – REZULTATET E LLOGARITJEVE HIDRAULIKE DHE CAPEX PËR GAZSJELLËSIT E TRANSMISIONIT TË ZHVILLUAR NË SKENARIN E GAZIFIKIMIT INDUSTRIAL DN500

	Nr	Komuna	Qarku	Seksioni	Gjatësia (km)	Diam. (inç)	Presioni në fund të seksionit (bar)	Totali (mil €)
Interkoneksioni MKD/KOS	0	Republika e Maqedonisë së Veriut		Pika e lidhjes MKD – Kufiri MKD/KOS	27,0	20	**39,17**	**N/A**
	1-1	Hani i Elezit	Ferizaj	Kufiri MKD/KOS - SBV Hani i Elezit	0,4	20	**39,34**	
	1-2	Kacanik	Ferizaj	SBV Hani i Elezit - SBV Kacanik	7,5	20	**38,24**	
	1-3	Viti	Ferizaj	SBV Kacanik - Smire	9,8	20	**38,74**	**16,684**
	2	Ferizaj	Ferizaj	SBV/PRMS Smire - STP/SMRP Ferizaj	14,2	20	**37,95**	**11,271**
	3	Ferizaj	Ferizaj	PTS/RMS Ferizaj - SBV Banulla	16,2	20		**11,401**
	4	Lipjan	Prishtina	PRMS Banulla - SBV/PRMS Lipjan	8,0	20	**36,59**	**6,436**
	5	Prishtina	Prishtina	SBV/PRMS Lipjan - STP/SMRP Prishtina 1	6,7	20	**36,25**	**5,476**
	6	Obiliq	Prishtina	STP/SMRP Prishtina 1 - STP/SMRP Prishtina 2	12,7	20	**35,84**	**10,251**
		NËNTOTAL Interkoneksioni MKD/KOS (pa seksionin MKD):			**75,5**			**61,519**
Degëzimet	7	Fushë Kosovë	Prishtina	STP/SMRP Prishtina 1 - PRMS Drenas	14,7	10	**35,99**	**8,389**
	8	Drenas	Prishtina	PRMS Drenas – STP/SMRP Skenderaj	17,7	10	**35,71**	**8,675**
	9	Mitrovicë	Mitrovica	PRMS Skenderaj – PRMS Mitrovica	16,5	6	**35,07**	**6,545**
	10	Vushtrri	Mitrovica	PRMS Mitrovica – STP/SMRP Vushtrri	7,2	6	**34,89**	**2,808**
	11	Hani i Elezit	Ferizaj	SBV Hani i Elezit - PRMS Hani i Elezit)	2,7	4	**38,23**	**1,989**
				NËNTOTAL Degëzimet e transmisionit:	**58,8**			**26,417**
				TOTAL sistemi i transmisionit të gazit Kosovë:	**134,3**			**87,936**

Për lehtësi krahasimi, **Tabela 53** dhe **Tabela 54** përfshijnë degët e planifikuara më parë drejt Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Megjithatë, në rast se nuk planifikohet fare unazë, siç sugjerohet nga Përfituesi për këtë skenar, ne vlerësojmë edhe alternativën pak më të shkurtër në drejtim të Mitrovicës, degën e re Obiliq-Vushtrri, që përfshin degën Mitrovicë-Vushtrri të planifikuar më parë. Dega e re Obiliq-Vushtrri do të përpunohet më tej gjatë fazës së ardhshme të kësaj detyre (PIP).

CAPEX paraprak i seksionit Obiliq – Vushtrri – Mitrovicë të gazsjellësit jepet në **Tabela 55**.

TABELA 55 –CAPEX PARAPRAK I DEGËS OBILIQ – VUSHTRRI - MITROVICË

Komuna	Qarku	Seksioni	Objekti	Gjatësia (km)	Diam. (inç)	Total (mil €)
Obiliq	Pristina	PTS/ PRMS Prishtina 2 - PRMS Vushtrri	PTS (BVS), BVS	20,4	6	**6,925**
Vushtrri	Mitrovica	PRMS Mitrovica - PRMS Vushtrri	PTS (BVS)	7,2	6	**2,808**

Sistemi i transmisionit në Kosovë për skenarin e gazifikimit industrial përfshirë seksionin alternativ Obiliq – Vushtrri – Mitrovicë paraqitet në **Figura 76**.

FIGURA 76 – SISTEMI I TRANSMISIONIT TË KOSOVËS PË SKENARIN ALTERNATIV TË GAZIFIKIMIT INDUSTRIAL



12.4.2 - Konsiderata mjedisore

Skenari i propozuar përbëhet nga 3 linja të gazsjellësit:

1. Interkoneksioni Maqedoni e Veriut – Kosovë

2. Gazsjellësi Obiliq – Vushtrri


3. Gazsjellësi Mitrovicë – Vushtrri

Meqenëse përfituesi ka propozuar skenarin e ri, është bërë vlerësimi shtesë mjedisor për linjën e gazsjellësit Obiliq - Vushtrri që nuk ishte mbuluar më parë. Duhet të parashikohet që linjat e gazsjellësit të interkoneksionit Maqedoni Veriore – Kosovë, si dhe gazsjellësi Mitorvicë – Vushtrri të përfshihen në skenarët e vlerësuar më parë.

12.4.2.1 - Përshkrimi I linjës

Ky gazsjellës transmisioni është 20.4 km i gjatë, shtrihet në drejtim të përgjithshëm veriperëndimor mbi toka bujqësore shumë të sheshta në luginën e lumit Sitnicë pranë korridoreve të hekurudhës dhe rrugës R220. Linja fillon në STP/SMRP Prishtina 2 dhe përfundon në STP/SMRP Vushtrri, duke kaluar dy herë rrugën R220, një herë rrugën R105-R220, një herë linjën hekurudhore dhe dy herë lumin Sitnicë. Gazsjellësi përshkon zonën rajonale të Prishtinës dhe zonën rajonale të Mitrovicës, përkatësisht përmes njësive administrative Obiliq dhe Vushtrri. Lartësitë në linjë janë nga 511 m deri në 539 m ASL dhe është planifikuar kryesisht në shpate shumë të buta. Gazsjellësi gjendet në zonën e përmbytjeve me potencial mesatar dhe në zonën e mundshme të rrëshqitjeve të dheut. Pjesa më e madhe e trasesë linjës ndodhet në zonën e tokës aluvionale të shkrifët dhe argjilore. Zona dominohet nga toka e punueshme pa ujitje dhe nga modele komplekse kultivimi. Pjesa më e madhe e linjës kalon përmes tokës bujqësore (16,3 km). Së pari 1,8 km e linjës kalon nëpër kullota, dhe rreth 2,3 km e linjës rreth kryqëzimit të gazsjellësit mbi lumin Sitnicë kalon nëpër ligatina. Gazsjellësi kalon kryesisht përmes habitatit I1 (bujqësor). Ai nuk është planifikuar brenda ose në afërsi të ndonjë zone të mbrojtur. Nuk ka asete kulturore nga lista e pasurive kulturore dhe natyrore të UNESCO-s në afërsi të konsiderueshme të projektit të planifikuar.

FIGURA 77 – LINJA E GAZSJELLËSIT BRENDA KOMUNAVE



Legend/Legjenda

- Kosovo border/ Kufiri i Kosovës

Administrative units/ Njësitë administrative

- Deçan
- Dragash
- Drenas
- Enclave-Kamenicë
- Enclave-Prishtine
- Ferizaj
- Fushë Kosovë
- Gjakovë
- Gjilan
- Graçanicë
- Hani i Elezit
- Istog
- Junik
- Kaçanik
- Kamenicë
- Klinë
- Kllokot
- Leposaviq
- Lipjan
- Malishevë
- Mamushë
- Mitrovicë
- Mitrovicë e Veriut
- Novobërdë
- Obiliq
- Partesh
- Pejë
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Rahovec
- Ranillug
- Shtërpcë
- Shtime
- Skënderaj
- Suharekë
- Viti
- Vushtrri
- Zubin Potok
- Zveçan

Gas pipelines/Gazsjellësi

- Gas pipeline Mitrovica-Vushtrri/ Gazsjellësi Mitrovicë-Vushtrri
- Gas pipeline Obiliq-Vushtrri/ Gazsjellësi Obiliq-Vushtrri
- Gas pipeline to Hani i Elezit (Sharrcem)/ Gazsjellësi për në Han të Elezit (Sharrcem)
- North Macedonia-Kosovo interconnection/ Ndërlidhja Maqedoni e Veriut-Kosovë

FIGURA 78 – HARTA E LARTËSIVE TË KOSOVËS





FIGURA 79 – HARTA E LUMENJVE TË KOSOVËS



Legend/Legjenda

Kosovo border/
Kufiri i Kosovës

Gas pipelines/Gazsjellësi

Gas pipeline Mitrovica-Vushtrri/
Gazsjellësi Mitrovicë-Vushtrri

Gas pipeline Obiliq-Vushtrri/
Gazsjellësi Obiliq-Vushtrri

Gas pipeline to Hani i Elezit (Sharrcem)/
Gazsjellësi për në Han të Elezit (Sharrcem)

North Macedonia-Kosovo interconnection/
